

shqip

Committed to Peace



kujtesa në lëvizje

instrument pedagogjik mbi kulturën e mbamendjes

manual
dvd

botimi i dytë i plotësuar

Udruženje profesora i nastavnika
istorije/historije/povijesti
Bosne i Hercegovine

BIP

anne frank
house



HUMANITY IN
ACTION
Bosnia and Herzegovina



kujtesa në lëvizje

instrument pedagogjik mbi kulturën e mbamendjes
botimi i dytë i plotësuar

manual
DVD

Sarajevë, 2019

Titulli i publikimit:

Kujtime në lëvizje - Mjet pedagogjik mbi kulturën
e kujtimeve
Botimi i dytë i plotësuar

Autorët:

Laura Boerhout
Ana Qigon
Bojana Dujković-Blagojević
Melisa Forić
Senada Jusić
Muhamed Kafexhić Muha
Larisa Kasumagić-Kafexhić
Vjollca Krasniqi
Nita Luci
Nicolas Moll
Michele Parente
Wouter Reitsema
Nxënësit e Institucionit Publik Gjymnazi Obala
Sarajevë

CIP - Katalogizacija u publikaciji
Nacionalna i univerzitetska biblioteka Bosne i Hercegovine, Sarajevo

791.5:725.94(497)

KUJTIME në lëvizje : mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve
botimi i dytë i plotësuar : manual / [Autorët Melisa Forić... [et
al.] ; [përkthimi Enes Tuna]. - Botim i 2. - Sarajevo : Forum Ziviler
Friedensdienste e.V. (forumZFD), 2016. - 101 str. : ilustr. ; 20 x 20
cm + [1] DVD

Prijevod djela: Sjećanje u pokretu. - Autorët: str. 93-95. -
Bibliografija: str. 97-100.

ISBN 978-9958-0399-4-2

1. Forić Melisa

COBISS.BH-ID 23297798

Konsulentët:

Suad Alić
Andrea Baotić
Judith Brand
Elma Hashimbegović
Adis Hukanović
Alma Mashić
Nerkez Opačin
Christian Pfeifer
Soraja Zagić

Kryeredaktor:

Michele Parente

Koordinatorët e projektit:

Michele Parente, *forumZFD*
Melisa Forić, EUROCLIO HIP BeH
Laura Boerhout, Anne Frank House (Hollandë)

I. manual

1.0. hyrje

1.1. Kujtime në lëvizje – mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve	7
---------------------------------------------------------------------------	----------

2.0. ese: si krijohet kultura aktive e kujtimeve në shoqëritë tona?

2.1. Influencimi i të rinjve për të menduar rreth monumenteve dhe kuptimit të tyre	11
-------------------------------------------------------------------------------------------	-----------

3.0. modulet mësimorë me njësitë

3.1. Moduli I: Fillimi

3.1.1. Njësia 1: Kush jam unë?	17
--------------------------------	----

3.2. Moduli II: Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve

3.2.1. Njësia 2: Çfarë është monumenti? dhe të dhënat rreth monumentit	21
3.2.2. Njësia 3: Muzeu i kujtimeve	26
3.2.3. Njësia 4: Këto janë kujtimet e mia/monumentet	28
3.2.4. Njësia 5: Monumenti im ideal	32

3.3. Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipet.

3.3.1. Njësia 6: Një monument, dhjetë mendime	35
3.3.2. Njësia 7: Heronjtë? Historia e rezistencës	39
3.3.3. Skenari: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipet.	44

3.4. Moduli IV: MONUMENTI. Fytyra e ndryshueshme e kujtimeve

3.4.1. Njësia 8: Bisedë me monumentet	49
3.4.1.1. Seti me 27 fotografi të monumenteve nga Ballkani Perëndimor me komente(në kuti)	56

3.5. Moduli V: MONUMENTImotion: Arti i ballafaqimit me të shkuarën. Film i shkurtër.

3.5.1. Njësia 9: Monumentet dhe momentet në lëvizje	59
3.5.2. Skenari: MONUMENTImotion. Film i shkurtër.	66

3.6. Moduli VI: “Në kujtim të të tjerëve” – film dokumentar

3.6.1. Njësia 10: Kujtim i ngjyrosur gjinor	77
---------------------------------------------	----

3.7. Moduli VII: Monumentet bashkëkohore për të ardhmen

3.7.1. Njësia 11: INDEXI (DAVORIN) DHE MIRZA – Romantikët e fundi	83
-------------------------------------------------------------------	----

4.0. ese: Krijimi i kulturës aktive të kujtimit me fuqizimin e mësuesit

4.1. Influencimi i të rinjve përmes pedagogjisë kritike dhe edukimit paqësor	87
-------------------------------------------------------------------------------------	-----------

5.0. autorët

5.1. Biografi të shkurtra	93
----------------------------------	-----------

6.0. materiali dhe burimet

97

II. DVD-materiale didaktike

1. memory walk (shëtitje ndër kujtime): sarajevë-mynih. videoklipet.

1.1. Tre videoklipe nga Sarajeva/Sarajeva Lindore (4'-6')

1.2. Tre videoklipe nga Mynihu (4'-6')

1.3. Krijimi i materialit: Prapa skenës (Making-of)

2. MOuMENTImotion (monumentet dhe momentet në lëvizje). Film i animuar.

2.1. Film i shkurtër i animuar – Arti i ballafaqimit me të shkuarën (10')

2.2. Krijimi i materialit: Nga idea deri te vepra e artit (Making-of)

3. dokumentari: Në kujtim të të tjerëve (46')

4. film i shkurtër Momentet-Monumentet-Lëvizjet: INDEXI (DAVORIN) DHE MIRZA (4')

5. MOuMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve

5.1. Katalogu MOuMENTI mbi monumentet në Ballkanin Perëndimor i disponueshëm në b/k/s, shqip, maqedonisht, anglisht dhe gjermanisht (pdf)

6. manual

6.1. Modulet dhe njësitë në gjuhët b/k/s, shqip, maqedonisht, anglisht dhe gjermanisht (pdf)

7. Kartat pedagogjike

7.1. 27 kartat pedagogjike rreth monumenteve për trajnime të disponueshme në gjuhët b/k/s, shqip, maqedonisht, anglisht dhe gjermanisht (pdf)

“Monumentet dhe vendet përkujtimore janë kujtesë e ngurtësuar. Kujtesa nuk është njëlloj si e vërteta historike – ajo është në një farë mase dhe vullnetare. Kujtesa është ajo çfarë një shoqëri dëshiron të ruajë si kujtim në këndvështrimin e ngjarjes historike.”

Christian Hellbach

Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Bosnje dhe Hercegovinë, në “MOuMENTI”, 2015

hyrje

Historia e projektit të përbashkët

Peisazhi monumental në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në rajon është shumë i ndarë, me “kujtimet në lëvizje” që i ulërijnë njëra tjetrës në hapësirën publike. Edhe pse të ekspozuar çdo ditë nga kujtimet e çimentuara në gur, shpesh të rinjtë dinë dhe ruajnë pak nga mesazhet e këtyre monumenteve, ata rriten në kontekstin shoqëror, politik dhe kulturor në të cilin e kaluara shpesh keqpërdoret, domethënë ku e kaluara shfaqet selektive dhe e njëanshme. Duke patur parasysh një sfond të tillë, në vitet 2013 dhe 2014 janë implementuar dy projekte për të rinjtë me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve nga komunitete të ndryshme të Bosnje dhe Hercegovinës dhe jashtë vendit rreth përkujtimin të monumenteve në Ballkanin Perëndimor, dhe për të nxjerrë në pah rëndësinë e përbaljes me të kaluarën.

“Memory walk” (shëtitje ndër kujtime) është titulli i seminarit filmik i implementuar nga Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut BeH (YIHR BiH) dhe Anne Frank House (AFH) nga Holanda në vitin 2013 në qytetet fqinje Sarajevë dhe Sarajevë Lindore, në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe në vitin 2014 në Mynih, Gjermani. Gjatë seminarit pesëditor, pjesëmarrës të moshave të reja nga qytete të ndryshme shkuan në një ekspeditë të përbashkët kërkimore dhe dokumentuese të monumenteve në mjedisin e tyre të afërt në mënyrë që të informoheshin më shumë rreth tyre, rreth kujtimeve shpesh kontraditore të Luftës së Dytë Botërore dhe luftës së viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Pjesëmarrësit e rinj të seminarit bënë dokumentarë të shkurtër në të cilët paraqiteshin të dhëna mbi monumentet në Sarajevë dhe Mynih në formën e intervistave me kalimtarët e rastësishëm, të cilët u shfaqën në kuadrin e projekteve publike.

“MONuMENTImotion” – Arti që ka të bëjë me të kaluarën (projekti i *forumZFD*) është një film i shkurtër i animuar i 18 studentëve nga Serbia, Kosova, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Gjermania që është inspiruar nga ekspozita MONuMENTI, ku u shfaqën monumente nga Ballkani Perëndimor nga Lufta e Dytë Botërore. Ideja origjinale e projektit ishte që të vendoste monumentet e ngurtësuar dhe të izoluar në një bashkëveprim fiktiv si metafora të caktuara për ndjesitë e gjalla. Me këtë vizion kreativ, studentët e rinj hapën dyert për një sërë mundësish për të shqyrtuar historinë e tregimeve dominuese dhe mbizotëruese në lidhje me monumentet dhe vendet përkujtimore në Ballkanin Perëndimor, si dhe rolet e artit dhe artistit në procesin e përkujtimin dhe ballafaqimit me të shkuarën.

Memory walk (Shëtitje ndër kujtime) dhe MONuMENTImotion – Monumentet dhe momentet në lëvizje bëhen “Kujtime në lëvizje”: Projekti i partneritetit *forumZFD* (Forum Ziviler Friedensdienst e.V. / Shërbimi i paqes civile), Ane Frank House (Hollandë), Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR BiH) dhe Shoqata e mësuesve dhe profesorëve të historisë në BeH (EURICLIO HIP BiH).

Gjatë verës së vitit 2014, për të nxitur përpjekjet individuale të të gjithë partnerëve për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve dhe për të shpalosur punën e të rinjve të publiku i gjerë, partnerët e dy projekteve patën një bashkëpunim të ngushtë. Duke marrë parasysh faktin se të dy projektet u projektuan nga të rinjtë për të rinjtë dhe se produkti i tyre përfundimtar ishte i ngjashëm- klipe filmike, lindi ideja që ai produkt të shndërrohej në një mjet pedagogjik, i cili do të shërbente për mësuesit dhe profesorët në mënyrë që të përdornin klipet filmike në punën e tyre.

Në shtator të vitit 2014 u pregatit një seri e projeksioneve të sukseshme dhe seminari pilot në Sarajevë, Doboj, Maglaj, Tesliç, Teshanj dhe Banja Luka, me pjesëmarrjen e më shumë se 150 të rinjsh. Qëllimi i këtyre seminareve ishte për të vlerësuar vlerën e bashkëpunimit të përbashkët dhe për të testuar disa koncepte të caktuara, disa metoda dhe ide rreth ndërgjegjësimit në lidhje me vështirësitë në procesin e përkujtimit dhe për të marrë në konsideratë rëndësinë e përbaljes me të shkuarën. Rezultoi se për shumicën e studentave, monumentet përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të kujtesës historike, dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të dinë se si janë krijuar këto monumente dhe kush ka vendosur për ta.

Kjo do të thotë që niveli i dëshiruar i ndërgjegjësimit mund të arrihet vetëm me qasjen kritike dhe të menduarit e thellë rreth kësaj teme. Klipet filmike të të dy projekteve janë vërenjtur si një pikënisje shumë interesante për një diskutim të tillë mbi politikën e kujtimeve.

Në periudhën nga shtatori në dhjetor të vitit 2014 *forumZFD* dhe *EUROCLIO HIP BeH* ftuan profesorë universitetesh dhe një numër ekspertësh nga fusha e historisë dhe kulturës së përkujtimit që me vizionin, idetë dhe kompetencën e tyre në zhvillimin e materialeve pedagogjike të jepnin kontributin e tyre në projektin e sapokrijuar me titullin “Kujtime në lëvizje” – mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve, që ndodhet para jush.

”Kujtime në lëvizje”: Konteksti

Monumentet që u trajtuan në “Kujtime në lëvizje” tregojnë se si konceptet e identitetit janë zhvilluar në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe pjesërisht në Gjermani gjatë shekullit të 20-të. Duke pasur parasysh rolin e tyre, monumentet përfaqësojnë mjetet ideale për të paraqitur këto procese në një mënyrë interesante. I njëjti monument ndonjëherë mund të sjellë në mendje koncepte të ndryshme identiteti për hapësira specifike gjeografike dhe kohore. Transformimi, shkatërrimi dhe neglizhimi i monumenteve ekzistuese përditëson konceptet politike të identitetit, dhe në këtë këndvështrim ato janë shumë të rëndësishëm për identitetin. Këto koncepte identiteti mund t’i ndajë njerëzit dhe të nxisë dhunën, por ato mund të kenë dhe efekt pajtues gjithashtu. Në këtë mënyrë u shfaq nevoja për gjetjen e formave të reja për të ballafaquar të shkuarën, për të ballafaquar tregimet historike dominuese dhe për të hulumtuar rreth koncepteve të përcaktuara të identitetit. Kështu që u prirëm për një perspektivë ndërkombëtare, me ndihmën e të cilës do ti njohim studentët me procesin dhe mekanizmat e përkujtimit, duke i’u lënë atyre hapësirë të mjaftueshme për shqyrtim kritik dhe reflektim mbi këtë temë.

Kujtime në lëvizje: Qëllimet

Qëllimi kryesor i mjetit edukativ është të inkurajojë të rinjtë në Europë që të angazhohen në mënyrë aktive në histori dhe për t'i mbështetur ata në reflektimin kritik rreth kulturës publike të përkujtimit. Autorët përcaktuan nën-qëllimet e mëposhtme:

- Inkurajimin e një qëndrimi kritik ndaj procesit të përkujtimit, p.sh me anë të kontekstualizimit të strategjive të ruajtjes së kujtimeve dhe ndërgjegjësimit në lidhje me vështirësitë e ndërtimit të monumentit, dhe kuptimet e diskutueshme të monumenteve;
- Britjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e të rinjve në procesin e përkujtimit;
- Promovimin e një reflektimi gjithëpërfshirës rreth të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes, në një dialog konstruktiv ndërmjet vendeve;
- Kontributin për të krijuar besim mes individëve dhe komuniteteve me prejardhje të ndryshme për të rivendosur dialog dhe për të rindërtuar marrëdhënie paqësore;
- Inkurajimi i formave alternative të të menduarit në lidhje me përkujtimin.

Materiali i përditësuar i përfshirë në këtë mjet edukativ do të inkurajojë të rinjtë që të punojnë aktivisht për të krijuar hapësira për dialog konstruktiv, që ka të bëjë me perceptime të ndryshme, me shkëmbimin e pikëpamjeve të ndryshme dhe shqyrtimin kritik rreth të shkuarës së tyre dhe të shkuarës së të tjerëve. Se fundi, duke njohur karakteristikat universale të përkujtimit në të gjithë Europën mund të ndihmojë për të kapërcyer diskursin dominant publik dhe kufinj të që ekzistojnë në çdo shoqëri.

Kujtime në lëvizje: Struktura e manualit

Manuali është strukturuar si një mjet interaktiv pedagogjik për mësues, instruktorë dhe profesorë që punojnë me të rinjtë nga mosha 15 deri në 25 vjeç dhe përmban:

- shtatë module tematike mbi kulturën e përkujtimit;
- njëmbëdhjetë njësi për të punuar me nxënësit dhe studentët, si dhe për të punuar me të rinjtë që janë aktivë në organizata rinore joqeveritare kulturore dhe arsimore;
- dy përmbajtje me shkrim (ese);
- DVD me material audiovizual didaktik (shatë filma të shkurtër dhe një film dokumentar);
- 27 karta didaktike (për të punuar me pjesëmarrësit e trajnimit) me fotografi monumentesh dhe përmendoresh nga Ballkani Perëndimor;
- Katalog me monumentet e Ballkanit Perëndimor me titullin MONUMENTI;
- Biografia e autorëve;
- përzgjedhja e materialeve relevantë për edukim mbi kulturën e kujtimit.

Paketa e materialeve pedagogjike të përfshirë në projektin “Kujtime në lëvizje” është rezultat i punës së përbashkët të një ekipi multikulturor të përbërë nga profesorë dhe mësues nga Bosnja dhe Hercegovina, historianë dhe historianë arti nga Bosnja dhe Hercegovina dhe nga jashtë vendit, të cilët kanë marrë parasysh

dhe kontributet e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare që punojnë me zgjidhjen jo të dhunshme të konfliktit, ndërtimin e paqes dhe me çështjet e të drejtave të njeriut. Materiali është i disponueshëm në gjuhët zyrtare të Bosnje dhe Hercegovinës, në Maqedonisht, Shqip, Anglisht dhe Gjermanisht.

Në sajë të një serie prej 10 trajnimesh për 124 mësues dhe profesorë, edukatorë të arsimit formal dhe joformal të implementuar gjatë vitit 2015 në nëntë qytete të Bosnje dhe Hercegovinës- Sarajevë, Doboj, Srebrenicë, Mostar, Jajce, Prijedor, Brčko, Tuzla dhe Buzhim, mjete pedagogjik “Kujtime në lëvizje” gjeti rrugën e tij për tek përdoruesit (vlerësimi dhe dokumentacioni janë të disponueshëm në www.dwp-balkan.org dhe në memorinmotion. cliohipbih.ba). Çdo trajnim mori dimension të ri me përgjigje pozitive dhe me ide të reja që pjesëmarrësit e trajnimit ndanë mes tyre. Idetë e reja konstruktive për përmirësim të materialit që morëm, vendosëm ti përfshinim në këtë botim të dytë të materialit me qëllim përmirësimin e tij. Si material krejtësisht i ri janë përfshirë dy module mësimorë me njësitë “Kujtim i ngjyrosur gjinor” dhe “Indexi (Davorin) dhe Mirza”. Këto module mësimorë janë të bazuar në filmin dokumentar shtesë “Në kujtim të të tjerëve” dhe në filmin e shkurtër “Indexi dhe Mirza”, që është fitues i konkursit për të rinjtë “Momentet-Monumentet-Lëvizjet”. Gjithashtu kemi shtuar dhe esenë mbi rëndësinë e inkurajimit të të rinjve rreth pedagogjisë kritike dhe edukimit të paqes. Botimi i ri i mjetit pedagogjik “Kujtime në lëvizje” do të udhëtojë në rajonin e Ballkanit Perëndimor ku do t’ju paraqitet mësuesve dhe përdoruesve të tjerë nëpërmjet trajnimit.

Shpresojmë që botimi i dytë i plotësuar i këtij manuali, me një numër më të madh materialesh didaktike të shërbejë për pedagogët, mësuesit dhe aktivistët e rinj si mjet shtesë që me ndihmën e të cilit të rinjtë do të njohin mënyrat se si historia dhe kujtimet rreth luftës paraqiten, përdoren dhe shpesh keqpërdoren në hapësirat publike.

Autorët e projektit “Kujtime në lëvizje” besojnë që këto “leksione” nga e kaluara që janë shndërruar në “mjete” për të ardhmen, t’ju mundësojnë të rinjve të Europës, diskutim me orientim konstruktiv dhe kritik mbi përkujtimin dhe në fund të fundit të vazhdojë në mënyrë të suksesshme të japë kontributin në vendosjen e paqes dhe pajtimit në shoqëri.

Laura Boerhout, Anne Frank House (Hollandë)

Michele Parente, Forum Ziviler Friedensdienst e.V. (*forumZFD*) në Bosnje dhe Hercegovinë Christian Pfeifer,

Forum Ziviler Friedensdienst e.V. (*forumZFD*) në Serbi

Melisa Foriq, EUROCLIO HIP BeH (Bosnja dhe Hercegovina)

www.memorytools.cliohipbih.ba

www.dwp-balkan.org

www.forumzfd.de

www.annefrank.org

ese

Inkurajimi i të rinjve për të menduar rreth monumenteve dhe kuptimit të tyre: Si krijohet kultura aktive e përkujtimit në shoqëritë tona?

Dr. Nicolas Moll, historian

Kultura e përkujtimit është shumë më tepër se monumentet- por gjithsesi ato janë pjesa veçanërisht e dukshme e ilustrimit të kulturës së përkujtimit në shoqëritë tona në Europë. Monumentet ndërtohen nga persona, grupe ose shoqëri në përjekje për të artikuluar vizionin e tyre rreth të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes. Në të njëjtën kohë, si dhe çdo simbol tjetër, monumentet kanë shtresa të ndryshme kuptimi dhe rrallëherë paraqesin blloqe monolitesh të thjeshtë, edhe pse nganjehërë atë qëllim kanë pasur. Gjithashtu, çdo monument ka histori me shumë aspekte, për shembull historinë e krijimit të tij, historinë e perceptimeve të ndryshme, historinë e fatit të tij pas ndërtimit.

Kuptimi dhe analizimi i monumentit është një sfidë, por ndonjëherë ajo është e domosdoshmë për të kuptuar një shoqëri, kulturën e përkujtimit të asaj shoqërie dhe zhvillimin e shoqërisë dhe të kulturës së përkujtimit të asaj shoqërie. Si të rrisim interesin e njerëzve në një shoqëri, dhe veçanërisht interesin e të rinjve për monumentet që i rrethojnë? Një nga problemet e monumenteve është që jo rrallë pas ndërtimit bëhen të padukshëm sepse bëhen pjesë e jetës së përditshme, dhe për këtë arsye shpesh nuk i vërejmë më. Ose i shohim por vetëm në një mënyrë sipërfaqësore dhe nuk mendojmë vërtetë rreth tyre. Si ti bëjmë ato të dukshëm prapë dhe si ti bëjmë subjekt i të menduarit kritik?

Projekti “Shëtitje ndër kujtime”, me videoklipët e tij, dhe “MONuMENTImotion”, me filmin e tij të shkurtër të animuar, në të cilat bazohet mjeti i përbashkët pedagogjik “Kujtime në lëvizje” – siç është përshkruar në fillim të këtij manuali – janë dy projekte të ndryshëm, të cilët ndër të tjera, kanë dhe shumë gjëra të përbashkëta. Para së gjithash, të dy projektet në qëndër të vëmëndjes vënë monumentet, duke u përpjekur që të theksojnë gjykimin tonë rreth tyre dhe të stimulojnë të menduarit tonë rreth monumenteve dhe kontekstit të tyre. Ato i bëjnë monumentet të dukshëm dhe subjekt i të menduarit, ndërsa filmat janë punuar kryesisht nga të rinjtë.

Gjithashtu, ka dallime mes projekteve dhe filmave që janë krijuar në kuadër të projektit- në formën e fokusit gjeografik dhe kontekstit historik të monumentit të pëzgjedhur për filmat. Kur është fjala për projektin “Shëtitje ndër kujtime”, çdo video klip i veçantë ka të bëjë me një monument specifik, ndërsa materialet përgjithësisht janë të organizuar rreth intervistave në të cilat persona të ndryshëm shprehin mendimet e tyre mbi monumentin e pëzgjedhur. Nga ana tjetër, “MONuMENTImotion” është një film i animuar që nuk merret me monumentë të veçantë, por përfshin të gjithë peisazhin monumental dhe krijon një tregim imagjinar rreth tyre. Përsa i përket fokusit historik dhe gjeografik, seria e parë e klipeve nga materialet “Shëtitje ndër kujtime” i referohet monumenteve nga Sarajeva dhe nga Sarajeva Lindore në lidhje me luftën e periudhës 1992-1995 dhe nga Lufta e Dytë Botërore, ndërsa seria e dytë e monumenteve përbëhet nga monumente të Mynihut, Gjermani që kanë të bëjnë me Rajhun e Tretë, të cilët janë ndërtuar gjatë njëzet viteve të fundit. Edhe pse filmi “MONuMENTImotion” fokusohet në territorin e ish-Jugosllavisë, me monumente të njëzet viteve të fundit, të cilët pjesërisht lidhen me luftërat gjatë 1990-tës, ai gjithashtu përfshin dhe periudhat e mëparshme, veçanërisht periudhën e Jugosllavisë socialiste me monumentet që kanë të bëjnë me luftërat e partizanëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Megjithatë, pavarësisht nga këto dallime, filmat që rrjedhin nga këto dy projekte janë gjithashtu në masë të madhe komplementare, sepse, siç u përmend tashmë, përbëhen nga monumentë të dukshëm që janë subjekt i shqyrtimit serioz. Në këtë mënyrë, të dy projektet kanë të bëjnë me të njëjtën temë: Si i trajtojmë monumentet dhe cila është rëndësia e monumentit? Kjo është një pyetje universale që nuk ka përgjigje universale sepse çdo monument është produkt i kohës së tij dhe shoqërisë dhe kërkon përgjigje specifike, por ajo që ne mund të vëzhgojmë janë disa trende të përgjithshme.

Kur shohim filma të ndryshëm mund të krijojmë përshtypjen se sa e shtresëzuar është çështja e kuptimit të monumenteve. Në rastin e tre monumenteve nga projekti “Shëtitje ndër kujtime” të lidhura me Mynihun, është e qartë se karakteristika e përbashkët e tre monumenteve që i janë dedikuar Trendafilit të Bardhë, Drückeberggasse (rrugës që zgjidhnin kalimtarët të cilët donin të shmangnin dhënien e respektit monumentit nazist) dhe Georg Elser është ajo që nuk janë monumentale, por diskretë, madje edhe nëse i vëreni ato, jo domosdoshmërisht do ta kuptoni se për çfarë bëhet fjalë, sepse monumentet nuk japin informacion direkt rreth ngjarjes historike që përfaqësojnë. Në rastin e projektit “MONuMENTImotion”, përgjithësisht shohim

një lloj tjetër monumentesh: statuja të personave ose monumente abstrakte me forma vertikale dhe të përpunuara, të cilët janë ndërtuar për të dominuar ose për të patur ndikim në mjedisin e tyre. Ato nuk janë domosdoshmërisht shumë të qartë, në fakt ato monumente janë nganjëherë shumë abstraktë. Me një fjalë, këto monumente shtrojnë dy pyetje të rëndësishme: e para, në çfarë mase monumentet duhet të jenë të dukshëm? Së dyti, sa duhet të jenë të qartë? Me fjalë të tjera, a përcjellin monumentet një mesazh të qartë të vizitori dhe sa duhet bërë ajo, domethënë sa hapësirë duhet të lihet për interpretim nga vizitori? Gjatë njëzet viteve të fundit në Europë kemi qënë dëshmitarë të zhvillimit të formave alternative vertikale dhe monumentale të formave të monumentit. Tre monumente nga video klipet nga Mynihu janë një shembull i tillë, ndërsa në ish-Jugosllavi mund të vërehet forma e monumentit “përdhes”. Ilustrimi më i spikatur i monumenteve më pak të dukshëm dhe të qartë janë me siguri “Trendafilat e Sarajevës”, të cilët janë treguar në video klipet e projektit “Shëtitje ndër kujtime”.

Një tjetër pyetje stimuluese që shtrohet në filma, në kuadrin e dy projekteve është si mëposhtë: Çfarë ndodh ose çfarë duhet të ndodhë me monumentet e regjimit të mëparshëm kur ai regjim zhduket? A duhet të shkatërrohen? të hiqen? të restaurohen? të transformohen? Kjo është një pyetje e rëndësishme dhe delikate, për shembull në shtetet e ish-Jugosllavisë në lidhje me një numër të madh monumentesh partizane që janë ndërtuar ndërmjet 1950-ës dhe 1980-ës.

Shumë nga këto monumente që janë ndërtuar në Jugosllavinë socialiste, në ditët e sotme janë braktisur, shkatërruar ose ndryshuar. Kjo është gjithashtu pika e fillimit e filmit “MONuMENTImotion”: fati i monumentit Boro dhe Ramiz në Prishtinë, i cili është ndërtuar për të theksuar vëllazërinë serbo-shqiptare në luftën kundër fashizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore, por nga i cili është hequr busti i Boros. Çështja e fatit të monumenteve partizane përmendet gjithashtu dhe në dy nga tre video klipet e projektit “Shëtitje ndër kujtime” që janë bërë në Sarajevë dhe në Sarajevën Lindore.

Duke pasur parasysh se ndërtimi i monumenteve dhe kuptimi i tyre është një çështje universale, dhe duke pasur parasysh faktin se këto dy projekte dhe filmat e tyre pjesërisht merren me pjesët e dallueshme të aspekteve të ngjashme nga e njëjta temë, ka kuptim fakti që këto dy projekte janë bashkuar në një mjet pedagogjik. Si mund të përdoren këto dy projekte dhe filmat që rrjedhin nga ato në mënyrë që të rinjtë e vendeve të ndryshme të

Europës të inkurajohen që të mendojnë rreth monumenteve dhe kuptimit të tyre? Dhe si të mendohet atëherë për mënyrat e përdorimit dhe sfidat e kujtimeve historike në shoqëritë tona? Modulet në këtë mjet pedagogjik propozojnë mundësi të ndryshme. Në këtë mënyrë kontribuohet që monumentet dhe kujtimet të mos shihen si diçka statike por të shndërrohen në diçka të gjallë, gjë e cila ndodh gjithashtu në filmat e këtyre dy projekteve. Në projektin “MONuMENTImotion”, monumentet e paraqitur vijnë në jetë, ndërsa në rastin e video klipëve në projektin “Shëtitje ndër kujtime” monumentet vijnë në jetë në mënyrë që ftojnë njerëzit që të mendojnë dhe të flasin rreth tyre. Ky mjet pedagogjik zgjeron këtë punë: duke influencuar të rinjtë që të mendojnë dhe të punojnë në monumente, fton ata të bëhen pjesë aktive e kulturës së kujtimit në shoqëritë e tyre, dhe me shpresën që do të inkurajohen të kuptojnë që zhvillimi i çdo kulture përkujtimore nuk është diçka që ndodh vetvetiu; ajo është diçka që kërkon mbështetjen e njerëzve, qytetarëve dhe varet nga pjesëmarrja e tyre.

Pjesa plotësuese e botimit të ri të mjetit pedagogjik përbëhet nga dy filma shtesë (me modulet pedagogjike përgjegjëse) të cilat janë në harmoni me filmat e parë të projektit, që i plotësojnë dhe u japin atyre një perspektivë shtesë për hulumtimin e monumenteve dhe rigjallërimin e tyre në sytë e studentëve. Njëri është “Në kujtim të të tjerëve”, i regjizores së re nga Sllovenia Ana Qigon, e cila bën kërkime rreth monumenteve në Kosovë përmes një vështrimi kritik të studentëve, artistëve, akademikëve dhe aktivistëve. Si dhe në shumë vende të tjerë, pothuajse të gjithë monumentet ekzistues në Kosovë paraqesin meshkuj, ndaj Ana Qigon për filmin e saj vendos të intervistojë vetëm femra. Rezultati është një udhëtim stimulues përmes lindjes dhe kulturës së përkujtimit, mos (përfaqësimi) i femrave, si dhe çështja e përgjithshme se pse disa grupe dhe tema përfaqësohen (më shumë), ndërsa të tjerët jo. Gjatë filmit, në një moment, një studente thotë: “Nuk e kuptoj se pse çdo monument ka të bëjë me luftën dhe politikën dhe pse nuk ka monumente për artistët. “Kjo na çon tek filmi i dytë që i është shtuar mjetit pedagogjik, i klipit filmik “Indexi dhe Mirza”. Filmi fokusohet në monumentë të pazakontë që janë ndërtuar në Sarajevë: njëri i dedikohet Davorin Popoviç, këngëtarit të grupit rok “Indexi”, ndërsa tjetri, lojtarit të basketbollit Mirza Delibashiç. Të dy janë figura legjendare të Sarajevës, të Bosnje dhe Hercegovinës dhe ish Jugosllavisë. Ata kanë qënë shokë, dhe të dy kanë vdekur herët, në vitin 2001. Te dy kanë mbetur në kujtesë si simbol i njerëzimit dhe përmbushjes së ëndrrave. Ky klip filmik, që është bërë nga nxënësit e Gjimnazit Obala nga Sarajeva është një shembull inkurajues se si te rinjtë merren me monumentet, dhe si perspektiva e të rinjve mund të hapë çështje frymëzuese mbi rëndësinë e monumenteve në shoqëritë bashkëkohore.



1994 “Krajputaš” – Monumenti i Ivo Andrić, Vishegrad, Bosnje e Hercegovinë

moduli I	fillim
	njësia 1
tema	Komunikimi dhe dëgjimi i përbashkët
titulli	Kush jam unë?
nëntitulli	Kërkimi i identitetit dhe krijimi i atmosferës për punë në grup
konteksti	Ky është një ushtrim hyrës që ka për qëllim të mundësojë pjesëmarrësit të kuptohen më mirë dhe të krijojnë atmosferën e punës në module të ndryshme dhe konkrete që janë paraqitur në këtë manual. Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e punës me modulet duke pasur parasysh se është shumë e rëndësishme të kuptosh dhe të njihesh me pjesëmarrësit dhe t'ju mundësosh atyre që të shprehin pa hezitim idetë dhe qëndrimet. Nëse në fillim të procesit mësimor krijohet atmosfera e përshtatshme e punës, rezultatet në fazat e mëvonshme do të jenë pozitive
tema të ngjashme	Identiteti dhe ndërveprimi i grupit
mesazhet	Si përcaktohem unë dhe si më përcaktojnë të tjerët?
qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> • mundësimi i pjesëmarrësve që të njihen me mirë përmes kontakteve personale; • mundësimi i pjesëmarrësve që të përmirësojnë aftësitë e tyre të dëgjimit; • inkurajimi i pjesëmarrjes së barabartë në punë.
Rezultatet e mësimimit	Pjesëmarrësit do të njihen më shumë me njëri -tjetrin dhe do të shkëmbejnë pritshmëritë e tyre nga moduli.
kohëzgjatja	90 minuta
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Nga puna në çift dhe në grup, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të njihen më mirë dhe të shkëmbejnë pritshmëritë e tyre nga moduli

procedura

Hyrje (10 minuta)

Kërkoni nga pjesëmarrësit që të klasifikohen në dy grupe.

Kërkoni nga grupet që të qëndrojnë në anë të kundërta të klasës dhe të jenë përballë njëri-tjetrit

Puna në çift (15 minuta)

Shpjegoni pjesëmarrësve që duhet të krijojnë kontakt me sy me një pjesëtar të grupit tjetër dhe që me atë person duhet të shkëmbejnë informacionet e mëposhtme:

- informacione personale,
- lojën e preferuar të fëmijërisë,
- ndodhinë më emocionuese që u ka ndodhur gjatë 30 ditëve të fundit,
- pushimet ideale,
- monumentin botëror më të famshëm që së pari u vjen ndërmend

Pastaj shpjegojuni pjesëmarrësve që do të:

- flasin njëri me tjetrin 8 minuta gjithsej,
- prezantojnë partnerin e tyre pjesës tjetër të grupit pa parë shënimet.

Puna në grup (50 minuta)

Me mbarimin e kohës së caktuar të punës në çift, duhet të kërkohet nga pjesëmarrësit që të prezantojnë partnerin e tyre pjesës tjetër të grupit, duke folur në vetën e parë dhe pa parë shënimet (p.sh. Mario prezanton Almën, do të fillojë prezantimin si vijon: “Përshëndetje, unë jam Alma...”).

Pjesës tjetër të grupit duhet t’i shpjegohet që të përqëndrojnë vëmëndjen tek personi që po prezanohet dhe jo tek personi që flet.

Çiftet do të ndërrohen derisa grupi të prezantojë të gjithë personat.

Rishikim:

Inkurajoni pjesëmarrësit të përshkruajnë se si u ndjenë kur bëhej një prezantim i tillë dhe si dukej kur dikush i’u prezantonte në mënyrë të tillë.

Nëse numri i pjesëmarrësve është tek, moderatori mund të luajë rolin e partnerit tek pjesëmarrësi që nuk ka partner në mënyrë që dhe ai të marrë pjesë në këtë ushtrim.

	<p>Përmblihdni obzervimet e paraqitura.</p> <p>Shënimet e moderatorit: Në fazën e “intervistimit” paralajmëroni pjesëmarrësit që kanë kaluar 4 minutat dhe që edhe personi tjetër i çiftit duhet të ketë kohë të njëjtë për intervistim.</p> <p>Pjesëmarrësit do të harrojnë ndonjëherë që të prezantojnë partnerin e tyre në rolin e kundërt. Kur kjo gjë të ndodhë, duhet detyrimisht të rikujtohet pjesëmarrësi në kërkesën e detyrës të dhënë në fillim.</p> <p>Mos i thoni pjesëmarrësve që do të kenë role të anasjellta derisa të mbarojnë ushtrimin e intervistimit.</p>
materialet	Tabelë me letër, lapsa dhe letra
burimet	<i>Simpoziumi i 10-të ndërkombëtar veror mbi jo-dhunën, Kingian ndalimi jo i dhunshëm i konflikteve</i> , Qendra kundër dhunës dhe studimeve paqësore, Universiteti i Rhode Island
literatura shtesë	http://www.intergroupresources.com/all-different-all-equal http://dramaresource.com/games/group-dynamics
aktivitetet shtesë	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve



1999 Monumenti i Nënë Terezës, Shkup, Maqedoni

moduli II kujtime për monumentet / monumentet e kujtimeve	
	njësia 2
tema	Kuptimi i kujtimeve: nga keqardhja te mohimi
titulli	Çfarë është monumenti? dhe Të dhënat rreth monumentit
nëntitulli	Kërkimi i temave të përkujtimit
konteksti	Në këtë orë mësimi nxënësit do të fillojnë të studiojnë kontekstet historike nga disa perspektiva. Fokusi do të jetë në procesin e përkujtimit dhe do të eksplorohehen mënyrat e ndryshme në të cilat individët, komunitetet dhe shoqëritë përgjigjen në forma të ndryshme ndaj traumës shoqërore. Nga nxënësit do të kërkohet që të reflektojnë në mënyrë kritike mbi mesazhet që komunikojnë monumentet.
tema të ngjashme	Ballafaqimi më të shkuarën, ndërtimi i monumenteve
mesazhet	Zhvillimi i një këndvështrimi “multiperspektiv” dhe kritik duke pasur parasysh kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e monumenteve dhe rolin e tyre në memorie dhe kujtesë
qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> • shqyrtimin e ndërgjegjësimit mbi monumentet duke futur temën e monumenteve; • të kuptuarit që monumentet janë vetëm një aspekt i kujtesës; • të kuptuarit se pse ngrihen monumentet dhe kush i ngre ata, çfarë n’a thotë mesazhi, vendi dhe dizajni mbi rëndësinë e tyre potenciale për shoqërinë; • konsiderimi dhe krahasimi i mekanizmave dhe proceseve të përkujtimit në vende të ndryshme, duke përfshirë dhe mekanizmat dhe proceset në vendin e tyre
Rezultatet e mësimimit	Pjesëmarrësit do të njihen me temën e monumenteve dhe do të kuptojnë që monumentet përfaqësojnë një tip kujtesë. Pjesëmarrësit do të kuptojnë se ndërtimi i monumenteve ka lidhje me të kaluarën aq sa ka lidhje dhe me të tashmen. Pjesëmarrësit do të kuptojnë kompleksitetin e kujtimeve, ndryshimet dhe ngjashmëritë e kujtimeve në të gjithë botën.
kohëzgjatja	30 minuta (aktiviteti 1), 60 minuta (aktiviteti 2)
numri i pjesëmarrësve	20-30

<p>metodologjia</p>	<p>Përgatitja aktuale për orën e dytë të mësimit ndahet në dy aktivitete plotësuese: Aktiviteti1: Çfarë është monumenti? Aktiviteti 2: Të dhënat mbi monumentin</p> <p>Diskutimi në grupet e vogla dhe analiza kritike do të inkurajojë pjesëmarrësit të ndajnë vizionet personale dhe perspektivat e ndryshme, dhe në këndvështrim kritik të interpretojnë monumentet dhe historinë.</p> <p>Skenarët janë përgatitur (të cilët mund të jenë të lidhur me videoklipet nga materiali “Shëtitje ndër kujtime”) ku pjesëmarrësit do të punojnë në grupe më të vogla, me qëllim zhvillimin e aftësive kërkuese dhe prezantuese përmes punës së përbashkët për detyrat e grupit.</p>
<p>procedura</p>	<p>AKTIVITETI 1: Çfarë është monumenti?</p> <p>1. Dhënia e ideve mbi një temë të caktuar (10 minuta)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkoni nga pjesëmarrësit që të shkruajnë në një copë letër: Çfarë kuptimi ka fjala monument? Le të shkruajnë ndonjë mendim/ide që atyre u vjen në mendje. Shpjegoni që mund të shkruajnë çfarë të duan – nga ndjesitë deri te ndonjë ndodhi. • Kërkoni nga një pjesëmarrës të mbledhë të gjitha letrat, dhe pastaj rreshtojini në formë rrethore rreth fjalës “monument”, që keni shkruar në tabelë, dhe kërkoni t’i lexojnë me zë të lartë. • Kërkoni nga pjesëmarrësit që të nxjerrin në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet që kanë vërenjtur. • Përpiquni që këto dallime dhe ngjashmëri t’i gruponi në tema rreth të cilave do t’i diskutoni më vonë gjatë ushtrimit: historia dhe kujtesa vs. e sotshmja/emocionet vs. ngjarjet/estetika vs. mesazhe dhe eksperiencia. <p>2.Diskutimi plenar (20 minuta)</p> <p>Konsideroni me pjesëmarrësit një nga pyetjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A janë monumentet gjithmonë çështje e historisë? Nëse jo, pse janë ata kaq të rëndësishëm sot? 2. Kush i ngre monumentet dhe përse? Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë për aktorë të ndryshëm (viktima, veteranë, politikanë, aktivistë dhe artistë) dhe arsytet e tyre (zisë, nderimit, edukimit, fajësimit, provokimit, informimit). 3. Cilat janë mënyrat e tjera në të cilat mund të prezantohet historia? Kërkojuni pjesëmarrësve të “hedhin” ide mbi mënyrat e tjera se si njerëzit kujtojnë historinë(prej varrezave, përkujtimeve, tregimeve familjare, televizorit, librave, arsimit, muzeve).

4. Pse mund të jetë e vështirë për të ngritur një monument dhe pse mund disa mund të mos jenë dakort? Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë mbi emocionet, ndjesitë, eksperiencat shqetësuese të luftës që janë të lidhura me monumentet, dhe të cilat mund të shkaktojnë reaksione të forta dhe pyesni ata mbi interesat e aktorëve të ndryshëm, siç janë për shembull politikanët.

AKTIVITETI 2: Te dhënat mbi monumentin

1. Pregatitja

Pregatitni 4-5 skenarë rreth monumenteve (aq sa grupe të dëshironi por maksimalisht 5 pjesëmarrës në një grup). Skenarët të kenë lidhje me videoklipët “Shëtitje ndër kujtime”.

2. Puna në grupe më të vogla (60 minuta)

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla kërkuese, nga 4 deri në 6 pjesëmarrës në secilin grup. Kërkoni nga “grupet kërkuese” që me ndihmën e “udhëzuesit”, i cili u lejon atyre të “lexojnë” monumentin, të zbulojnë monumente në mbarë Europën, në mënyrë që të demonstroni ushtrimin para tyre përmes futjes së ndonjë shembulli. Për t’u pregatitur për kërkimin e tyre, pjesëmarrësit mund të përdorin videoklipet “Shëtitje ndër kujtime” dhe materialet e disponueshme në internet. Theksoni që grupet kanë në dispozicion 40 minuta për të përfunduar detyrën e tyre kërkuese dhe 20 minuta që të bëjnë një prezantim të shkurtër në PowerPoint ose poster me anë të cilit do t’ju prezantojnë pjesëmarrësve të tjerë gjetjet në lidhje me monumentin e tyre.

3. Prezantimi i posterave (30 minuta)

Lejoni që çdo grup të prezantojë monumentin e vet.

4. Diskutimi plenar (30 minuta)

Temat e propozuara për bashkëbisedim:

- Si ishte pjesëmarrja në këtë aktivitet? Cilat janë të rejtat që mësuat rreth monumenteve?
- A keni vënë re ndonjë ngjashmëri mes monumenteve në vende të ndryshme? Mendoni rreth ngjashmërive në kontekstin estetik dhe të mesazheve dhe përpiquni në nivel grupi që të mendoni mbi arsyet e këtyre ngjashmërive (diskutimin mund t’a drejtoni në faktin se polemikat historike janë universale dhe që çdo vend ka ngjarjet e veta serioze të cilat dëshiron t’i shënojë).

- A keni vënë re ndonjë ndryshim mes monumenteve në vende të ndryshme? Mendoni rreth ndryshimeve në kontekstin estetik dhe të mesazheve dhe përpikuni në nivel grupi të mendoni se pse ekzistojnë këto ndryshime (diskutimi mund të drejtohet në kohën nga përfundimi i luftës, origjina e konfliktit / marrëveshja paqësore, klima aktuale sociale dhe politike).

Udhëzues për të “lexuar” monumentet: Çfarë pyetje mund/duhet të bëni

I. Ngjarja historike:

- Me cilën ngjarje historike lidhet monumenti?

II. Procesi i ndërtimit të monumentit:

- Kush e ka iniciuar ndërtimin e monumentit dhe si ka rrjedhur procesi i vendimit?
- Kur është bërë / në çfarë konteksti?
- Si është financuar?
- Kur, si dhe kush e ka paraqitur atë?

III. Monumenti në vetvete dhe funksioni i tij:

- Në çfarë lokaliteti ndodhet? (autentik/simbolik/i distancuar/i theksuar)
- Cila është forma/dizajni i monumentit? (abstrakt/figurativ/tradicional/modern)
- Cilat simbole (nuk) përdor? (fetare/politike/emocionale)
- Çfarë nënshkrimi/teksti përmban?
- Çfarë përfaqëson, domethënë çfarë mesazhi dëshiron të përcjellë në lidhje me ngjarjen historike të cilës i referohet?
(mesazh gjithëpërfshirës / mesazh të veçantë, nderim / fajësim / mohim / edukim)
- Për kë, ose kundra kujt është ngritur monumenti? (viktimave/autorëve të krimi/ndihmësve)
- Kujt i drejtohet mesazhi?
(gjuha: e banorëve vendas/të huaj)
- A komunikon monumenti me vizitorin, a e angazhon atë?

IV. “Jeta pas”:

- Si duket monumenti sot? (i mbrojtur/i dëmtuar)
- A është forma ose mesazhi i tij i ndryshuar?
- A përdoret për përkujtime (zyrtare) ose për ndonjë aktivitet tjetër?
- A është pjesë e jetës së përditshme(qytetare) dhe nëse është, si përdoret?

	<p>V. Pranimi dhe perceptimi – reagimi ndaj monumenteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si kanë reaguar njerëzit kur është planifikuar/ndërtuar? • A ka shkaktuar monumenti diskutime/polemika? • Si e perceptojnë atë monument njerëzit sot?
materiali	<p>Tabela me letra, ku në një letër do të jetë e shkruar me shkronja të mëdha fjala “monument”;</p> <p>Letra boshe në të cilat pjesëmarrësit do të bëjnë posterat; laptopë dhe lidhje interneti; kopje udhëzuesi “Si të lexojmë monumentet”.</p>
burimet	<p>Udhëzuesi: Moduli III / “Shëtitje ndër kujtime” (Memory walk) Sarajevë – Mynih/ Skenari dhe videoklipet “Shëtitje ndër kujtime” (në DVD: Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve)</p>
literaturë shtesë	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli IV: MONUMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve; • Katalogu MONUMENTI, në format PDF, në DVD “Kujtime në lëvizje”.
aktivitete shtesë	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 2: Muzeu i kujtimeve; • Moduli II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 5: Monumenti im ideal; • Modul II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 4: Këto janë kujtimet e mia/monumentet

moduli II Kujtime për monumentet /monumentet e kujtimeve	
	njësia 3
tema	Sfidat në procesin e ndërtimit të monumentit
titulli	Muzeu i kujtimeve
nëntitulli	Konsiderimi i arenës përkujtimeve
konteksti	Në këtë leksion, pjesëmarrësit do të vazhdojnë të studiojnë kontekstet historike nga perspektiva të shumta. Fokusi do të jetë në procesin e përkujtimit dhe ndërtimit të monumenteve nga perspektiva e aktorëve të ndryshëm të prekur nga forma të ndryshme të traumës sociale. Do të shqyrtohen përmendoret me qëllim studimin e balancës së pushtetit në të shkuarën dhe në të tashmen dhe të krijohen lidhje mes kujtimeve dhe historisë zyrtare
tema të ngjashme	Shqyrtimi kritik, ndërtimi i monumenteve, ballafaqimi me të shkuarën
mesazhet	Njohja e kompleksitetit të procesit të përkujtimit në çdo shoqëri
qëllimet	Konsiderimi i procesit (të rëndë) të përkujtimit në shoqëri
Rezultatet e mësimit	Pjesëmarrësit do të krijojnë një imazh më të qartë të të gjitha shtresave të procesit të përkujtimit dhe të marrjes së vendimeve për ndërtimin e monumenteve. Pjesëmarrësit do të njihen me zëra të ndryshëm dhe do të kuptojnë më mirë ndjeshmërinë e çështjes së ndërtimit të monumenteve pas luftës dhe konfliktit.
kohëzgjatja	60 minuta
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Me aktivitetet kërkuese dhe punën në grupet e vogla, pjesëmarrësit do të shqyrtojnë perspektiva të ndryshme të lidhura me ndërtimin e monumenteve dhe do të studiojnë situata në të cilat mund të ndodhin diskutime në lidhje me vendime të tilla.
procedura	1. Hyrje dhe shpjegimi i ushtrimit (10 minuta) Ndani pjesëmarrësit në grupe me nga 5 pjesëmarrës dhe çdo grupi jepni një ngjarje historike që duhet të shënojnë në përputhje me dëshirën e shprehur nga Shoqata e viktimave. Lejoni pjesëmarrësit të tërheqin një nga kartat në të cilat janë përcaktuar rolet (kryetar bashkie, historian, aktivist, përfaqësues i Shoqatës së viktimave) dhe shpjegojuni atyre që në nivel grupi duhet të bëjnë një monument që në mënyrën më të mirë të mundshme duhet të reflektojë ngjarjen historike të zgjedhur.

	<p>2. Puna në grupet e vogla (15 minuta) Shpegojuni se çdo grup duhet të mendojë në mënyrë kritike mbi temën kryesore të monumentit dhe realizimin e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vendi i monumentit dhe arsyeet se pse ka zgjedhur atë vend • finansimi • estetika • mesazhi (edukativ, paralajmërues, fajësues, keqardhës etj.) • afrimi me publikun dhe promovimi (si ceremonitë) • grupet e synuara të monumenteve <p>3. Bërja e posterit (15 minuta) Pregatitja e posterit dhe prezantimi i tij para grupit</p> <p>4. Prezantimi i posterit (20 minuta) Pasi secili grup të paraqesë monumentin përkatës, bëni pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si ju lindi ideja për atë monument? • Për çfarë arsye keni zgjedhur atë monument? • A ishte e lehtë apo e vështirë për të arritur në konsensus? <p>Në diskutimin e përgjithshëm mund të fokusoheni në pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cila është arsyeja për kundërshtim në lidhje me ndërtimin e monumentit?
materialet	Lapsa me ngjyra, shënues me ngjyrë, tabelë me letra dhe fletë format A4, kartat e pregatitura me rolet e ndryshme
burimet	Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve: <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: “Shëtitje ndër kujtime (Memory walk). Videoklipët”
literaturë shtesë	Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve: <ul style="list-style-type: none"> • Moduli IV: MonuMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve • v. gjithashtu: Katalogu MonuMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve, dokumenti në format PDF, në DVD, nën titullin “Kujtime në lëvizje” • v. Gjithashtu Udhëzuesi:/ Moduli III/Skenari “Shëtitje ndër kujtime”. (Memory walk) Sarajevë-Mynih. Videoklipët
aktivitete shtesë	Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 4: Këto janë kujtimet e mia/monumentet

moduli II kujtime për monumentet / monumentet e kujtimeve	
	njësia 4
tema	Shënimi i kujtimeve dhe eksplorimi i monumenteve
titulli	Këto janë kujtimet e mia/monumentet
nëntitulli	Historia lokale, historia verbale, historia ime
konteksti	Duke studiuar rëndësinë e monumenteve dhe përmendoreve, pjesëmarrësit do të zbulojnë se ruajtja e kujtimeve paraqet një nga mënyrat e marrjes së përgjegjësive për të kaluarën dhe zgjidhjen e traumave sociale. Ata eksplorojnë rëndësinë e monumenteve si shenjë e kujtimeve shoqërore rreth të shkuarës dhe pranimit të padrejtësive.
tema të ngjashme	Monumentet dhe kujtimet
mesazhet	Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë në mënyrë kritike rolet e kujtimeve historike.
qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> • ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në lidhje me faktin se historia është pjesë e jetës/ rrethit të tyre; futjen e tyre në procesin e eksplorimit të monumenteve; • pjesëmarrësve t’ju mundësohet përfshirja në krijimin e kujtimeve të komunitetit dhe familjes; • inkurajimi i pjesëmarrësve që të paraqesin rezultatet e tyre mbi kujtesën historike me metoda kreative dhe me mjete multimediatike.
Rezultatet e mësimit	Pjesëmarrësit do të bëjnë lidhje informative mes ngjarjeve nga e kaluara dhe pyetjeve më të cilat jetojnë sot, dhe do të shprehën kreativisht në lidhje me kuptimin e historisë. Gjithashtu, do të shohin ndryshimin mes kujtimeve personale dhe historisë zyrtare. Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë në mënyrë kritike rolin që kujtesa historike ka në promovimin e praktikave informative qytetare dhe pjesëmarrëse.
kohëzgjatja	Pregatitja: 1 orë, detyra e shtëpisë: 2 orë, prezantimi përfundimtar: 2 orë
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Duke përdorur metodën e intervistës – strategjia mësimore “e fotove të gjalla” (e cila ngjall imazhe historike) -pjesëmarrësit do të njihen nga afër me memorien historike dhe do të arrijnë të kuptojnë më thellë atë proces, që do të jetë gjithashtu mundësia për praktikuar aftësitë e intervistimit dhe bashkëpunimit me moshatarët e tyre.

procedura

1. Ushtrimi hyrës dhe shikimi i videoklipeve (15 minuta)

Shikoni një nga klipet e materialit “Shëtitje ndër kujtime”. Shpjegojuni pjesëmarrësve që edhe ata do të kalojnë një punë kërkuese të ngjashme. Kërkoni nga pjesëmarrësit të zgjedhin një monument i cili ndodhet afër shtëpisë së tyre. Kërkoni nga ata që të eksplorojnë atë monument (në internet, në bibliotekë), dhe të bëjnë intervista me 1-2 persona, të fotografojnë monumentin dhe personat me të cilët kanë biseduar (nëse është e mundur bashkëbiseduesit të fotografohen afër monumentit) dhe të realizojnë prezantimin.

2. Prgatitja e intervistës (30 minuta)

Kërkoni nga pjesëmarrësit që gjithsecili të kryejë intervista me gojë mbi temën e historisë me prindërit e tyre, me pjesëtarë të tjerë të familjes ose me fqinj të dhe të mbledhin nga ata mendime mbi monumentin. Çfarë ata mendojnë për monumentin?

Realizoni më përpara një pyetësor të vogël me pjesëmarrësit. Si inspirim për pyetjet mund të përdorni transkripte nga klipet filmike të materialit “Shëtitje ndër kujtime”.

** Pjesëmarrësit punojnë në shtëpi në projektin e tyre kërkimor.**

3. Shkëmbimi i gjetjeve: Puna në grupet e vogla (45 minuta)

Pajisni pjesëmarrësit me udhëzues për t'u referuar kur të punojnë në këtë detyrë. Ndani ata në grupe të vogla, me nga 4 deri në 5 pjesëmarrës për grup.

- Shikoni një nga një të gjitha fotografitë dhe shënimet nga intervista dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:
 - Cili është konteksti i këtyre fotografive?
 - Çfarë vini re? Çfarë vini re konkretisht në lidhje me këtë monument? Cilat janë historitë e personave me të cilët keni folur? Cilat janë kujtimet e tyre? Si janë ndjerë kur ju kanë treguar historitë?
 - Çfarë tregon kjo fotografi për monumentin dhe historinë?
- Pasi t'ju përgjigjen pyetjeve për çdo foto, bëni “foton e gjallë” për secilën. “Fotografia e gjallë” gjallëron skenën nga fotoja në jetën reale. Mendoni veten tuaj në rolin e aktorëve të cilët duhet të marrin një pozicion, të bëjnë ndonjë gjest ose shprehje fytyre si personazhet në fotografi. Çdo foto duhet të kishte “producent”, i cili koordinon pjesëmarrësit në skenë. Fotografia duhet të ishte e “ngrirë”, që do të thotë që aktorët duhet të qëndrojnë në një pozicion të caktuar për të paktën 10 sekonda.

- Kur të krijoni foton tuaj të gjallë, vendosni se çfarë prioriteti do të vini në dukje. Pastaj, punoni në atë që grupi juaj të paraqesë foton tek pjesa tjetër e klasës, dhe gradualisht të kalohet nga një foto te tjetra. (Për të theksuar gjëndjen e shprehur në çdo imazh, mund t’i propozoni pjesëmarrësve që të zgjedhin një muzikë e cila do mund të luhet në sfond gjatë prezantimin të tyre.)

4. Prezantimi (30 minuta)

- Grupet prezantojnë punën e tyre te pjesa tjetër e klasës. Grupet në qetësi prezantojnë foton e tyre të gjallë. Ndërkohë që skenat renditen, publiku i interpreton. Pasi çdo grup performon prezantimin e tij, publiku mund të bëjë pyetje. Ndërmjet prezantimeve, pjesëmarrësit mund të marrin shënime se çfarë kanë mësuar për një periudhë historike të caktuar përmes “fotove të gjalla”.

5. Diskutimi plenar, sqarimi dhe rishikimi (45 minuta)

- Sqarim: Pasi grupet bëjnë prezantimin e tyre, mund të hapni debatin me pjesëmarrësit se çfarë kanë mësuar ata më shumë nga intervistat dhe nga prezantimi i “fotove të gjalla” për historinë dhe të tashmen. Pjesëmarrësit mund të kenë interpretime të ndryshme rreth asaj që kanë parë. Inkurajoni ata që interpretimet e tyre t’i mbrojnë me fakte dhe ftoni ata që të ndryshojnë interpretimet e tyre pasi të dëgjojnë dhe idetë e moshatarëve të tyre.
- Diskutimi:
 - Kur merrni në konsideratë të gjithë monumentet/tregimet që janë prezantuar, a mendoni që i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme luftës në këtë vend? Pse / Pse jo?
 - Ku qëndron ndryshimi mes kujtimeve personale dhe historisë zyrtare?
 - A mendoni që ndonjë monument /histori mungon?
 - A keni ndonjë propozim të ri për monumente?
- Reflektimi kritik: Kërkoni nga pjesëmarrësit të shkruajnë ose të shkëmbejnë eksperiencat e tyre personale në lidhje me drejtimin e intervistave dhe pjesëmarrjes në ushtrimin “fotot e gjalla” në mënyrë që të adresohen pyetjet e mëposhtme:
 - Nëse do të mund të bënit përsëri këtë aktivitet, çfarë do të bënit në të njëjtën mënyrë? Cilën pjesë do të donit të bënit ndryshe ose që grupi t’a bënte ndryshe?
 - Çfarë keni mësuar nga këto aktivitete në lidhje me të punuarit me njerëz të tjerë?
 - Cila ka qënë pjesa më e lehtë e këtyre aktiviteteve? Dhe cila pjesë ka qënë më e vështira?

materiali

Telefona smart dhe laptopë, projektues dhe ekran, videoklipet nga materiali Manuali:/Moduli III/skenari “Shëtitje ndër kujtime” (Memory walk. Sarajevë – Mynih.

burimet	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: “Shëtitje ndër kujtime. (Memory walk). Sarajevë – Mynih Videoklipët”
literaturë shtesë	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli I-IV në përgjithësi dhe në veçanti • Moduli II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 2: Çfarë është monumenti? <p>Faqja e internetit Ballafaqim me të shkuarën – faqja edukative e internetit e cila frymëzon dhe ofron më shumë përgatitje për mësimet (siç janë “trashëgimia monumentale e luftës së Vietnamit ose “hulumtimet historike e të drejtave të njeriut” ose “Emmet Till zgjedh për të kujtuar”</p> <p>www.facinghistory.org (e disponueshme vetëm në gjuhën angleze)</p>
aktivitete shtesë	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: “Kujtime për monumentet/ Monumentet e kujtimeve”/ Njësia 5: Monumenti im ideal; • Moduli II: “Kujtime për monumentet/ Monumentet e kujtimeve”/ Njësia 3: Muzeu i historisë.

moduli II Kujtime për monumentet / monumentet e kujtimeve	
	njësia 5
tema	Perceptime personale dhe përgjegjësitë
titulli	Monumenti im ideal
nëntitulli	Hulumtimi i perspektivës personale rreth të shkuarës
konteksti	Çfarë është e nevojshme që dikush të angazhohet për një ide të caktuar? Çfarë roli ka arti në hapësirën publike për të krijuar kujtimin e grupit? Pse disa njerëz vendosin të marrin masa të caktuara për të korrigjuar disa gjëra, ndërsa të tjerët qëndrojnë në anë dhe shohin? Ky leksion fton pjesëmarrësit të shprehin qëndrimin e tyre mbi monumentet dhe procesin e përkujtimit, dhe të marrin në konsideratë se si këto shembuj reflektojnë në jetët e tyre. Nga pjesëmarrësit kërkohet që të vënë re simbolikën pas monumentit të tyre ideal dhe të jenë guximtar në paraqitjen e ideve të tyre dhe në mbrojtjen e pikëpamjeve të tyre.
tema të ngjashme	Videoklipët nga materialët e titulluar “Shëtitje ndër kujtime” (Memory walk). Sarajevë – Mynih, monumentet dhe kujtimet, veprimtari kreative
mesazhet	Me anë të kërkimit dhe shprehjes kreative, pjesëmarrësit do të prezantojnë monumentin e tyre ideal dhe do t’a lidhin atë me rolin e tyre dhe përgjegjësitë në krijimin e historisë.
qëllimet	Të menduarit kreativisht mbi vizionet e ndryshme dhe mesazhet e monumentit dhe krijimi i atmosferës kreative për vetë-shprehje dhe diskutim kritik në grup.
Rezultatet e mësimimit	Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë rolin e tyre dhe përgjegjësitë në shoqëri. Pjesëmarrësit do të ndërgjegjësohen që dhe ata kanë të drejtë të ndikojnë në formimin e kulturës publike të përkujtimit. Pjesëmarrësit do të kuptojnë se sa e rëndësishme është të njihin guximin e dikujt që mbron idenë e tij.
kohëzgjatja	120 minuta
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Me anë të aktiviteteve individuale dhe grupore, pjesëmarrësit do të punojnë në analizën kritike të monumentit dhe do të ri-shqyrtojnë interpretimin e tyre në lidhje me monumentet
procedura	1. Hyrje dhe prezantimi i videoklipeve nga materiali “Shëtitje ndër kujtime” (në DVD Kujtime në lëvizje”) (30 minuta) Shfaqja e 2-3 klipeve filmike nga materiali “Shëtitje ndër kujtime” i cili tregon konfliktin/luftën e caktuar, që pjesëmarrësit kanë përgatitur dhe pastaj kërkoni nga ata që të analizojnë ndryshimet në kuadrin e estetikës dhe mesazheve. Si duket monumenti dhe kujtimi për të cilin është ngritur?

	<p>(Përpiquni të zgjidhni lloje të ndryshme monumentesh – nga lufta e dytë botërore ose nga ndonjë formë tjetër konflikti në mënyrë që të theksoni ndryshimin.)</p> <p>2. Puna individuale (30 minuta)</p> <p>Çdo pjesëmarrësi jepini nga një fletë të madhe letre dhe kërkoni nga ata të vizatojnë, skicojnë ose të shkruajnë (si alternativë mund të përdorni plastelinën) se si mund të dukej monumenti i tyre ideal (sikur të kishin të gjitha paratë e duhura në dispozicion). Mund të behet fjalë ose për përmirësim të ndonjë monumenti ekzistues ose për ngritjen e ndonjë monumenti të ri – le të zgjedhin vetë për ngjarjen historike ose për personin që duan t’ia dedikojnë.</p> <p>3. Galeria e posterave dhe prezantimi (30 minuta)</p> <p>Vendosni të gjithë posterat (ose monumentet e bërë nga plastelina) në mur dhe krijoni galerinë e posterave/monumenteve. Inkurajoni pjesëmarrësit që punët e tyre ti prezantojnë grupit. Personit që bën prezantimin e monumentit përkatës, bëjini pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pse keni zgjedhur atë ngjarje historike ose atë person? • Cili është mesazhi që doni të përcillni me këtë monument? <p>4. Diskutimi plenar (30 minuta)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si ishte të punonit për këtë aktivitet? • Çfarë zgjedhesh keni bërë dhe pse? • Cilat janë ndryshimet dhe ngjashmëritë (në formë, mesazh, vend, dizajn) që vini re kur shikoni monumente të ndryshme? • A mendoni ju, si person i ri në moshë, që duhet të keni influencë në monumentet që ndërtohen? Pse /pse jo?
materiale	Tabela me fletët e letrave, letra me ngjyra, lapsa me ngjyra, plastelinë.
burime	“Shëtitje ndër kujtime” (Memory walk). Sarajevë – Mynih. Videoklipët
literaturë shtesë	Katalogu MONUMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve, dokumenti në format PDF, në DVD “Kujtime në lëvizje”
aktivitete shtesë	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime.: Sarajevë – Mynih. Videoklipët/Njësia 6: Një monument – dhjetë mendime dhe Njësia 7: Njësia 7: Heronjtë – historia e rezistencës.



1929 Grgur Ninski Monument, Split, Croatia

moduli III memory walk (shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. videoklipët	
	njësia 6
tema	Vizionet e përkujtimit dhe tregimet historike
titulli	Një monument, dhjetë mendime
nëntitulli	Studimi i vizioneve të diskutueshme mbi monumentet
konteksti	<p>Shëtitje ndër kujtime është një trajnim edukativ filmik që u ofron të rinjve mundësinë që të njihen me mënyrat se si historia dhe kujtimet e luftës dhe të konfliktit shndërrohen në monumente, domethënë se si përdoren dhe keqpërdoren në hapësirën publike. Gjatë trajnimit pesë-ditor, të rinjtë inkurajohen të mendojnë në mënyrë kritike mbi procesin e përkujtimit dhe të shqyrtojnë se sa vende përkujtimoresh janë relevante, domethënë se sa është e diskutueshme natyra e tyre për ata dhe për komunitetet e tyre në shoqërinë e sotme.</p> <p>Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit kanë punuar së bashku për të studiuar klipet e filmit të shkurtër rreth monumentit konkret, duke eksploruar arsyet e krijimit të tij, rolin e tij në shënimin shoqëror, mosmarrëveshjet dhe polemikat e mundshme rreth monumentit, si dhe perceptimi i rëndësisë së atij monumenti në kontekstin e të shkuarës, të sotshmes dhe të ardhmes.</p> <p>Në vitin 2013, një grup prej 12 personash nga qytetet fqinjë të Bosnje dhe Hercegovinës, nga Sarajeva dhe Sarajeva Lindore, u mbledhën rreth idesë që në komunitetet e tyre të eksplorojnë dhe të regjistrojnë me kamer monumentet e Luftë së Dytë Botërore dhe ato të vitit 1992 deri në vitin 1995. Ndërsa në vitin 2014, rreth 20 pjesëmarrës nga Bosnja dhe Hercegovina u mbledhën në Mynih të Gjermanisë për të eksploruar monumentet nga Lufta e Dytë Botërore.</p> <p>Ky trajnim është një përpjekje për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme: A keni menduar ndonjëherë se kush i ka ndërtuar dhe pse i ka ndërtuar monumentet në qytetin tuaj? Cilët janë mesazhet që këto monumente përcjellin për të kaluarën (dhe për të ardhmen)? A mungon ndonjë monument në qytetin tuaj? Sipas mendimit tuaj, si mund të ishte monumenti ideal?</p>

	Ditën e parë të trajnimit, pjesëmarrësit degjuan një leksion dhe së bashku me lektorët, ekspertët, aktivistët dhe dëshmitarët okularë bënë ushtrime praktike që kishin lidhje me përkujtimin. Ditën e dytë ata vizituan disa lokalitete përkujtimore dhe filluan punën e tyre kërkimore për monumentet. Ditën e tretë intervistuan kalimtarët e rastësishëm në rrugë dhe filmuan mendimet e tyre me kamer. Ditën e katërt montuan materialin e filmuar me ndihmën e redaktorëve profesionistë dhe realizuan videoklipin pesëminutësh. Ditën e pestë të trajnimit, prezantuan punën e tyre në kontekstin e projeksonit publik dhe u realizua ceremonia mbyllëse.
tema të ngjashme	Shqyrtimi kritik, përgjegjësia personale
mesazhet	Çfarë rëndësie kanë monumentet për mua dhe për të tjerët?
qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> • rritja e perceptimit multiperspektiv të kujtimit; • shqyrtimin e mendimit personal në lidhje me monumentet; • konsiderimin e rëndësisë së mundshme të përkujtimit.
Rezultatet e mësimit	<p>Pjesëmarrësit do të zbulojnë mendime të ndryshme rreth monumentit dhe do të jenë në gjendje ti kategorizojnë ato.</p> <p>Pjesëmarrësit do të kuptojnë që qëndrimi i dikujt mund të ketë ndikim në mënyrën se si monumenti përjetohet.</p> <p>Pjesëmarrësit do të bëjnë gjykimin e tyre në lidhje me monumentet.</p> <p>Pjesëmarrësit do të mendojnë në mënyrë kritike mbi rëndësinë e përkujtimit.</p>
kohëzgjatja	90 minuta
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Analiza e klipit filmik nga këndvështrime të ndryshme dhe inkurajimi i pjesëmarrësve të shprehin mendimet e tyre
procedura	<p>1. Hyrje dhe shikimi i klipit filmik (10 minuta)</p> <p>Shfaqja e videoklipeve të dëshiruara dhe shpjegimi për pjesëmarrësit që duhet të kushtojnë vëmendje të veçantë në lidhje me qëndrimet e ndryshme dhe opinionet e shprehura në ato videoklipe</p> <p>2. Puna kërkuese në grupet e vogla (10 minuta)</p> <p>Kërkoni nga pjesëmarrësit që në çifte të shtrojnë pyetje, në lidhje me klipin filmik, për të cilat duan të marrin përgjigje përpara se të fillojnë të interpretojnë klipin.</p> <p>Shkruani në tabelë: Dëshiroj të di...</p> <p>Po pyesja veten...</p>

3. Transferimi i njohurive mbi monumentin (10 minuta)

Brenda grupit konsideroni pyetje të caktuara, të mëposhtmet në veçanti:

- Çfarë mendoni – cili ka qënë qëllimi i monumentit dhe cili është mesazhi i tij?
- Në cilin vend ndodhet monumenti dhe çfarë dizajni ka?
- Cila është audienca e synuar?

4. Puna në grupet e vogla për një interpretim konkret (20 minuta)

Ndani grupin në grupe të vogla, nga 4 deri në 6 pjesëmarrës në secilin grup. Çdo pjesëmarrësi në grup, jepini një rol të caktuar, si për shembull:

- rol civil që ka përjetuar personalisht luftën;
- rol veteran i cili ka luftuar në luftë;
- turist i cili sapo ka mbërritur në qytet dhe që kalon afër monumentit;
- fqinji i cili jeton afër monumentit;
- aktivist i cili është kundër monumentit;
- artist që ka bërë monumentin.

Pjesëmarrësit duhet t'ju përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, të parë nga këndvështrimi i tyre: “Cili është mendimi im për këtë monument”

Pjesëmarrësit duhet të jenë kreativë dhe të përdorin imagjinatën e tyre por gjithashtu mund të frymëzohen nga transkriptet dhe videoklipet. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të prezantojnë gjetjet e tyre në kohëzgjatjen prej një minute.

5. Prezantimi i gjetjeve (10 minuta)

Çdo grup prezanton shkurtimisht rezultatet e veta.

6. Diskutimi i përgjithshëm (30 minuta)

- Cilat janë arsyet e mendimeve të ndryshme?
Mendoni për distancën kohore/fizike në lidhje me temën dhe interesat e ndryshme.
- Cilat opinione nuk keni dëgjuar në prezantime dhe në videoklipe?
Mendoni për njerëzit që kanë strategji e cila është e orientuar nga e ardhmja ose për ata të cilët përdorin strategjinë e mohimit, si politikanët të cilët përpiqen të fshehin histori të caktuara, ose për të rinjtë të cilët nuk ndjejnë asnjë lidhje me historinë.
- A kanë të rinjtë, në përgjithësi, mendim rreth monumenteve? A duhet ata të kenë mendim rreth kësaj teme?
- Cili është mendimi juaj për këtë monument?
- A mendoni që monumentet dhe përkujtimoret janë të rëndësishëm dhe pse?

materiale	Klipet filmike, kartat me opinione të ndryshme, lapsat dhe letrat
burime	Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik rreth kulturës së kujtimeve: <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime). Sarajevë – Mynih. Videoklipët • Udhëzues / Moduli III/ skenari i materialit: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë-Mynih. Videoklipët, autor Wouter Reitsema
literaturë shtesë	Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve: <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipët • Udhëzues / Moduli III/ skenari i materialit: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipët • Katalogu “MONUMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve”, dokumenti në format PDF, në DVD i titulluar “Kujtime në lëvizje”.
aktivitete shtesë	Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve: <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 5: Monumenti im ideal; • Moduli II: “Kujtime për monumentet / Monumentet e kujtimeve” – Njësia 3: Muzeu i kujtimeve; • Moduli IV: “MONUMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve” – Njësia 8 • Moduli V: “Kujtime në lëvizje. MonuMENTImotion.Film i shkurtër / Njësia 9

moduli III memory walk (shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. videoklipët	
	njësia 7
tema	Shqyrtimi kritik rreth roleve të ndryshme dhe përgjegjësive në kontekstin e padrejtësisë
titulli	Heronjtë? Historia e rezistencës
nëntitulli	Strategji të ndryshme të rezistencës kundrejt padrejtësisë
konteksti	<p>Shëtitja ndër kujtime është një trajnim edukativ filmik që u ofron të rinjve mundësinë që të njihen me mënyrat se si historia dhe kujtimet e luftës dhe të konfliktit shndërrohen në monumente, domethënë se si përdoren dhe keqpërdoren në hapësirën publike. Gjatë trajnimit pesë-ditor, të rinjtë inkurajohen të mendojnë në mënyrë kritike mbi procesin e përkujtimit dhe të shqyrtojnë se sa vende përkujtimoresh janë relevante, domethënë se sa është e diskutueshme natyra e tyre për ata dhe për komunitetet e tyre në shoqërinë e sotme.</p> <p>Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit kanë punuar së bashku për të studiuar klipet e filmit të shkurtër rreth monumentit konkret, duke eksploruar arsyet e krijimit të tij, rolin e tij në shënimin shoqëror, mosmarrëveshjet dhe polemikat e mundshme rreth monumentit, si dhe perceptimi i rëndësisë së atij monumenti në kontekstin e të shkuarës, të sotshmes dhe të ardhmes.</p> <p>Në vitin 2013, një grup prej 12 personash nga qytetet fqinjë të Bosnje dhe Hercegovines, nga Sarajeva dhe Sarajeva Lindore, u mbledhën rreth idesë që në komunitetet e tyre të eksplorojnë dhe të regjistrojnë me kamer monumentet e Luftës së Dytë Botërore dhe ato të vitit 1992 deri në vitin 1995. Ndërsa në vitin 2014, rreth 20 pjesëmarrës nga Bosnja dhe Hercegovina u mbledhën në Mynih të Gjermanisë për të eksploruar monumentet nga Lufta e Dytë Botërore.</p> <p>Ky trajnim është një përpjekje për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme: A keni menduar ndonjëherë se kush i ka ndërtuar monumentet në qytetin tuaj dhe pse i ka ndërtuar ato? Cilat janë mesazhet që këto monumente përcjellin për të kaluarën (dhe për të ardhmen)? A mungon ndonjë monument në qytetin tuaj? Sipas mendimit tuaj, si mund të ishte monumenti ideal?</p>

	<p>Ditën e parë të trajnimit, pjesëmarrësit degjuan një leksion dhe së bashku me lektorët, ekspertët, aktivistët dhe dëshmitarët okularë bënë ushtrime praktike që kishin lidhje me përkujtimin. Ditën e dytë ata vizituan disa lokalitete përkujtimore dhe filluan punën e tyre kërkimore për monumentet. Ditën e tretë intervistuan kalimtarët e rastësishëm në rrugë dhe filmuan mendimet e tyre me kamër. Ditën e katërt montuan materialin e filmuar me ndihmën e redaktorëve profesionistë dhe realizuan videoklipin pesëminutësh. Ditën e pestë të trajnimit, prezantuan punën e tyre në kontekstin e projeksionit publik dhe u realizua ceremonia mbyllëse.</p>
tema të ngjashme	Heroizëm, rezistencë, lufta kundër padrejtësisë, përgjegjësia për të marrë qëndrim
mesazhet	Cilat janë strategjitë e ndryshme dhe pengesat në rrugën e luftës kundër padrejtësisë? Cila është përgjegjësia individuale në luftën kundër padrejtësisë?
qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> • rritjen e “multiperspektivave” mbi temat e heroizmit dhe rezistencës; • ndërgjegjësimin e individëve për mundësinë e shprehjes së rezistencës.
Rezultatet e mësimit	<p>Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të identifikojnë role të ndryshme të cilat individ mund ti ketë gjatë konfliktit dhe të kuptojnë se atë role nuk janë asnjëherë fikse.</p> <p>Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të identifikojnë forma të ndryshme të rezistencës dhe të konsiderojnë natyrën e tyre të diskutueshme.</p> <p>Pjesëmarrësit do të kuptojnë që historinë e bëjnë historitë individuale dhe që veprimet individuale janë shumë të rëndësishme.</p> <p>Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike mbi përgjegjësitë personale për kundërshtimin e padrejtësisë.</p>
kohëzgjatja	180 minuta
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Ndërmjet historisë personale për format e ndryshme të rezistencës dhe pas shikimit të tre videoklipeve nga materiali “Shëtitje ndër kujtime” nga Mynihu, pjesëmarrësit do të njihen me format e ndryshme të rezistencës. Pjesëmarrësit do të prezantojnë gjetjet e tyre reth atyre historive personale dhe do të bashkëbisedojnë për idetë e tyre.

1. Hyrje dhe mbledhje e rastësishme e ideve (20 minuta)

- Kërkoni nga pjesëmarrësit që në mënyrë të rastësishme të japin ide në lidhje me faktin se çfarë rolesh mund të ketë individi gjatë konfliktit, ndërsa ju shkruani në tabelë. Kujdesuni që në listë të ketë terma të tilla si viktimë, autor krimi, “anëtar i rezistencës”. Pyesni pjesëmarrësit nëse është e mundur që individët të ndryshojnë rolet dhe nëse një individ mund të ketë më shumë se dy role në të njëjtën kohë, duke i’u kujtuar atyre ushtrimin e identitetit: personi mund të ketë identitet të shumëfishtë, mund të bëjë zgjedhje të ndryshme në momente të ndryshme, si dhe rolet asnjëherë nuk janë fikse.
- Kaloni në temën e rezistencës dhe kërkoni nga pjesëmarrësit që në mënyrë spontane të përmendin strategji të ndryshme/ forma të rezistencës që ju vijnë në mendje dhe shkruajini në tabelë. Inkurajoni ata të eksplorojnë format kreative/shpirtërore më të zakonshme: si shkrimi, demonstrimi, shkrimi i muzikës, luftimi, shpëtimi, shpërndarja e mallrave... Në fund, pyesni pjesëmarrësit cilat pengesa të rezistencës mund të ndjejnë.

2. Shfaqja e klipeve filmike (20 minuta)

Shpegoni kontekstin e klipeve filmike dhe shpjegoni që do të shfaqni klipet që flasin për rezistencën. Shikoni me pjesëmarrësit tre klipe filmike nga materiali “Shëtitje ndër kujtime” nga Mynihu, dhe pastaj kërkoni nga pjesëmarrësit që secili të shkruajë në letër, format e strategjisë së rezistencës që mban mend.

3. Puna në grupet e vogla (30 minuta)

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkoni që për çdo person që kanë parë në klipet filmike (të anketuarit: Sophie Scholl, Georg Elser, kalimtari anonim në rrugën Dodger) t’ju përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, dhe ato përgjigje ngjitini në poster:

- Kush jam unë?
- Pse kam reaguar (kundër padrejtësisë)?
- Cilën strategji rezistence kam përdorur?
- Çfarë kam rrezikuar?
- Cili ka qënë reagimi për punën time?

Grupet mund të përdorin si burim transkriptet nga filmat, dokumentet në format PDF të cilat flasin për përkujtimoret e Mynihut (shiko burimin).

4. Prezantimi (30 minuta)

Kërkoni nga çdo grup të prezantojë gjetjet përkatëse. Si moderator, në tabelë mund shtoni strategjitë e “reja” që ka eksploruar grupi.

5. Diskutimi plenar (20 minuta)

Gjatë diskutimit plenar konsideroni pyetjet e mëposhtme:

- Rreth Sophie Scholl: A ishte rastësi që Hans dhe Sophie Scholl ishin studentë të rinj? Këtu mund të flisni për reziqet që janë karakteristike për rezistencën (frika për jetën dhe jetën e familjes) dhe të pyesni pjesëmarrësit rreth arsyeve të ndryshme se pse njerëzit rezistojnë ose nuk rezistojnë.
Çfarë përgjegjësie ka individi ndaj shoqërisë? Ndaj familjes së tij? Besimeve personale? Komunitetit? Komunitetit fetar? Popullit? Të bësh gjënë e duhur edhe kur kjo nënkupton ndërmarrjen e reziqe të mëdha dhe pasojave të tmerrshme?
- Rreth rrugës Dodger: Pse është kjo formë rezistence ndryshe nga ajo që ka treguar Sophie Scholl? Dhe pse disa njerëz nuk e quajnë këtë rezistencë? Mund të konsideroni forma të ndryshme të rezistencës: ata njerëz që kanë përdorur rrugicën e pasme jo domosdoshmërisht kanë ndihmuar njerëzit e tjerë, por ata kanë shprehur protestën e tyre ndaj sistemit. Mendoni rreth arsyeve të tjera, përveç rezistencës, që këta persona kanë përdorur rrugën e pasme.
- Rreth Georg Elser: A janë “anëtarët e rezistencës” gjithmonë heronj? A mund të konsiderohet Georg Elser hero? Shqyrtoni rolin e shumëfishtë që një person mund të ketë: si “anëtar i rezistencës” dhe në të njëjtën kohë mund të jetë dhe autor i krimit.
- Në përgjithësi I: Shkruani në tabelë deklaratën e mëposhtme dhe kërkonte nga pjesëmarrësit që t’ju thonë, në bazë të gjetjeve të tyre, a janë dakort apo jo me atë deklaratë: “Ata kanë qënë njerëz krejtësisht të thjeshtë të cilët kanë shfrytëzuar rrethanat e zakonshme për të bërë diçka të jashtëzakonshme.” (Matthias Heyl, pedagog i lartë, Ravensbrück Memorial Site). Shqyrtoni me pjesëmarrësit rëndësinë e veprimit individual dhe sa ndikim individi mund të ketë.
- Në përgjithësi II: Shqyrtoni eksperiencat e pjesëmarrësve në lidhje me rezistencën përmes pyetjeve të mëposhtme:
Çfarë mund të bëni ju si individ për të ndryshuar situatën? A jeni ngritur ndonjëherë kundër padrejtësisë (psh. Kundër sjelljes së dhunshme, krimeve të vogla) dhe nëse po, si jeni ndjerë?
Nga çfarë lloj reziqesh jeni ekspozuar? Si kanë qënë reagimet?

materiale

Tabelë me letra, projektues, klipet filmike nga materiali “Shëtitje ndër kujtime”, lapsa dhe letër, klipet filmike të transkriptuara.

burime

Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:

- Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipet/Mynih”

<p>literaturë shtesë</p>	<p>Në materialin “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime). Videoklipët; për më shumë informacione bazë mbi monumentet shikoni skenarin e videoklipeve nga materiali Manuali/ Moduli III/ skenari <p>INë materialin “Vendet e kujtimeve dhe përkujtimeve”, të cilat janë temat bazë historike (ThemenGeschichtspfade)si pjesë e serisë “Stazekulturnehistorije” (rrugët e historisë kulturore) (KulturGeschichtspfade) në publikimin Qyteti i Mynihut, i cili përmban monumente nga videoklipet e materialit “Shëtitje ndër kujtime” nga Mynihu, i cili përmban më shumë informacione rreth kulturës publike të kujtimeve në Mynih: http://www.ns-dokumentationszentrum-muenchen.de/bildungsangebote/tgp-ns/tgpremembrance.pdf</p> <p>Pregatitja për leksion është marrë nga faqja e Muzeut Përkujtimor të Holokaustit të SHBA (United States Holocaust Memorial Museum - USHMM) “Përgjegjësia individuale dhe rezistenca gjatë holokaustit”: http://www.ushmm.org/educators/lesson-plans/individual</p>
<p>aktivitete shtesë</p>	<p>Propozim për veprimtarinë shtesë (90 minuta)</p> <p>“Rezistenca në shoqërinë e sotme”</p> <p>Qëllimi: Kërkoni nga pjesëmarrësit të identifikojnë rastet e padrejtësive në shoqëritë e tyre dhe të eksplorojnë strategjitë e shprehjes së rezistencës kundër padrejtësive të tilla. Ky aktivitet i shtohet aktivitetit kryesor.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpjegoni ushtrimin dhe paraqitni artikuj nga gazetatat lokale dhe kombëtare në të cilat flitet për forma të ndryshme të shtypjes/ diskriminimit/ padrejtësisë në shoqërinë e sotme. (10 minuta) 2. Kërkoni nga pjesëmarrësit të studiojnë këto raste gazetash dhe të tregojnë listën e shtypjes. Nëse pjesëmarrësit kanë njohuri të caktuara për të drejtat e njeriut, kërkoni nga ata që të përmendin se cilat nga të drejtat e njeriut në këto raste është dhunuar (30 minuta) 3. Kërkoni nga pjesëmarrësit të pregatisin një prezantim duke përfshirë shqyrtimin kritik ne lidhje me “çfarë duhej apo çfarë duhet bërë për t’u ngritur kundër një shtypjeje të tillë?” (20 minuta) 4. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të ndajnë me grupin gjetjet e tyre dhe shkruani në tabelë, strategjitë që përmendin pjesëmarrësit. (30 minuta)

skenari

Autor Wouter Reitsema, Shtëpia Anne Frank (Hollandë)

I. “Shëtitje ndër kujtime” (Memory Walk) - Sarajevë & Sarajevë Lindore

Në periudhën nga 12 deri më 17 gusht të vitit 2013, nën organizimin e shtëpisë Ane Frank nga Holanda dhe Iniciativës së të rinjve për të drejtat e njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe në bashkëpunim me organizatën Humanity in Action (Njerëzimi në veprim), u mbajt trajnimi filmik i titulluar “Memory Walk” (Shëtitje ndër kujtime) në qytetet fqinjë të Bosnje dhe Hercegovinës, Sarajevë dhe Sarajevë Lindore. Gjatë 5 ditëve, 12 pjesëmarrës – që erdhën nga mjedise dhe pjesë të ndryshme të të dy qyteteve - patën rastin të vizitojnë së bashku monumente në mjedisin e tyre të afërt në mënyrë që të eksploronin, dokumentonin dhe të njiheshin nga afër – me monumentet prej guri që janë shpesh konkurreuese ndërmjet tyre, të cilët janë ndërtuar në kujtim të të rënëve në Luftën e Dytë Botërore dhe në luftën e fundit të viteve 1990-t.

Trajnimi u hap me leksionin e ekspertëve të përfshirë në procesin përkujtimor dhe ishte i mbushur me ushtrime krijuese. Leksioni frymëzues dhe diskutimet vendosën kujtimin publik në Bosnje dhe Hercegovinë në kontekstin europian, fokusuan vëmendjen e pjesëmarrësve në lidhjen e vendeve të përkujtimeve kontradiktore si rrjedhojë e raportimit të njëanshëm, dhe mësuuan pjesëmarrësit se si të “lexonin” monumentet nga këndvështrime të ndryshme. Folësit e ftuar në mënyrë frymëzuese paraqitën marrëdhënien e tyre aktive ndaj mënyrave përkujtime alternative. Përveç se paraqitën mendimet e tyre mbi prezantimin e të shkuarës dhe të tashmes, ata gjatë asaj dite trajnimi, prekën dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Dita tjetër vazhdoi me vizitimin e monumenteve në dy qytetet me ndihmën e drejtuesit. Me vizitimin e monumenteve në Sarajevë dhe në Sarajevën Lindore, shumë pjesëmarrës patën rastin unik që të vizitonin pjesë të vendit të tyre që deri në atë moment nuk i kishin vizituar dhe gjithashtu të bisedonin ndërmjet tyre rreth historive dhe monumenteve për të cilët nuk kanë pasur rastin të flasin në shkollë ose në shtëpi. Pastaj pjesëmarrësve i'u dha detyra që të zgjidhnin një monument dhe rreth tij të bënin një film të shkurtër. Pas studimit të detajuar të monumentit të zgjedhur dhe mësimin rreth bazave të intervistimit dhe regjistrimit, pjesëmarrësit filluan me regjistrimin e materialeve për filmat. Ata hulumtuan histori që kishin lidhje me monumentet, ndërsa vëzhgimet e qytetarëve u regjistruan me anë të intervistave. Gjatë ditës që i ishte dedikuar redaktimit të materialit të regjistruar, pjesëmarrësit me ndihmën e redaktorit profesionist bënë redaktimin e materialeve të videove të tyre. Gjatë ditës së fundit, në kinemanë Kriterion në Sarajevë, në kuadrin e programit vjetor të Festivalit të Filmit, kineastët e rinj me krenari prezantuan videot e tyre me anë të shfaqjeve publike në kuadër të të cilave u mbajt dhe një panel diskutimi.

Filmat janë të disponueshëm në Youtube dhe DVD, në gjuhën angleze, gjermane, boshnjake/kroate/serbe. Trajnimi u financua nga Humanity in Action, Ambasada Gjermane, Austriake dhe Italiane në BeH dhe nga programi Vullnetar i Shteteve të Bashkuara.

- Monumenti i Milan Simoviç është ngritur si shenjë kujtimi për partizanin Milan Simoviç, heroin kombëtar të Jugosllavisë socialiste, në Pale, pjesë e Sarajevës Lindore. Urdhëri i heroit kombëtar ishte dekorimi i dytë më i lartë ushtarak që është dhënë gjatë Jugosllavisë për vepra të jashtëzakonshme heroike. Simoviçit i është dhënë ky status si komandant i trupave të kalorësisë së detashmentit partizan të Romanijës gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjatë betejës pesëmuajore, në të cilën mori pjesë personalisht dhe ishte në rreshtat e parë, organizoi prishjen e hekurudhës Sarajevë – Vishegrad dhe në atë mënyrë i'u kufizoi mundësitë për më shumë se 10 muaj. U vra nga lëvizja fashiste e ustashëve.
- Parku përkujtimor Vraca u ngrit në vendin ku ishte dikur kalaja Austro-Hungareze. Ngritja e tij u bë me urdhër të presidentit të ish Jugosllavisë Josip Broz Tito (1892-1980) në vitin 1980. Parku përkujtimor Vraca paraqet monumentin e viktimave të lëvizjes partizane të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe gjatë kohës së ish Jugosllavisë kishte një funksion të rëndësishëm rekreativ. Gjatë rrethimit të Sarajevës (1992-1995), parku përkujtimor Vraca u përdor nga forcat ushtarake serbe të Bosnjes si pikë e rëndësishme strategjike për të sulmuar qytetin i cili shtrihet në luginë poshtë këtij monumenti. Nga të njëjtat forca, monumenti është pjesërisht i dëmtuar gjatë tërheqjes në vitin 1996. Edhe pse gjatë vitit 2005 është shpallur si monument kombëtar i Bosnje dhe Hercegovinës, parku përkujtimor Vraca është ende një vend i braktisur në kufirin mes dy qyteteve fqinje, Sarajevë dhe Sarajevë Lindore, i vendosur në dy entitete të ndryshme të shtetit, Federata e Bosnje dhe Hercegovinës dhe Republika Srpska në BeH.
- “Trëndafilat e Sarajevës” janë shenja në beton të cilat janë krijuar nga shpërthimi i granatave, të cilat më vonë janë mbushur me bojë të kuqe. “Trëndafilat” përfaqësojnë kujtimin për të rënë gjatë rrethimit të të Sarajevës (1992-1995). Nuk është e ditur se kur ka filluar mbushja me ngjyrë të kuqe e dëmtimeve në asfalt, por qytetarët dhe aktivistët për vite me rradhë ruajnë dhe tregojnë rëndësinë e këtyre shenjave-përkujtimore. Autoritetet e bashkisë që nga viti 2013 kanë filluar zyrtarisht ti mbrojnë këto shenja. “Trëndafilat e Sarajevës” janë anonime dhe ende nuk është e shpjeguar se përse ato përfaqësojnë simbolet e të gjitha viktimave të rëna gjatë luftës sepse sot nuk i përfshijnë të gjithë banorët e Sarajevës si të tyre, ndërsa shumë turistë kalojnë afër tyre dhe nuk i vënë re.

II. “Shëtitje ndër kujtime” në Mynih

Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Shtëpia e Ane Frank dhe Gjimnazi Staatliches-Karolinen në Rosenheim, në periudhën nga 5 deri më 11 korrik 2014, organizuan një seminar filmik të titulluar “Memory Walk” në Mynih, Gjermani. Gjatë pesë ditëve, 21 pjesëmarrës nga Bosnja dhe

Gjermania, patën mundësinë që së bashku të vizitojnë monumente në mjedisin e tyre të afërt, në mënyrë që të eksploronin, dokumentonin dhe të njiheshin nga afër me monumentet e ngurosurat - që janë shpesh konkurruese ndërmjet tyre- të ngritur në kujtim të të rënëve në Luftën e Dytë Botërore.

Pjesëmarrësit e seminarit bashkëbiseduan intensivisht mbi trashëgiminë e Luftës së Dytë Botërore në Gjermani, qëndrimin problematik dhe të diskutueshëm të autoriteteve të Mynihut në lidhje me ish ndërtesat nacistike dhe gjithashtu u njohën nga afër me monumentet e grupeve të ndryshme të viktimave dhe të lëvizjeve të rezistencës- me ndihmën e ekspertëve lokale dhe aktivistëve nga Mynihu dhe nga afërsia e Dachau. Përveç vizitimit të “zakonshëm” të monumenteve, të rinjtë gjithashtu hulumtuan çështjet e lidhura me monumentin Stolpersteine, i cili nuk ekziston ende në qytet. Dhe ndërsa ky “gur i pengesës” është ende i ndaluar në Mynih, pjesëtarët e grupit gjatë shetitjes në qytet përdorën aplikimin në telefonët e tyre “smart” në mënyrë që të njiheshin me biografitë e viktimave të përndjekura. Pavarësisht nga koha me shi, pjesëmarrësit ishin shumë të motivuar që me anë të intervistimit të njerëzve në rrugë të mësonin më shumë rreth këndvështrimeve të tyre për monumentet, dhe së bashku punuan shumë për rregjistrimin e tre materialeve filmike. Për shkak të ndryshimeve kulturore të lidhura me mjediset nga vijnë, shkëmbimi i ideve ishte sfidues, por edhe i dobishëm, sepse pjesëmarrësit nga Gjermania nuk kishin shumë njohuri rreth historisë së luftës në Bosnje që akoma paraqet një barrë të rëndë mbi krahët e qytetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës. Rezultati përfundimtar i seminarit u tregua dy herë me anë të shfaqjeve publike: një herë në Mynih dhe një herë në Sarajevë. Në Mynih, më 11 korrik, të pranishmit me një minutë heshtje nderuan viktimat e gjenocidit të Srebrenicës të vitit 1995, duke bërë kështu lidhjen mes viktimave të persekutimit nacional socialist me viktimat jo të largëta të dhunimit të të drejtave të njeriut. Kjo përkujtimore u organizua gjatë shfaqjeve publike ku pjesëmarrësit me krenari prezantuan filmat e tyre mbi monumentet e Hans dhe Sophia Scholl, Georg Elser dhe monumentit “Dodger’s Alley” prapa ndërtesës së Feldhernhalle. Filmat janë të disponueshëm në Youtube dhe në DVD, në gjuhën angleze, gjermane dhe boshnjake/kroate/serbe. Ky seminar u financua nga fondacioni EVZ (Europeans for Peace Program dhe organizata Anne Frank Verein).

- Monumenti i Georg Elser u ngrit për nder të Georg Elserit (1903-1945), një marangoz nga Mynihu i cili më 8 nëntor të vitit 1939, vuri një bombë, dhe në këtë mënyrë u përpoq të kryente atentat ndaj Adolf Hitlerit në pijetoren Bürgerbräukeller (klubi i madh i birrarisë Löwenbräu në Mynih). Meqënëse Hitlerit i'u desh të ikte nga vendi i ngjarjes më herët, bomba shpërtheu disa minuta pasi ai kishte ikur. Elser u arrestua dhe u vra në qytetin Dachau më 9 prill të vitit 1945. Monumenti me tekstin ‘8. nëntor’ është ngritur në vitin 2009 në murin e jashtëm në afërsi të shtëpisë së Elser. Çdo ditë në orën 21.20 – kohë në të cilën ndodhi përpjekja për atentat – një dritë në monument ndizet për rreth një minute.
- Monumenti “Trëndafil i bardhë” i është kushtuar pjesëtarëve të grupit studentor të rezistencës që u vetëquajt Trëndafil i bardhë të cilët ftuan publikisht qytetarët e Gjermanisë në Mynih për rezistencë ndaj diktaturës naziste. Që nga viti 1942, Trëndafil i bardhë ka ndarë rreth 6 pamflete të ndryshme

deri në vitin 1943, kur anëtarët e lëvizjes së rezistencës u arrestuan dhe u ekzekutuan nga nazistët. Pamfletët në mur të cilët janë shfaqur në film janë vendosur me iniciativën e qytetarëve, dhe më vonë janë adaptuar nga fondacioni që është përgjegjës për të gjitha përkujtimoret e viktimave të kësaj lëvizjeje, duke përfshirë dhe bustin prej bronzi dhe ekspozitën e përhershme në Universitetin Ludwig-Maximilians.

- Rrugica Feldherrnhalle & Dodgers' është ndërtuar për ndër të qytetarëve të Mynihut, të cilët refuzonin të përshëndesnin nazistët. Ndërtimi i Feldherrnhalle fillimisht u lejua nga mbreti Luddwig I i Bavarisë (1786-1868), por ndërtesa u shndërrua në pjesë propagantiste naziste në vitin 1933. Kalimtarët duhej të përshëndesnin me përshëndetjen e Hitlerit. Ata që nuk dëshironin të bënin një veprim të tillë mund të shmangnin këtë përshëndetje duke kaluar përmes rrugicës Viscardi Alley. Për këtë arsye rrugica Viscardi Alley u quajt rrugica Dodger's Alley – historia në të cilën, si shenjë kujtimi, sot ekziston kalldrëmi me pllakat ngjyrë ari.



1961 Monumenti i Boro Vukmiroviçit dhe Ramiz Sadikut, Prishtinë, Kosovë

moduli IV MONUMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve	
	njësia 8
tema	Udhëtim përmes katalogut MONUMENTI
titulli	Bashkëbisedim me monumentet
nëntitulli	Fytyra e ndryshueshme e kujtimeve
konteksti	<p>Gjatë 100 viteve të fundit, në hapësirën që dikur zinte Jugosllavia, dhe që sot e quajmë rajon, situata ka qënë shumë e furishme. Nga viti 1914 deri në 2014, kanë ndryshuar disa shtete, struktura shoqërore dhe për fat të keq dhe lufrat. Janë ndryshuar carët, sulltanët, mbretërit, shokët dhe zotërinjtë; kanë ndryshuar shtetet, njerëzit janë transferuar, disa me dëshirën e tyre dhe disa me dëshirën e të tjerëve, janë ndryshuar kufinj të, dhe kështu gjithçka deri në ditët tona.</p> <p>Gjithsesi çdo kohë ka pasur heronjtë e saj dhe janë ngritur monumente me dëshirën që veprat e rëndësishme dhe njerëzit të qëndrojnë në kujtesë për gjeneratat që vijnë. Shumë monumente i'u kanë rezistuar luftërave, por nuk i'u kanë rezistuar kohës së paqes. Heronjtë e një kohe janë shndërruar në mbeturina shoqërore në një gjeneratë tjetër. Nga ana tjetër, heronjtë e një kombi në Ballkan janë parë si kriminelë tek një komb tjetër. Interpretimi i ngjarjeve historike ka ndryshuar shumë me ndryshimin e klimës shoqërore. Dhe kështu deri në ditët tona. Tërmeti i vitit 1914 dhe fillimi i Luftës së Parë Botërore ndodhën në më të rajonit – në Sarajevë. Lufta kaploi të gjitha zonat, dhe u shënuan shumë dëmtime dhe viktima. Fundi i luftës çoi në ndryshim të kufinjve. Monarkia Austro-Hungareze u shpërbë, pushtimi osman gjithashtu dhe u krijua shteti i ri- Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, emri i të cilit do të ndryshohej pak me vonë në Mbretërinë e Jugosllavisë. Ky shtet do të shtrihej nga Vardari deri në Triglav dhe nga Dunabi deri në detin Adriatik. Ky vend u sundua nga dinastia Karagjorgjeviç, dhe kryeqytet kishte Beogradin.</p> <p>Ky shtet i ri ishte i ngarkuar me shumë probleme- ekonomike, shoqërore, politike dhe kombëtare, të cilat ishin vështirë për t'u zgjidhur. Përveç kësaj, Europa mes dy luftërave botërore (1918-1939) nuk ishte vendi më i lumtur për të jetuar. Pasojat shkatërruese të Luftës së Parë Botërore vështirësonin jetën e njerëzve të zakonshëm. Sëmundjes dhe varfërisë i'u bashkua dhe kriza ekonomike botërore, e cila në një farë mase shpejtoi formimin e rregjimeve totalitare. Paqja e brishtë në Europë përfundoi në vitin 1939.</p> <p>Periodha e Luftës së Dytë Botërore solli në Jugosllavi vuajtje të reja. Vendi u okupua nga forcat fashiste dhe popullsia u dëmtua si nga forcat okupatore të huaja ashtu dhe nga lëvizjet e ndryshme që u zhvilluan në vend. Luftën kundër okupatorit për çlirimin e vendit e organizoi partia Komuniste e Jugosllavisë, forcat e të cilit me kalimin e luftës u bënë më të shumta.</p>

	<p>Viti 1945 solli çlirimin e vendit dhe formimin e shtetit të ri – të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (SFRJ)- në përbërjen e të cilit ishin Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia (me krahinën e Kosovës dhe të Vojvodinës), Mali i Zi dhe Maqedonia. Në krye të shteti ishte presidenti Josip Broz Tito (deri në fund të jetës së tij, në vitin 1980), ndërsa Beogradi ishte kryeqyteti. Kjo periudhë mbahet mend si periudhë e ripërtëritjes dhe ndërtimit të vendit, dhe gjithashtu nga shumë njerëz ajo periudhë mbahet mend si periudhë prosperiteti dhe e një jete të mirë.</p> <p>Dekadat e fundit të trazuara të shekullit 20, sollën një krizë të re dhe trazira. Arsyet për pakënaqësi ishin të shumta - ekonomike, shoqërore, dhe nacionale. Kriza në Jugosllavi e cila zgjati nga fillimi i viteve 80-të pati si rezultat luftërat e gjakshme dhe rënien e Jugosllavisë.</p> <p>Luftërat filluan në vitin 1991 dhe zgjatën, me intensitet të vogël ose të madh, për dhjetë vitet në vazhdim. U luftua nga Sllovenia deri në Maqedoni, këto lufta patën dimension fetar dhe nacionalist, ku ndërhyjnë dhe forcat e huaja. Lufta filloi në Slloveni dhe përfundoi në Kosovë. Si dhe në luftërat e mëparshme, dhe këto konflikte në fundin e shekullit të 20-të përfunduan me ndryshimin e kufinjve. U krijuan shtete të reja: Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova.</p> <p>Duke marrë parasysh që në rajon në shekullin e 20-të u krijuan rrethane historike komplekse dhe njëkohësisht ai u përfshi në sisteme të ndryshme politike, interpretimi i historisë në vend ishte i ndryshueshëm dhe subjekt i instrumentalizimit, në përputhje me politikën aktuale. Kujtimi dhe përkujtimi i ngjarjeve të caktuara historike u përkushtëzua nga ideologjia aktuale, e cila para së gjithash kishte si qëllim forcimin e identitetit/ identiteteve nacionale.</p>
<p>tema të ngjashme</p>	<p>Kujtime për monumentet e Ballkanit Perëndimor, historia lokale</p>
<p>mesazhet</p>	<p>Mendoni se sa e rëndësishme është mbi të gjitha të kujtojmë të kaluarën, luftërat, heronjtë, dhe pse mund të jetë shumë e vështirë ballafaqimi me të shkuarën?</p>
<p>qëllimet</p>	<p>Qëllimi i këtij moduli është rishqyrtimi i rolit të monumenteve dhe marrëdhënia e shoqërive ndaj tyre në shekullin e 20-të. Përveç kësaj, qëllimi i këtij moduli është që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri të caktuara në lidhje me monumentet nga komuniteti lokal dhe rajoni. Këto dije do t'i fitojnë nga burimet historike të formuara të zgjedhura dhe didaktike, që japin një këndvështrim multiperspektiv rreth kësaj teme.</p>

	<p>Gjithashtu, gjatë zbatimit të këtij moduli, përveç informacionit historik, pjesëmarrësit do të zhvillojnë të menduarit kritik, si për ngjarjet historike ashtu edhe për artin, veçanërisht për monumentet, me anë të të cilëve përkujtohen ngjarje të caktuara ose të ngritura për nder të ndonjë personaliteti. Pjesëmarrësit do të konsiderojnë arsyet për ngritjen e një monumenti, rolin e tyre brenda komunitetit dhe qëndrimin e komunitetit ndaj monumenteve.</p> <p>Si do të zbatohet moduli nga pjesëmarrësit që vijnë nga mjedisë të ndryshme, ata do të zhvillojnë aftësitë e komunikimit të ndërsjelltë, shkëmbimin e përvojave të ndryshme dhe traditat nga mjediset nga të cilat vijnë, zhvillimin e aftësive të tolerancës dhe respektit të ndërsjelltë.</p>
Rezultatet e mësimimit	Pjesëmarrësit janë trajnuar për të punuar me dokumente historike, bëjnë pyetje rreth tyre, vlerësojnë vlerën e tyre, mbledhin të dhëna mbi bazën e tyre, i organizojnë të dhënat e marra, i analizojnë dhe i sintetizojnë, i krahasojnë dhe nxjerrin përfundime rreth tyre.
kohëzgjatja	<p>90 minuta</p> <p>pjesa e I-rë: 15 minuta: 10 (hyrje) + 5 (ndarja e detyrave)</p> <p>pjesa e II-të: 50 minuta: 5 x 10 minuta</p> <p>pjesa e III-të: 25 minuta: prezantimet dhe përfundimi</p>
numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Pjesëmarrësit e trajnimit do të ndahen në pesë grupe për të analizuar materialet mbi monumentet e grupuar veçmas dhe të paraqitur në kartone.
procedura	<p>pjesa e I-rë: 15 minuta: 10 (hyrje) + 5 (ndarje detyrash)</p> <p>Hapi i parë – ndarja e pjesëmarrësve në grupe dhe sigurimi i informacionit rreth mënyrës së operimit dhe ndarja e detyrave.</p> <p>Pjesëmarrësit do të ndahen në 5 grupe. Çdo grup do të ketë materiale të ndryshme. Çdo grup duhet të ketë nga një tavolinë, rreth të cilës ulen pjesëmarrësit dhe ku ndodhet materiali i pregatitur më përpara.</p> <p>Kur pjesëmarrësit të zënë vendet e tyre të punës fillon cikli i parë i punës, lektori do të shkruajë në dërrasën e punës afatin kohor i cili përmban përcaktuesit bazë kohor të ngjarjeve të mëdha historike: Lufta e Parë Botërore (1914-1918), Lufta e Dytë Botërore (1939-1945), faza fillestare e rënies së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe deri në ditët e sotme - 2014 dhe vendosja në mur e hartës së rajonit ku do të shënohen vendet ose rajonet ku është ndërtuar monumenti.</p>

pjesa e II-të: 50 minuta: 5 x 10 minuta

Hapi i dytë

Pjesëmarrësit e seminarit janë të ndarë në grupe. Çdo grup merr një karton me fotografi dhe histori nga monumentet dhe ka si detyrë të analizojë përmbajtjen e tyre në bazë të pyetjeve rreth punës me monumentet, për të cilat përgjigjen përmes tre fazave. Çdo grup duhet të analizojë të gjithë monumentet që ka marrë, t'ju përgjigjet pyetjeve të bëra dhe të pregatisë një prezantim me rezultatet që ka nxjerrë (për pjesën e tretë të seminarit).

pjesa e III -të: 25 minuta: prezantimet dhe përfundimi

Hapi i tretë – prezantimi i rezultateve. Çdo grup gjatë prezantimit të materialit përdor tablon e kohës dhe hartën. Gjatë prezantimit të monumentit konkret, e vendos atë në tablon e kohës (ose e shënon) dhe tregon vendndodhjen (qytetin, mjedisin) në hartë ku ndodhet monumenti.

Pasi çdo grup paraqet konkluzionet përkatëse, vazhdon pjesa e diskutimit dhe përgjigjet për pyetjet kryesore

PYETJET KRYESORE GJATË GJITHË PROCESIT:

1. Në çfarë mase marrëdhënia ndaj monumenteve nga e shkuara dëshmon për shoqërinë e sotme?
2. A kanë monumentet afat në kuptimin fizik/kujtimor?
3. Çfarë/kush ndikon më shumë në një marrëdhënie të tillë ndaj monumenteve?
4. Në çfarë mase moskujdesja për monumentet flet për turpin që kemi ndaj të shkuarës tonë?

PYETJE NË LIDHJE ME PUNËN ME MONUMENTET; PYETJE PËR ÇDO GRUP

A. Pyetje për monumentet të anës përpara:

1. Nga çfarë është bërë monumenti?
2. Ku ndodhet monumenti?
3. Cilat janë karakteristikat artistike të tij?
4. Çfarë mesazhi simbolik përcjell monumenti?
5. Për cilën periudhë dëshmon monumenti?

	<p>B. Pyetje për monumentet në anën e pasme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Krahasoni përgjigjet me informacionin për monumentet. 2. Kujt i është ngritur monumenti? 3. A i përkasin të njëjtës periudhë monumentet e këtij grupi? 4. Cili është mesazhi i përbashkët i monumenteve të këtij grupi? 5. Cili është fati i monumenteve të këtij grupi? <p>C. Monumenti im – pyetje për një monument të unifikuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkruani komentin tuaj për monumentin dhe krahasojeni atë me komentin ekzistues historik, nëse ka. Ku vini re ngjashmëritë dhe ku ndryshimet? 2. Cili është përcaktimi juaj për monumentin ?
<p>materiale</p>	<p>Pjesa e I-rë:</p> <p>Duhet të përgatitet më përpara tabloja e kohës me vitet të cilat reflektojnë kontekstin historik, në të cilën pjesëmarrësit do të shënojnë kohën kur monumenti është ngritur dhe hartën e rajonit, në të cilën do të shënohet vendi ose mjedisi ku është ngritur monumenti.</p> <p>pjesa e II-të:</p> <p>Monumentet nga katalogu</p> <p>grupi i I-rë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. 1961. - “Fluturimi i ndërprerë” – parku “Shumarice”; vendi: Kragujevac, Serbi; skulptori: Miodrag Zhivkoviç; b. 1966. - “Lulja e Jasenovacit”; vendi: Jasenovac, Kroaci; skulptori: Bogdan Bogdanoviç; c. 1973. – Monumenti i Betejës në Sutjeska; vendi: Tjentishte, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Miodrag Zhivkoviç; d. 1978. – Monumenti në Makljen; vendi: Makljen, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Boshko Kuçanski; e. 1974. - “Makedonium”; vendi: Krushevo, Maqedoni; skulptor: Jordan Grabuloski dhe Iskra Grabuloska (arkitektura), Borko Lazeski (vitrazhi) dhe Peter Mazev (kupolat).

grupi i II-të:

- a. 1934. – Monumenti i Petar II Petroviç Njegosh; vendi: Trebinje, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Toma Rosandiç;
- b. 2006. - Monumenti i Skenderbeut; vendi: Shkup, Maqedoni; skulptor: Thoma Thomai;
- c. 2011. - “Luftëtari në kalë”; vendi: Shkup, Maqedoni; skulptor: Valentina Stevanovska;
- d. 1938. – Monumenti i Gjorgje Petroviç Karagjorgje; vendi: Topola, Serbi; skulptor: Petar Palaviqini;
- e. 1948. - Monumenti i Titos; vendi: Kumrovec, Kroaci; skulptor: Antun Augustinçiq.

grupi i III-të:

- a. 1929. – Monumenti i Grgur Ninskit; vendi: Split, Kroaci; skulptor: Ivan Meshtroviç;
- b. 1990. – Monumenti i Desanka Maksimoviç; vendi: Valjevo, Serbi; skulptor: Aleksandar Zarin;
- c. c. 1994. (ndërtimi i parë 1984) - “Krajputash” – monumenti i Ivo Andriç; vendi: Vishegrad, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Ljupko Antunoviç;
- d. d. 1999. – Monumenti i Nënë Terezës; vendi: Shkup, Maqedoni; skulptor: Tome Serafimovski.

grupi i IV-t:

- a. 1953. – Monumenti përkujtimor “Beteja e Kosovës”, 1389; vendi: Gazimestan, Kosovë; skulptor: Aleksandar Deroko;
- b. 2001 (mbase më herët) – Parku memorial “Rorovi”; vendi: Gorazhde, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Senad Pezo;
- c. 2003. – Qendra përkujtimore “Srebrenica – Potoçari” për viktimat e gjenocidit të vitit 1995.; vendi: Srebrenicë, Bosnje dhe Hercegovinë; arkitekt: Ahmed Xhuviq dhe Ahmet Kapixhiç;
- d. 2004. – Monumenti i viktimave shqiptare të Luftës së Dytë Botërore dhe të konfliktit të 2001; vendi: Blace, Maqedoni; skulptor: Selam Mustafa;
- e. 2004. – Monument i ushtarëve të rënë në luftën patriotike të mbrojtjes së atdheut; vendi: Mrkonjiç, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Miodrag Zhivkoviç;
- f. 2005. - Monumenti i ushtarëve të rënë Kroatë; vendi: Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë; skulptor: Slavimir Drinkoviç;
- g. 2009. – Monumenti i “Viktimave të pafajshme të agresionit të NATO-s kundër Jugosllavisë”; vendi: Shkëmbi Grdeliq, Serbi; skulptori: i panjohur.

	<p>grupi i V-të:</p> <p>a. 2007. – Monumenti i Roki Balbosë; vendi: Zhitishte, Serbi; skulptor: Boris Staparac;</p> <p>b. 2008. – Monumenti i Bob Marleit; vendi: Banatski Sokolac, Serbi; skulptor: Davor Dukiq;</p> <p>c. 2010. – Monumenti i Srgjan Aleksiç; vendi: Panqevo, Serbi; skulptor: Ivana Rakixhiç-Krumes;</p> <p>d. 2000. – Monumenti i Zahir Pajazitit; vendi: Prishtinë, Kosovë; skulptor: Muntoz Dhrami;</p> <p>e. 1961. – Monumenti i Boro Vukmiroviç dhe Ramiz Sadikut; vendi: Prishtinë, Kosovë; skulptori: i panjohur.</p>
burimet	<p>“Monumente në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Katalogu MONUMENTI, autor: Marko Krojaq, dokumenti në format PDF në DVD, organizator: <i>forumZFD</i>, 2014. • Moduli V/Njësia 9/Skenari: MonuMENTImotion (Monumentet dhe momentet në lëvizje), autor Muhamed Kafexhiç Muha
literaturë shtesë	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e monumenteve në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në rajon • Simbolet e monumenteve • Moduli V/Njësia 9/Skenari: Monumentet dhe momentet në lëvizje, autor Muhamed Kafexhiç Muha
aktivitete shtesë	<p>Nga: “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: “Kujtime për monumentet/ Monumentet kujtime”; • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipët (DVD); • Moduli V: “Monumentet dhe momentet në lëvizje” /MonuMENTImotion. Film i shkurtër (DVD).

Përdorni 27 kartat me fotografitë e monumenteve që janë të përfshirë në mjetin pedagogjik “Kujtime në lëvizje”.

PYETJE PËR SECILIN GRUP:

(Pyetjet janë të njëjta për secilin grup)

A. Pyetje për monumentet në anën e përparme:

1. Nga çfarë është bërë monumenti?
2. Ku ndodhet monumenti?
3. Cilat janë karakteristikat e tij artistike?
4. Çfarë mesazhi simbolik përcjell monumenti?
5. Për cilën periudhë dëshmon monumenti?

B. Pyetje për monumentet në anën e pasme:

1. Krahasoni përgjigjet me informacionet mbi monumentet.
2. Kujt i është ngritur monumenti?
3. A i përkasin monumentet e këtij grupi të njëjtës periudhe?
4. Cili është mesazhi i përbashkët i monumenteve të këtij grupi?
5. Cili është fati i monumenteve të këtij grupi?

C. Monumenti im – pyetje për monument të unifikuar:

1. Shkruani komentin tuaj për monumentin dhe krahasojeni atë me komentarin ekzistues historik, nëse ka. Ku vini re ngjashmëritë dhe ku ndryshimet?
2. Cili është përcaktimi juaj për monumentin ?

Pjesa e fundit – diskutimi:

PYETJET KRYESORE PËR DISKUTIMIN E FUNDIT NË PJESËN E TRETË TË MODULIT:

1. Në çfarë mase marrëdhënia ndaj monumenteve nga e shkuara dëshmon për shoqërinë tonë?
2. A kanë monumentet afat kohor në kuptimin fizik/përkujtimor?
3. Çfarë/kush ndikon më shumë në këtë marrëdhënie ndaj monumenteve?
4. Në çfarë mase moskujdesia ndaj monumenteve flet për qasjen tonë ndaj të shkuarës tonë?



Kuadër nga krijimi i materialit MONuMENTImotion, autor Muhamed Kafexhiç Muha

moduli V Arti i ballafaqimit me të shkuarën	
	njësia 9
tema	Eksperienca filmike: analiza dhe debati
titulli	MOnuMENTImotion: Monumentet dhe momentet në lëvizje
nëntitulli	Arti dhe ballafaqimi me të shkuarën
konteksti	<p>Tregimi për Boro Vukmiroviç dhe Ramiz Sadikun</p> <p>Boro dhe Ramizi u vranë nga ushtarët italianë në prill të 1943 pasi i kapën ndërsa udhëtonin nga Gjakova për në Prizren. Një nga legjendat që ekziston në lidhje me vdekjen e tyre është që ushtarët italianë dhe brigadat shqiptare që i kapën ata, i ofruan Ramiz Sadikut të arratisesj dhe të shpëtonte, por ai refuzoi të largohej nga shoku i tij i luftës dhe miku i tij Boro.</p> <p>Martirizimi i shqiptarëve me sllavët (Boro Vukmiroviç ishte djalë Malazezi nga Peja) u kthye në simbol “vëllazërimi dhe bashkimi” i popullësisë shqiptare me popullësinë serbo-malazeze. Në 1999, gjatë heqjes dhe shkatërrimit të monumenteve nga koha e komunizmit dhe epokës së Millosheviçit, monumenti i Boros u hoq. Kështu që Ramizi mbeti aty i “ruajtur” në një mënyrë që është komplet në kundërshtim me historinë origjinale, e cila i kalon kufinj të etnikë. Mesazhi politik që qëndron pas shkatërrimit të monumentit mbështetet nga fakti që deri më sot asnjë autoritet zyrtar nuk ka bërë rregullimin e monumentit dhe disa shkolla në Kosovë që dikur mbanin emrin e këtyre dy “heronjve”, tani mbajnë vetëm emrin e Ramizit.</p> <p>Sfondi i filmit të shkurtër “MOnuMENTImotion” është ekspozita “MOnuMENTI – fytyra e ndryshueshme e kujtimeve” e autorit Marko Krojaq, e cila ka shërbyer si frymëzim për lindjen e idesë së projektit të Forumit të Shërbimit Civil për Paqe (<i>forumZFD</i>) dhe partnerëve, më të cilin do të krijohet ndërveprimi midis monumenteve të treguar në këtë ekspozitë. Si është e mundur lëvizja e monumenteve që ndodhen në vende të ndryshme? Çfarë efekti arrihet me këtë të shikuesit?</p> <p>Në fakt, ideja bazë ishte që monumentet e ngurtësuar dhe të izoluar të sillëshin në një ndërveprim imagjinar, e cila është metaforë e kujtimeve zgjuar dhe të gjalla. Ato monumente të së shkuarës “të ringjallur” fillojnë kërkimin për bustin e Boros të zhdukur, i cili dikur qëndronte bashkë me bustin e Ramizit në një monument në Prishtinë.</p> <p>Puna për realizimin e idesë filloi në dhjetor të vitit 2013, ndërsa formën e saj të parë ideja e mori në seminarin përgatitor të grupit të ngushtë që u mbajt në fillim të shkurtit të vitit vijues, në Beograd.</p>

	<p>Me artistin e pavarur Muhamed Kafexhiç Muha dhe studentët nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Gjermania, <i>forumZFD</i> planifikoi që filmi i animuar të shfaqej në kuadrin e Ngjarjes Paqësore Sarajevë 2014, në muajin qershor.</p> <p>Në fillim të marsit të vitit 2014 <i>forumZFD</i> mbajti seminarin treditör shtesë në Sarajevë me grupin e zgjedhur të studentëve dhe të aktivistëve të rinj. Në seminar morën pjesë 18 të rinjë nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Kosova, Maqedonia dhe Gjermania, ndërsa studentëve i'u paraqitën konceptet e pajtimit dhe të ballafaqimit me të kaluarën. Së bashku ata projektuan skenarin, biseduan rreth efekteve që dëshironin të përfshinin në film dhe ndanë detyrat që do të bënin gjatë muajve të ardhshëm. Të gjithë pjesëmarrësve i'u caktuan detyra, qoftë për animimin në skenë, për rregullimin e skenarit ose për organizimin e shfaqjes premierë në Sarajevë.</p>
tema të ngjashme	<p>Nga : “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik rreth kulturës së kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli II: Kujtime për monumentet / Monumentet kujtime; • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipët (DVD); • Moduli IV: katalogu MOnuMENTI, autor: Marko Krojaq, si dokument PDF në DVD. • Procesi i ballafaqimit me të shkuarën dhe i drejtësisë tranzicionale • Historia lokale
mesazhet	<p>Mendoni se si një film artistik mund të ngjallë interes për ngjarjet aktuale në shoqëri dhe si mund të shpjegojë fenomene të caktuara shoqërore dhe ngjarje historike. Mendoni se çfarë vlerash njerëzore mund të ngjallë filmi, si pjesë e artit, tek shikuesit.</p>
qëllimet	<p>Zhvillimi i mendimit kritik tek pjesëmarrësit me anë të filmit. Me anë të analizës rreth filmit dhe bashkëbisedimit rreth asaj çfarë panë, pjesëmarrësit do të konsiderojnë arsyet për ngritjen, por edhe për shkatërrimin e monumenteve, dhe arsyet për të cilat konteksti i ndryshëm shoqëror ndikon në interpretimin e ndryshëm të ngjarjeve historike. Si do të zbatohet moduli ndër pjesëmarrësit nga mjedise të ndryshme, ata do të zhvillojnë aftësinë e komunikimit, do të shkëmbejnë përvojat e traditave të mjedisve nga vijnë. Kjo do të ketë ndikim në zhvillimin e aftësive dhe në respektin e ndërsjelltë. Së fundmi, biseda rreth temave të dhimbshme do të ketë ndikim dhe në proceset e pajtimit në rajon dhe ngjashmërinë e qëndrimeve.</p>
Rezultatet e mësimit	<p>Pjesëmarrësit nëpërmjet filmit do të shqyrtojnë marrëdhënien e individëve të kohës së sotme ndaj të shkuarës, si të popullit të tyre ashtu dhe të popujve fqinjë.</p>
kohëzgjatja	<p>75 minuta: Pjesa hyrëse: 15 minuta Pjesa kryesore: 40 minuta = 10+30 Pjesa e fundit: 20 minuta</p>

numri i pjesëmarrësve	20-30
metodologjia	Pjesëmarrësit me anë të punës individuale dhe punës në grup, me anë të analizës së filmit dhe diskutimit do të nxjerrin përfundimet rreth pyetjeve kryesore të shtruara.
procedura	<p>Pjesa hyrëse e mësimit: 15 minuta</p> <p>Në qetësi, në tabelën e punës vëmë dy fotografi – një me fytyrë përpara (fotografia në të cilën ndodhet heroi kombëtar Ramiz Sadiku) dhe fotografia tjetër e kthyer prapa (fotografia në të cilën janë Ramiz Sadiku dhe Boro Vukmiroviç bashkë). Kartat ndodhen mes kartave të tjera të këtij mjeti.</p> <p>Me anë të metodës së dialogut, zgjojmë interes tek pjesëmarrësit dhe në dërrasën e punës mes dy fotografive shënojmë pyetjet që shtrohen.</p> <p>Arrijmë te tema e punës dhe së bashku formulojmë dhe shtrojmë pyetjet bazë të lidhura me temën, e cila me vetë procesin e punës do të na çojë tek pyetja përfundimtare kryesore.</p> <p>Pyetjet e mundshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë shikoni? 2. A mungon diçka? 3. Çfarë mungon? 4. Sa jeni të ndërgjegjshëm për monumentet rreth jush? 5. Sa jeni të njohur me monumentet në vend dhe rajon? 6. I kujt është monumenti simbol? 7. Çfarë roli mund të luajë arti në kulturën e kujtimit ? <p>Pjesa kryesore: 40 minuta</p> <p>Pjesa I - 10 min</p> <p>Pjesëmarrësit ndahen në 5 grupe. Informohen për shfaqjen e filmit dhe drejtohen për të dhënë pershtypjet dhe pyetjet e tyre të lidhura me simbolizmin, me sfondin historik dhe kulturor të filmit. Temat rreth të cilave mund të mendojnë ndërsa shohin filmin, të cilat do t'i ndihmojnë të përqëndrohen janë: simbolet në film, personazhet e famshme dhe publike në film, sfondi kulturor dhe historik i filmit, mesazhet që përcjell filmi etj. Bashkë me temat rreth të cilave do të mendojnë, në tabelë të shkruhen pyetjet që do të jenë temë diskutimi pas shfaqjes së filmit.</p>

Pyetjet me të cilat do të punohet për analizimin e filmit janë:

1. A n'a ndihmon filmi për të kuptuar të shkuarën? Në çfarë mase?
2. A n'a ndihmon filmi artistik në shpjegimin e situatës aktuale kulturore dhe politike në shoqëri ?
3. A mund të njohim mesazhet e këtyre lloj filmash?
4. A mundet filmi artistik të shërbejë si stimulues për pjesëmarrje aktive në shoqëri?

Pjesa II: 30 minuta

Shfaqja dhe analiza e filmit MOnuMENTImotion, (autor/regjisor: Muhamed Kafexhiç Muha me studentët nga vendet e Ballkanit Perëndimor)

Pas shfaqjes së filmit, pjesëmarrësve t'ju jepet disa minuta kohë që të reflektojnë mbi informacionet dhe përshtypjet dhe të përgatiten për analizën e filmit me ndihmën e temave dhe pyetjeve të shtruara. Vëzhgimet e secilit duhet të shënohen në letër, të cilat pas përfundimit të analizave dhe diskutimit të rreshtohen në murin e punës që të kemi mendime dhe përshtypje konkrete të pjesëmarrësve.

Pastaj vijon analiza e filmit dhe paraqitja e përfundimeve dhe qëndrimeve të pjesëmarrësve. Moderatorin ndjek rrjedhën e eventit dhe të mendimeve dhe shënon aspekte të reja në lidhje me vëzhgimin e filmit dhe në fund do të bëjë përmbledhjen. Pas diskutimit, pjesëmarrësit do të rreshtojnë shënimet e tyre në tabelën e punës.

Pjesa e fundit: 20 minuta

Të kthehet nga para fotografia që ka qënë gjatë gjithë kohës e kthyer mbrapsht (e Boros dhe Ramizit) dhe në atë mënyrë të vizualizohet pjesa që mungon!

Me metodën e diskutimit plenar dhe me ndihmën e pyetjeve kryesore, pjesëmarrësit të motivohen të formulojnë qëndrimin e tyre rreth temës dhe roleve të filmit artistik si motivatorë për analizën e shoqërisë dhe pjesëmarrjen aktive në të.

	<p>Pyetjet kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kush janë / çfarë janë heronjtë e një periudhe? Deri në çfarë mase heronjtë e një periudhe vazhdojnë të njihen si vlerë e përhershme? Çfarë roli kanë monumentet në ruajtjen e këtyre vlerave? Deri në çfarë mase filmi përshkruan ndryshimet e marrëdhënieve dhe të politikës ndaj monumenteve? Sa i madh është interesi që mund të ngjallë filmi artistik për ngjarjet aktuale në shoqëri? A mund të japim përgjigje për pyetjen: Pse Boro dhe Ramiz nuk qëndrojnë më “krah për krah” dhe simbol i kujt janë ata sot? <p>Pas diskutimit, pjesëmarrësve t’ju jepet detyrë që të shkruajnë mesazhin e tyre në bazë të përshtypjeve nga filmi që panë gjatë seminarit. Mesazhet të vendosen rreth fotografisë së Boros dhe Ramizit!</p>
<p>materiale</p>	<p>pjesa I:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1961. – Monumenti i Boro Vukmiroviç dhe Ramiz Sadikut; vendi: Prishtinë, Kosovë; skulptori: i panjohur http://sh.wikipedia.org/wiki/Boro_Vukmirovi%C4%87#mediaviewer/File:Boro_i_ramiz.jpg karta Boro dhe Ramiz, në kutinë e mjetit pedagogjik “Kujtime në lëvizje” <p>pjesa e II:</p> <p>Film i shkurtër (10 minuta): “Monumente në lëvizje”</p> <p>pjesa e III:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1961. - Monumenti i Boro Vukmiroviç (u hoq si pjesë e monumentit) dhe Ramiz Sadikut; vendi: Prishtinë, Kosovë; skulptori: i panjohur http://sh.wikipedia.org/wiki/Boro_Vukmirovi%C4%87#mediaviewer/File:Boro_i_ramiz.jpg Karta e Boro dhe Ramiz, në kutinë e mjetit pedagogjik “Kujtime në lëvizje”

burimet	<p>Nga : “Kujtime në lëvizje” – mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • film i shkurtër: “Monumentet dhe momentet në lëvizje”, autor/regjisor: Muhamed Kafexhiç Muha (DVD); • katalogu: MOnuMENTI, autor: Marko Krojaq, si dokument PDF(DVD), organizator: <i>forumZFD</i>, 2014; • Monumenti i Boro Vukmiroviç (u hoq si pjesë e monumentit) dhe Ramiz Sadikut; vendi: Prishtinë, Kosovë; autor fotografie: Marko Krojaq, skulptori: i panjohur; • Fotografi bardh e zi: Boro dhe Ramiz: http://sh.wikipedia.org/wiki/Boro_Vukmirovi%C4%87#mediaviewer/File:Boro_i_ramiz.jpg (internet, wikipedia).
literaturë shtesë	<p>Nga: “Kujtime në lëvizje” – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipët”, Njësia 7: Heronjtë?, histori rreth rezistencës
aktivitete shtesë	<p>Njohja me katalogun MOnuMENTI, dokumenti PDF në DVD.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Modul II: “Kujtime për monumentet/Monumentet e kujtimeve”, Njësia 2: Çfarë është monumenti?; • Moduli III: Memory walk (Shëtitje ndër kujtime): Sarajevë – Mynih. Videoklipët”, Njësia 6 dhe 7.

moduli V materiali i punës shtesë për nxënësit dhe mësuesit

pjesa e I dhe e III:

Fotografitë /kartat (nga kutia e mjetit) të nevojshme për fillimin dhe fundin e mësimit:

pjesa e II:

Filmi i shkurtër /MonuMENTImotion
“Monumente në lëvizje”

pjesa e III:

Pyetjet kryesore në kartë:

- Kush janë / çfarë janë heronjtë e një epoke?
- Deri në çfarë mase heronjtë e një periudhe vazhdojnë të njihen si vlerë e përhershme?
- Çfarë roli kanë monumentet në ruajtjen e atyre vlerave?
- Sa i madh është interesi që mund të ngjallë filmi artistik për ngjarjet aktuale në shoqëri?
- A mund të japim përgjigje për pyetjen: Pse Boro dhe Ramiz nuk qëndrojnë më “krah për krah” dhe simbol i kujt janë ata sot?



Monumenti i Boro Vukmirović (u hoq nga monumenti) dhe Ramiz Sadikut



Boro V. (majtas) dhe Ramiz S. (wikipedia)

Materiali mësimor shtesë për mësuesit

1. Emrat e grupeve të punës në të cilët ndajmë pjesëmarrësit:

- Diversiteti i formës së monumenteve
- Simbolizmi dhe simboli i monumentit
- Populizimi i monumentit
- Historia e monumentit
- Politika prapa monumentit

2. Pyetjet kryesore në kartë:

- Kush janë / çfarë janë heronjtë e një epoke?
- Deri në çfarë mase heronjtë e një periudhe vazhdojnë të njihen si vlerë e përhershme?
- Çfarë roli kanë monumentet në ruajtjen e atyre vlerave?
- Sa i madh është interesi që mund të ngjallë filmi artistik për ngjarjet aktuale në shoqëri?
- A mund të japim përgjigje për pyetjen: Pse Boro dhe Ramiz nuk qëndrojnë më “krah për krah” dhe simbol i kujt janë ata sot?

skenari

Muhamed Kafexhiç Muha, artist i pavarur (Bosnje dhe Hercegovinë)

Prolog

Animacioni fillon me monumentet:

- Beteja në Sutjeska 1943. (1973), Tjentište, Bosnje dhe Hercegovinë, skulptor: Miodrag Zhivković, faqe 54,
- Monumenti i viktimave shqiptare të Luftës së Dytë Botërore dhe në konfliktin e vitit 2001. (2004), Blace, Maqedoni, skulptor: Selam Mustafa, faqe. 72,
- Monumenti në Makljen (1978), Makljen, Bosnje dhe Hercegovinë, skulptor: Boshko Kuçanski, faqe 58, si hyrje e pavarur, e ndarë nga pjesa tjetër e animacionit. Kjo është një përvojë krejtësisht vizuale, hartuar në formën e vidoeklipit, që mund të paraqitet në mënyrë të pavarur si një e tërë që përsëritet vazhdimisht. Në çdo skenë ka punuar një animator tjetër që mund të ndjehet dhe në mënyrën e animacionit. Animacioni i prologut është realizuar nga: Branislav Pantiç, Filip Pantiç dhe Luka Tilinger.

Atë që kemi dashur të arrijmë është ndjenja e ndryshimit në vendet ku forca dhe qëndrueshmëria janë paraqitur në këto monumente të mëdha, në vendet me krahë të hapur, domethënë me mendje të hapur. Monumenti i dedikuar Betejës në Sutjeska, në Tjentishte, Branislav Pantiç njohu duart. Edhe pse monumenti simbolizon një degë të kanionit të lumit Sutjeska, ndonjëherë ky monument interpretohet si krahët e shpresës. Monumentet në Tjentishte dhe Makljen janë ngritur në kujtim të luftës nacionalçlirimtare dhe në përgjithësi paraqesin luftën kundër fashizmit. Sipas fjalëve të skulptorit, Makljen kishte “formën vitale të lules”, por më së shpeshti është interpretuar si grusht i ngritur, dhe meqënëse është i vendosur në pikën më të lartë mbi vendin e betejës në lumin Neretva, ai paraqet fitoren mbi fashizmin. Monumenti është shkatërruar pas luftës në Bosnje dhe u përpoqëm të tregojmë formën e prishur të grushtit. Ndryshe nga këto dy monumente, monumenti në Blace, në Maqedoni, i dedikohet Shqiptarëve që janë vrarë nga partizanët në Luftën e Dytë Botërore dhe luftëtarëve të rënë shqiptarë në konfliktet e brendshme në Maqedoni, në vitin 2001.

Titulli

Tipografia e titujve është punuar nga Edita Dauti, studente sociologjie, e cila për shkak të barrierave gjuhësore nuk mundi të përfshihej plotësisht në projekt. Ajo ka ndihmuar në skenat me Nënë Terezën dhe gjatë një çasti krijues të saj erdhi në idenë vizuale për titullin.

Muzika në titull shndërrohet në një formë më melodike, e cila do të përdoret për pjesën e mbetur të animacionit. Nuk kam dashur të depresionoj publikun me animacionin.

Hyrje

Dy kokat e Ivo Andriç, histori hyrëse

IVO: Andriç, Andriç, a ke për të më thënë ndonjë histori?

ANDRIÇ: Ivo, një histori po ndodh tani. Në Kumrovac është ditë e bukur me diell.

Fillojmë me monumentin e Ivo Andriç, fituesin e çmimit Nobël për letërsi nga Bosnja dhe Hercegovina – Krajputash(1984, 94), Vishegrad, Bosnja dhe Hercegovina, e skulptorit Ljupko Antunoviç, faqe 64. Polemika në lidhje me këtë shkrimtar është se të tre grupet etnike në vend duan t'a përvetësojnë. Por, vitet e fundit, Boshnjakët kanë hequr dorë nga Ivo. Ivon e kam zgjedhur kryesisht në rast nevojë për një tregimtar, zë në sfond, nëse vendosim që të punojmë me detaje disa skena. Përveç kësaj, ka dy portrete të Ivo Andriç, të cilët janë të kthyer njëri përballë tjetrit, pozitivi dhe negativ. Unë mendoj që shkrimtarët janë tregimtarë mbi të gjitha, dhe ata i tregojnë historitë e reja fillimisht vetvetes :).

Tito fillon të trokasë dhe të lëvizë

Ishte një ditë e bukur me diell, kur papritmas diçka fillon të trokasë. Tito zgjohet. Duket i depresionuar dhe shkon për një shëtitje në rrugë.

Tito (1948), Kumrovec, Kroaci, skulptor Antun Augustinçiq, faqe 40. Në fazën e hershme të shkrimit të skenarit bëme dy pyetje: A n'a duhen monumentet ? Disa pjesëmarrës, në thelb, i'u përgjigjën kësaj pyetje me ngritjen e monumenteve në ajër, veçanërisht në monumentin e Titos, ku ishte kapur bomba e NATOs, e cila në skenën e fundit duhej të shkatërronte të gjithë monumentet. Si grup ramë dakort që Tito dhe Jugosllavia ishin diçka që n'a bashkoi dhe ajo është tani pjesë e historisë tonë kolektive. Ashtu filluam me Titon, por nuk e dinim se çfarë ishte ajo gjë që trokiste, mbase ishte një bombë, por mbase ishte dhe ora e tij biologjike. Nuk mundëm t'a shpjegonim atë dhe mendojmë që tani për tani nuk ka nevojë për një shpjegim.

Konflikti

Tito viziton Ramizin dhe Boron dhe vë re që Boro mungon.

Tito:

Ramiz, zgjohu, ku është shoku Boro?

Ramiz (zgjohu):

Boro, Boro, ku është Boro? Çfarë ka ndodhur?

Tito:

Po shkoj t'a gjej.

Thuaju të tjerëve që është zhdukur! (del nga skena)

Ramizi (antena del nga koka e tij, zëri i brendshëm):

Ftohen të gjithë skulptorët, ftohen të gjithë skulptorët...

- Nga antenna del sinjali radiofonik (linjat rrethore) i cili transmetohet nga monumenti në Petrova Gora (në çdo panel monumenti paraqiten monumentë të ndryshëm).

Nuk e dimë pse u zgjua Tito. Mbase sepse donte të vizitonte bashkëluftëtarët ose fushëbetejat e vjetra, si vizitë të fundit që shënon zhdukjen e Jugosllavisë. Dhe krejtësisht rastësisht shkon për të vizituar Boro Vukmiroviç dhe Ramiz Sadikun (1961), në Prishtinë, në Kosovë, faqe 43. Historia e Boros dhe Ramizit nuk është e vetme. Histori të tilla mund të gjenden në çdo shtet jugosllav, me të njëjtin fat bustesh, që paraqet bazën shumë solide për këtë animacion.

Monumenti në Petrova Gora (1981), Petrovac, Kroaci, e autorit Vojin Bakiç, faqe 60, është përdorur në film si përforcues, dhe sot, në jetën reale përdoret si bazë për shpërndarës të telekomunikacionit, si edhe shumë monumentë të tjerë. Në fakt, asnjë pjesë tjetër e monumentit nuk është rindërtuar dhe as nuk është funksional.

4. Skulpturat i'u përgjigjen thirrjeve

Pëllumbi fluturon, Nënë Tereza qëndron pezull, kokat e heronjve kombëtarë kërcejnë dhe rrotullisen – si kokat në filmin e animuar “Spirited Away” – minatorët e rënë lëvizin, por fillojnë e bien si Walker në filmin “Lufta e Yjeve”, Rocky zgjohet dhe bërtet: ADRIAN!

Pëllumbi i paqes dhe prosperitetit i Travnik dhe Bosnje dhe Hercegovinës (2011), Travnik, Bosnje dhe Hercegovinë, autor Ismet Begoviç Ipe dhe Luej Maktou, faqe 90, qëndron në vendin ku ka qëndruar dikur busti i Titos. Ky është gjithashtu një shembull i heqjes së figurave dhe fytyrave njerëzore nga hapësirat publike në vendet ku shumica janë boshnjakë. Sfondi fetar i liderave boshnjakë në fushën e kulturës censuron me sukses format njerëzore në skulpturat e reja.

Monumenti i Nënë Terezës (1999), Shkup, Maqedoni, autori Tomo Serafimovski, faqe. 67. Nënë Tereza përfaqëson heronjtë fetar të popullit. Kam dashur të tregoj dy anë të ikonave fetare – atë njerëzore dhe fetare. Qëndrimi i saj pezull është në fakt shfaqje e shenjtërisë së saj. Ajo nuk ecën, por ngrihet në ajër, domethënë qëndron pezull.

Bustet e heronjve kombëtarë Darinka Radoviç, Sofija Ristiç, Milan Blagojeviç Shpanac dhe Milan Iliç QiQa (1971), Topola, Serbi, faqe 50, përgjigjen si shokë. Ata i kam zgjedhur për nder të filmit Hayao Miyazakij “Spirited Away”. Mendova që do të ishte diçka interesante të bëja animacionet e tyre.

“Heronjtë e minierave” lëvizja çlirimtare popullore (1973), Mitrovicë, Kosovë, e autorit Bogdan Bogdanoviç, faqe 53, janë zgjedhur si heronjtë që i’u përgjigjen thirrjeve për shkak të lidhjes së tyre direkte me Boron dhe Ramizin. Kjo është historia e bashkimit të dy nacionaliteteve. Në këtë rast i kemi bërë që të pengohen dhe të bien sepse njëra këmbë nuk funksionon. Kjo është, gjithashtu, dedikuar skenës Walker nga filmi “Luftërat e Yjeve”.

Rocky Balboa (2007), Zhitishte, Serbi, autori Boris Staparac, faqe 80, është përfaqësues i valës së heronjve të skulpturës publike që “nuk ofendon askënd”, ku pop-ikona ndërkombëtare shndërrohet në simbol të paqes. Në këtë grup janë monumentet e: Bob Marley, Johnny Depp në Serbi dhe Bruce Lee në Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë.

Kërkimi

Skenderbeu dhe historia e Boros dhe Ramizit

Kokat e heronjve kombëtarë që kërcëjnë përreth frikësorinë kalin e Skënderbeut dhe zgjojnë Skënderbeun. Skënderbeu: Ngadalë, çfarë po ndodh këtu?

Kokat: Skënderbe, Skënderbe, a mund të n’a ndihmosh?

Skënderbeu: Çfarë po ndodh?

Kokat: A mund të n’a ndihmosh të gjejmë shokun Boro?

Skënderbeu: Cilin Boro?

Kokat: Shokun më të mirë të Ramizit.

Skënderbeu: Ngjituni lart dhe me tregoni me shumë.

Kokat: Boro dhe Ramizi janë shokë partizanë që janë kapur nga okupatorët fashistë. Ramizit i kanë ofruar që të arratiset dhe të shpëtojë, por ai ka refuzuar që të ndahet nga shoku i tij i luftës.

Kokat pastaj fillojnë të këndojnë këngën e Ramizit dhe Boros: Jemi një qiell

Dy gjethe nga e njëjta degë Dy gurë nga i njëjti lumë nga Bistrica e Pastër

Skënderbeu (2006) Shkup, Maqedoni, autori Thoma Thomai, faqe 76, është shembull i historisë së përbashkët dhe miqësisë serbo-shqipëtare. Babai i tij është princ shqiptar ndërsa nëna e tij është princeshë serbe. Duke pasur parasysh që ishte edhe ushtar, menduam që do të ndihmonte ushtarët e tjerë por edhe Ramizin, si bashkëpatriot. E përdorim gjithashtu si figurë që paraqet historinë e Boros dhe Ramizit. Ai nuk e di atë sepse mund të konsiderohet superhero, hero i të shkuarës së largët, që është shndërruar në krijesë mitologjike.

Tito kalon afër monumentit

Në skenat që vijojnë tregojmë Titon se si kërkon Boron, duke vizituar monumentet që i dedikohen Luftës Çlirimtare Kombëtare:

- a. Prishja e monumentit në Petrova Gora – Ky monument është veçanërisht interesant sepse Marko Krojaq ka bërë fotografi nga faza të ndryshme të shkatërrimit dhe restaurimit të monumentit. Ato fotografi nuk kemi mundur t'i përdorim për animim për arsye teknike, por kam dashur të mbaj skenën në të cilën themi që me ikjen e Titos, të gjithë monumentet i janë lënë të shkuarës.
- b. Viktimave të terrorit fashist dhe luftëtarëve të rënë të Luftës Çlirimtare Kombëtare nga Sanski Most dhe rrethinat e tij(1972), Shushnjar (Sanski Most), Bosnje dhe Hercegovinë, autori Petar Krstić, faqe 52. Ky monument i përket serisë së monumenteve që kanë një aspekt futuristik dhe hapësinor. Në katalog tregohet vetëm një nga pllakat.

Kjo pjesë e animacionit me siguri paraqet konfirmimin e rëndësisë së historisë së përbashkët, Titos dhe Jugosllavisë.

- c. Makedonium (1974), Krushevo, Maqedoni, autori Jordan Grabuloski dhe Iskra Grabuloska (arkitektura), Borko Lazeski (vitrazh) dhe Peter Mazev (pjesa plastike e tavanit), faqe 56, është një kompleks i jashtëzakonshëm që është përballur me këtë skulpturë naive të Maqedonasit të veshur me uniformë tradicionale.

Atë e kemi përdorur për t'u ndarë nga Tito dhe që të "thyejmë" seriozitetin e skenave të mëparshme. Në sfond mund të shohim dhe të dëgjojmë se si mbyllen dyert e monumentit qendror në kompleksin Makedonium.

- d. Jasenovac 'Guri' lule (1966), Jasenovac, Kroaci, Bogdan Bogdanović, faqe 48. Pëllumbi ngre një lule të vogël të Jasenovacit (vetëm një), dhe ndërkohë monumenti në Jasenovac zhduket, por pasqyrimi i tij në ujë qëndron akoma.

Në fillim ishte planifikuar që Tito të kalonte afër Jasenovacit, dhe pastaj pëllumbi të kapte lulen. Ajo duhet të ishte skena e dytë – në vend të skenës me monumentin në Sanski Most, që është vetëm vazhdim i prishjes së monumenteve të së kaluarës Jugosllave. Unë kam punuar në skenën e shëtitjes së Titos, ndërsa Luka Tilinger ka punuar në skenën e kapjes së lules. Doli aq bukur sa kam vendosur të ndaj atë skenë dhe ta hedh Makedonium mes atyre dy pjesëve. Kjo gjë shkaktoi konfuzion tek njerëzit e organizatës *forumZFD*, prandaj pranova të ndryshonim atë pamje.

Në disa skena të ardhshme vazhdojmë me pëllumbin që fluturon mbi monumentet e tjerë/të saponjërtuar, duke mbajtur lulen e Jasenovacit si simbol ndërkombëtar i paqes. Në të njëjtën kohë kam dashur të tregoj se si monumentet konsiderohen si të njëjtë, tek njerëzit që nuk janë të lidhur direkt me monumentet, si për shembull komuniteti ndërkombëtar. Me njerëzit nga organizata *forumZFD* kam bërë shumë bisedime rreth zgjedhjes së monumentit. Ata kanë parë konflikt aty ku nuk ka qënë, dhe gjithashtu është insistuar në “korrektësinë politike”, e cila nuk kishte kuptim. Humbëm shumë kohë të vlefshme me ato bisedime.

e. Pëllumbi fluturon lart:

Monumenti i partizanëve të rënë dhe viktimave të terrorit fashist (1965), Sisak, Kroaci, Antun Augustinçiq, faqe 47; Monumenti kundër të keqes (1991), Kragujevac, Serbi, Romo Miguel, faqe 63; Monumenti i lirisë (1977), Berane, Mali i Zi, Bogdan Bogdanoviç, faqe 57; Monumenti për Desanka Maksimoviç (1990), Valjevo, Serbi, Aleksandar Zarin, faqe 62; Monumenti i Bob Marley (2008), Sokolac në Banat, Serbi, Davor Dukiç, faqe 82;

f. derisa të ulet në gishtin e Grgur Ninskit (1929), Split, Kroaci, Ivan Meshtroviç, faqe 37, për të pushuar. Grguri zgjohet dhe e fryn atë deri te retë. Përveç që e dëgjojmë, shohim gjithashtu një PUFF, si në komeditë e vjetra. Historinë e ndërpret tregimtarin Andriç.

Andriç: Qëndro, Ivo! Nuk ishte ashtu. Por prit, po shkojmë shumë përpara me historinë. Ndërkohë në Sutjeskë...

Duket se Ivo ka marrë rolin e tregimtarit dhe bën shaka. Andriç e korrigjon atë, por duket se dhe diçka tjetër po ndodh dhe që duhet të tregohet përpara se të mbarohet historia e pëllumbit.

Në krye

Sutjeska, Makljen, Nënë Tereza, Rocky

Në sfond shohim fushat dhe malet me zor të dukshme, format rrethore në tokë. Shihen rrufe dhe bubullima dhe nga ajo errësirë del monumenti qendror nga kompleksi Makedonium. Nga aty del avull sikur është lëshuar nga çlirimi i presonit. Hapen dyert rrëshkitëse dhe shohim Rocky-in dhe Nënë Terezën.

Rocky bërtet: Boro.

Dëgjojmë jehonat – Boro, Boro...

Rocky dhe Nënë Tereza zbresin shkallët dhe bashkëbisedojnë. Nënë Tereza: Domethënë, aty është skaneri i Sutjeskës.

Rocky: Po është, Nënë T.

Nënë Tereza: Por ku janë krahët? E dini që zogjtë janë të dërguarit e Zotit.

Rocky: Duhet të aktivizojmë krahët. E shihni, njerëzit kanë ndalur së vizituar këtë vend dhe krahët janë mbyllur për të kursyer energji – mendo gjelbër.

I afrohen diçkaje që ngjan me një tabelë komandash në të cilën ndodhet vetëm një buton i kuq.

Rocky: A mund të më bëni nder? Mbase ndonjë lutje?

Nënë Tereza: Ah, pusho dhe shtyp atë buton.

Shohim dorezën e boksit që shtyp butonin. Krahët fillojnë të hapen nga toka si në filmin “Transformers”. Në sfond shohim një krah; dëgjojmë zhurmën e makinës elektrike nga e cila në drejtim të qiellit fluturojnë vija të bardha të ndërprera.

Nënë Tereza: Qofsh i ladëruar Zot, çfarë skulpture e mrekullueshme, të ngrejë dëshmorët e rënë në parajsë!

Rocky: Nënë T., ju e dini që ata ishin komunistë, dhe kur them komunistë, kam parasysh ateistë. Nënë

Tereza: A nuk janë të gjithë besimtarë në momentin e fundit!?

Papritmas, makineria e Sutjeskës fiket.

Rocky: Syri i shenjtë i tigrin, çfarë ndodhi???

Në monumentin Sutjeska gjendet një monitor në të cilin është shkruar mesazhi – Ritransmetuesi në Makljen nuk përgjigjet.

Rocky: Si është e mundur, në librin tim të të dhënave shkruhet që Makljen i ka mbijetuar luftës?

Nënë Tereza: A mendon për librin e të dhënave të CIA-s? Makljen i ka mbijetuar luftës, por nuk i ka mbijetuar paqes. Rocky i zemëruar: Paqja e mallkuar. Çfarë do të bëjmë tani? Nuk kemi asgjë.

Nënë Tereza: Të kthesh qiellin dhe tokën.

Në këtë skenë kemi dashur dhe një pikëpamje “ndërkombëtare” të situatës. Shumica e këtyre monumentëve të vjetër Jugosllavë janë zbuluar përsëri dhe te publiku ndërkombëtar janë paraqitur nga fotografët e huaj. Për disa, këto janë pjesët më të neveritshme të skulpturave publike, ndërsa për disa të tjerë janë pjesë fantastike dhe mahnitshme të artit. Këtu është dhe një koment i vogël, që i referohet të gjithë organizatave joqeveritare ndërkombëtare, domethënë forcave të UN-it, ku çdo individ nën ndikimin e paragjykimeve të tyre personale ka ide rreth asaj se si mund të zgjidhet problemi. Gjithashtu, kam dashur të tregoj se si paqja nganjëherë nuk është paqe, por vetëm fundi i operacioneve luftarake, por dhuna end vazhdon.

Aktivizo lëvizjen e qiellit dhe të tokës

Anti-graviteti arrihet përmes aktit të pajtimit, me lidhjen e Parkut Përkujtimor Rorovi (2001), Gorazde, Bosnje dhe Hercegovinë, Senad Pezo, faqe 69, me Monumentin e ushtarëve kroatë të vrarë në Mostar 1992– 1995. (2005), Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, Slavomir Drinkoviç, faqe 75, me Monumentin e ushtarëve të rënë të luftës patriotike (2004), Mrkonjiç-Grad, Bosnje dhe Hercegovinë, Miodrag Zhivkoviç, faqe 73, në një Monument të ri të ushtarëve të rënë të luftës së Bosnjes, pa ndasi etnike dhe pa konkurrencë në numra dhe me trishtim të njëjtë për jetët e humbura.

Makineria antigravitet është iniciuar nga urdhëri i Nënë Terezës; shohim tre përmendore për tre grupet etnike të ushtarëve të rënë në luftën e Bosnjes, të cilët përzihen në një monument që fillon e rrotullohet. Për të transmetuar këtë energji përdoren tre monumente shtesë:

Monumenti i Kosmaj i detashmentit të Lëvizjes Çlirimtare Popullore (1971), Kosmaj, Serbi, i skulptorit Vojin Stojiç, faqe 50, përdoret që kjo lidhje të ndahet nga monumentet e tjerë shumë të rëndësishëm por të kundërt, të cilët janë në vijim:

Monumenti për nder të luftës së Kosovës 1389. (1953), Gazimestan, Kosovë, Aleksandar Deroko, faqe 42, i cili sot mbart vetëm mesazhin serb, duke mos marrë parasysh forcat shqiptare,

NATO (2010), Prizren, Kosovë, faqe 86, i ngitur si simbol stabiliteti, i cili mund të konsiderohet si kujtesë e vazhdueshme e paqëndrueshmërisë në Kosovë.

Gjendje e mungesës së peshës

Makineria anti-gravitet i vendos të gjithë monumentet në një “gjendje pa peshë” dhe ata notojnë në hapësirë. Të gjithë ato blloqe mermeresh dhe bakri janë çliruar nga graviteti:

- Busti i Adem Jasharit (2004), Prekaz, Kosovë, autori Mumtaz Dhrami, faqe 74,
- Njegosh (1934), Trebinje, Bosnje dhe Hercegovinë, Tomo Rosandić, faqe 38,

- Mbreti Tomislav (1997), Tomislav-Grad, Bosnje dhe Hercegovinë, Vinko Bagariç, faqe 66,
- Bill Clinton (2009), Prishtinë, Kosovë, Izeir Mustafa, faqe 83,
- Monumenti për serbët e rënë në luftërat për çlirimin e atdheut 1912-1918 nga shokët e mirë tek mirënjohja e kombit (1982), Kraljevo, Serbi, Zhivojin Lukiç, faqe 61, Sikur janë çliruar nga zinxhirët e rëndë të së shkuarës së dhunshme të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht Klinton, i cili fluturon si një tullumbace.

Universi

Në univers shohim të gjitha statujat, skulpturat dhe monumentet, por veçanërisht ato që nuk janë përdorur deri tani në film. Por, nuk shohim bustin e Boros. Kur të rivendoset graviteti, të gjithë do të bien në tokë.

Fund

Prishtinë, Kosovë

Tani shohim se si statujat bien rreth vendit ku kanë qënë bustet e Boros dhe Ramizit në Prishtinë, në Kosovë. Mirëpo, tani nuk shohim më as Ramizin sepse busti i tij nuk ka rënë tek vendi i vet. Në fakt, busti nuk është kthyer fare. Ndërsa shohim në hapësirë boshë, shohim pëllumbin që vendos lule në vendin ku kanë qënë me parë bustet. Por se çfarë ndodhi me Ramizin nuk dihet.

Titujt mbyllës

Në titujt e fundit duhej të përdornim vetëm Parkun memorial “Shumice”, Fluturimi i ndërprerë (1961), Kragujevac, Serbi, Miodrag Zhivkoviç, faqe 44, monumentin e viktimave civile të Luftës së Dytë Botërore, që mund t'i shohim në hartën e monumenteve – një klasë nxënësish që duken si kor, të cilëve kemi dashur t’ju japin zë. Ajo duhej të ishte skena kryesore, bashkë me imazhet e Qendrës memoriale “Srebrenica - Potoqari” për viktimat e gjenocidit 1995. (2003), Srebrenicë, Bosnje dhe Hercegovinë, Ahmed Džuvic dhe Ahmet Kapixhiç, faqe 70, dhe me Monumentin “e viktimave të pafajshme të agresionit të NATO kundër Jugosllavisë” (2009), shkëmbi Grdeliq, Serbi, faqe 84.

Fund

Ndryshe nga hyrja krejtësisht e animuar artistike, kemi përdorur fotografi të papërpunuara të heronjve të minierave të Lëvizjes Popullore Çlirimtare, të filmuara nga Marko Krojaq, të cilat i kemi animuar në atë mënyrë që j’u kemi dhënë zë për ti bërë të duken më realë. Monumenti akoma qëndron në kodër mbi qytetin Zveqan, afër Mitrovicës, dhe në heshtje shikon ndarjen e tij etnike.

Dinamika:

Arti që bazohet në ballafaqimin me të kaluarën zakonisht mbart në vetvete emocione të forta, kryesisht emocione të trishta. Ideja ime ishte të bëja diçka që do të tregohej me gisht në atë çfarë kemi humbur. Diçka që nuk do të shtypte ose të depresiononte shikuesit por që do ti intrigonte dhe motivonte të rizbulonin atë që e marrin për të mirëqënë. Prandaj i gjithë animacioni është pak i ngadaltë dhe i paraqitur me ngjyra të hapura. Dinamika ndryshon vazhdimisht, nga historia te eksperiencia vizuale, nga serioziteti tek qesharakja.

SHËNIM:

MONuMENTImotion është tërësisht i bazuar në katalogun MONuMENTI; sa herë që në skenar prezantohet ndonjë skulpturë e re, afër saj do të gjeni numrin e asaj skulpture në katalog. Katalogu është i disponueshëm në format PDF në DVD-në MemorImotion.



1990 Monumenti i Desanka Maksimović Valjevo, Serbi

moduli VI “Në kujtim të të tjerëve” – filmi dokumentar	
	njësia 10
tema	Shfaqje e fuqisë, kuptimi dhe fuqia e monumenteve publike
titulli	Kujtim i ngjyrosur gjinor
nëntitulli	Gjinia, përkujtimi dhe kombi
konteksti	<p>Ky leksion është i bazuar në shqyrtimin kritik dhe në diskutimin rreth filmit Në Kujtim të të Tjerëve (2015)</p> <p>të autores Ana Qigon, konkretisht (shiko DVD-në Kujtime në lëvizje me filmim si material didaktik të përfshirë në manual), por edhe në përgjithësi në shqyrtimin e marrëdhënieve mes ndërtimit të historive të mëdha kombëtare dhe gjinisë në histori dhe në përkujtim. Leksioni kombinon punën me veprën e artit – filmin dokumentar- dhe metodologjinë e bazuar në pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve dhe kërkimin si mënyrë për të hulumtuar mungesën, heshtjen dhe fshirjen e femrave dhe grupet e tjera të marginalizuara nga hapësira publike.</p> <p>Në kujtim të të tjerëve, siç vë në dukje autorja, është “dokumentari mbi rëndësinë dhe fuqinë e monumenteve publike. Në këtë film, studentët, artistët, teoricienët dhe aktivistët nga Prishtina (Kosova) flasin për rëndësinë e monumenteve. Cilët persona kanë privilegjin të tregohen nëpërmjet monumenteve? Pse në Kosovë pothuajse nuk ka monumente dedikuar femrave? Cilët janë personat (grupet e marginalizuara) dhe historitë e përjashtuara nga këto monumente. Filmi flet rreth asaj që nëse historia, domethënë historitë e grupeve të marginalizuara nuk tregohen, dhe nëse historitë dhe tregimet që janë të dukshme nuk hulumtohen, rezultati do të jetë gjithmonë një ndjesi mashtruese e normalitetit. Status quo-ja që krijon një platformë dhe që grupeve të caktuara i’u mundëson të arrijnë pozicionet me të larta, ndërsa grupet e tjera i shtyn në harresë, dhe gjithçka nën maskën e një ndjesie të rreme drejtësie dhe normaliteti. Epilogu i filmit hap rrugën për ide mbi llojet e monumenteve që njerëzit do të donin të shikonin në të ardhmen”¹.</p> <p>Në Kosovë, si dhe në gjitha kontekstet moderne të post-luftës, në të cilat ndërtimi i shtetit dhe kombit janë procese kryesore që çojnë në ndryshime shoqërore dhe politike, hapësira publike është e përmbytur nga mashkulloriteti dhe ushtria, me motivet e së shkuarës.</p>
	¹ Në MemorInmotion: DVD me material didaktik: filmi Në kujtim të të tjerëve i autores Ana Qigon

	Edhe pse Kosova është një rast interesant për t'u analizuar, që përbën dhe një nga qëllimet e këtij leksioni, është e nevojshme ndër të tjera të bëhen analiza krahasuese. Kjo e fundit është dhe qëllimi kryesor i këtij leksioni, dmth të menduarit kritik rreth lokaliteteve të ndryshme, vendeve dhe periudhave të cilat kanë krijuar hapësira publike dhe përkujtime të bazuara në përjashtimin. Duke identifikuar këto përjashtime, leksioni bëhet një mjet për të krijuar tregime, veprime dhe forma të tjera të ndryshme të ndërhyrjes së ndërmjetme, në mënyrë që lëvizjet e marginalizuara alternative politike dhe shoqërore të bëhen më të njohura.
tema të ngjashme	Kujtimet zyrtare dhe të diskutueshme dhe historia, gjinia – mashkulloriteti dhe feminiliteti, lufta, përkujtimi, Kujtimi publik dhe privat dhe hapësira, arti, shfaqja dhe fuqia
mesazhet	Vlerësimi kritik dhe feminist seksion mes gjinisë dhe kombit, e cila ka të bëjë me historinë dhe kujtimet dhe veçanërisht në përfaqësimin e tyre në monumente publike.
qëllimet	Kuptimi i rëndësinë së gjinisë në ndërtimin e kombit, të hapësirës publike dhe të së kaluarës Për të mësuar si të studiohen monumentët publikë nga perspektiva gjinore Për të mësuar se si të shihen dhe të analizohen shfaqjet vizuale Zhvillimi i aftësive për të menduar në mënyrë kritike
Rezultatet e mësimit	Mësimi dhe praktikimi i aftësive të shqyrtimit kritik të burimeve dhe krahasimi i tyre Konfirmimi i mënyrave në të cilat shfaqen meshkujt dhe femrat në hapësirën publike në kontekste të ndryshme shoqërore dhe historike, dhe veçanërisht në kontekstet e post-luftës Bërja e analizave krahasuese të përkujtimeve të post-luftës përmes prizmit të gjinisë Shpjegimi, përmes argumentit, të konstruksioneve shoqërore, politike dhe të tjera me bazë gjinore të së shkuarës Zhvillimi i aftësive të debatit dhe argumentit
kohëzgjatja	120 minuta 1. Hyrje dhe formimi i grupit: 10 minuta 2. Shikimi i filmit dhe mbajtja e shënimeve: 45 minuta 3. Puna në grupe: diskutimi 25 minuta 4. Paraqitja e gjetjeve të grupeve të punës dhe diskutimi: 30 minuta 5. Përfundimi: 10 minuta
numri i pjesëmarrësve	20–30 Rekomandohet për studentë, por është i aplikueshëm dhe për nxënës të përparuar të shkollave të mesme

metodologjia	Leksioni është realizuar përmes metodave të shumta mësimore: shikimi i filmit, puna në grup për të analizuar filmin, kërkimi në internet, prezantimet dhe diskutimi. Pjesa kryesore e kësaj metodologjie është praktika reflektive dhe për këtë arsye është kërkuar nga studentët të bëjnë kërkime online dhe të mbledhin të dhëna për diskutimin krahasues (nëpërmjet materialeve që janë paraqitur në film dhe atyre që kanë mbledhur vetë pjesëmarrësit).
procedura	<p>Pjesa hyrëse: 10 minuta</p> <p>Pjesëmarrësve i'u është paraqitur pregatitja për mësim, duke përfshirë dhe metodologjinë dhe qëllimet e pritshme dhe rezultatet. Pjesëmarrësit janë ndarë në katër grupe, temat për secilin grup janë ndarë dhe kërkohet nga ata që gjatë shikimit të filmit të marrin shënime në përputhje me pyetjet e përmendura më poshtë (10 minuta)</p> <p>Pjesa kryesore: 100 minuta = 45 + 25 + 30</p> <p>Pjesëmarrësit shohin filmin Në kujtim të të tjerëve (45 minuta). Gjatë filmit duhet të mbahen shënime me kujdes sepse ato do të shërbejnë për punën në grup.</p> <p>Puna në grup (25 minuta) Pjesëmarrësve të secilit grup, të cilëve i'u janë dhënë temat, janë të lutur të hartojnë ato që konsiderojnë si argumentet kryesorë të theksuar në film në lidhje me monumentët publikë. Konkretisht, do të thotë që nga ata kërkohet që ndërsa vëzhgojnë monumentët publikë dhe temat e dhëna, të shkruajnë argumentat kryesorë të vetë filmit, si dhe argumentet e personave të intervistuar në film.</p> <p>Grupi 1: Gjinia – mashkulloriteti dhe feminiliteti Grupi 2: Hapësira publike – përfshirja dhe përjashtimi Grupi 3: Historiografia kombëtare, kujtimet private dhe publike Grupa 4: Kërkimi online</p> <p>Ky grup ka si detyrë të kryejë kërkime në internet në mënyrë që të gjejë shembuj që janë të krahasueshëm me ato të paraqitur në film. Kërkimi i tyre duhet të fokusohet tek pyetjet e renditura më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikoni personin/vendin/ndodhinë – Çfarë përfaqëson ajo/çfarë do të thotë? – Kush është personi/cilët janë njerëzit që shfaqen aty? Kë përfaqësojnë ata? – Cila është historia zyrtare? Kush është përgjegjës për t'a treguar? – Çfarë historish të tjera ekzistojnë? Kush janë mbartësit e tyre?

	<ul style="list-style-type: none"> – A ka marrëveshje/mosmarrëveshje në lidhje me atë person/me atë ngjarje/vend? Si manifestohen ato? – Për çfarë qëllimesh – shoqërore, kulturore, politike, ekonomike shërben? – Cila është audienca e lidhur me atë person/ngjarje/vend? – Si kanë ndryshuar historitë dhe imazhet (në kuptimin e formës dhe përmbajtjes) gjatë periudhave të ndryshme? Cilët kanë qënë iniciatorët (shoqërorë, politikë, ekonomikë) të ndryshimeve? <p>Prezantimi i gjetjeve të grupit dhe diskutimi – 30 minuta Secili grup ka në dispozicion 5 minuta që të paraqesë në mënyrë konçize rezultatet e ushtrimit në grup. Koha e mbetur përdoret për diskutim.</p> <p>Pjesa mbyllëse: 10 minuta</p> <p>Mbyllja e seminarit – 10 minuta</p>
materiale	tabelë, projektues, fletore, aparat fotografik, lapsa dhe lapsa me ngjyra
burimet	<p>Në kujtim të të tjerëve. Ana Qigon, 2015.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manuali “MemorInmotion” – Mjet pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve, botim i ri 2016. • Moduli II, pregatitja për mësimin 2: “Çfarë është monumenti?” dhe biografia e monumentit në manualin “MemorInmotion” – Mjet pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve, botimi i ri 2016. • Moduli II, pregatitja për mësimin 4: “Këto janë kujtimet/monumentet e mia” në manualin “MemorInmotion” – Mjet pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve, botimi i ri 2016. • Moduli II, pregatitja për mësimin 5: “Monumenti im ideal” në manuali “MemorInmotion” – Mjeti pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve, botimi i ri 2016. • Moduli V, pregatitja për mësimin 9: MOnuMENTImotion, “Momentet dhe monumentet në lëvizje” në manualin “MemorInmotion” – Mjet pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve, botimi i ri 2016.

<p>literaturë shtesë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Davis-Yuval, Nira dhe Floya Anthias. 1989. Women-Nation-State [Femrat –Kombi –shteti], New York: St. Martin’s Press. Kapitulli 1. dhe Kapitulli 4. • Chaterjee, Partha. 1993. The Nation and Its Fragments: Colonial and Postcolonial Histories [Historitë koloniale dhe post-koloniale], Princeton, NJ: Princeton University Press. • Mayer, Tamar. 2012. Gender Ironies of Nationalism [Ironitë gjinore të nacionalizmit], Routledge. • Ivekovic, Rada dhe Julie Mostov. 2002. From Gender to Nation [Nga gjinia te kombi], Ravena: Longo Editore. • Krasniqi, Vjollca. 2007. “Imagery, Gender and Power: The Politics o Representation in Post-War Kosova. [Imazhet, gjinia dhe fuqia: Politika e përfaqësimit në Kosovën e post-luftës]”, Feminist Review 86 (July): 1–23. • Luci, Nita dhe Linda Gusia. 2014. “Our men will not have amnesia”: Civic Engagement, Emancipation, and Gendered Public in Kosovo. In Civic and Uncivic values in Kosovo: Value Transformation, Education, and Media, edited by Sabrina P. [Burrat tanë nuk do të kenë amnezi: angazhimi qytetar, emancipimi dhe publiku gjinor në Kosovë. Në publikimin vlerat qytetare dhe joqytetare në Kosovë: transformimi i vlerave, arsimit dhe media, redaktoi Sabrina P. Ramet, Albert Simkus dhe Ola Listhaug, Central European University Press.
<p>aktivitete shtesë</p>	<p>Propozim për aktivitet shtesë: 120 minuta</p> <p>Kërkoni nga pjesëmarrësit që në grupe, të përpiqen të bëjnë përgatitjen për orën e mësimin në bazë të këtyre përgatitjeve duke u fokusuar në një shembull të përjashtimit gjinor në një kontekst të ndryshëm kombëtar. Kërkoni nga ata që këtë përgatitje për mësimin t’a ndajnë me autorët dhe partnerët që kanë punuar në përgatitjen e mjetit pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve në “MemorInmotion” dhe me artisten Ana Qigon.</p>



Kuadër nga filmi: INDEXI (DAVORIN) dhe MIRZA, Instituti Publik Gjinnazi Obala Sarajevë

moduli VII Monumentët modernë për të ardhmen	
	njësia 11
tema	Si kujton brezi i ri
titulli	INDEXI (DAVORIN) dhe MIRZA – Romantikët e fundit
nëntitulli	Arti, sporti dhe monumentët
konteksti	<p>Romantikët e fundit</p> <p>Davorin Popoviç Pimpek (Këngëtar) i lindur në Sarajevë, në vitin 1946. Ai ka studiuar në Fakultetin e Shkencave Politike në Sarajevë, dhe që në moshë të re është marrë me volejball dhe basketboll. Në basketboll ai ishte një nga lojtarët më të talentuar që Sarajeva kishte në atë kohë. Ai ishte kapiten i skuadrës Mlada Bosna dhe si lojtar standart i ekipit të parë, ka luajtur mbi 500 ndeshje. Ai nuk u mor më me sport që nga viti 1968 kur i'u përkushtua tërësisht muzikës. Ai ka qënë i famshëm si këngëtar i grupit Indexi, që nga viti 1964. Pimpek ka qënë heroi i kohës së tij. Yll i madh i muzikës në ish Jugosllavi. Ai ka marrë pjesë në Eurosong, dhe ka lënë pas vetes shumë hite muzikore që pasqyrojnë vlerat e kohës në të cilën jetoi dhe pikëpamjet e tij mbi jetën. Ai ishte fitues i çmimit të Gjashtëprillit të Qytetit të Sarajevës që i'u jepet artistëve më të shquar në fushën e tyre. Ai vdiq në vitin 2001 nga kanceri.</p> <p>Bashkëkohësi dhe miku i tij Mirza Delibashiç Kingje lind në Tuzla në vitin 1954 në një familje minatorësh. Që në moshë të vogël ishte i aktivizuar me sportin, ndërsa suksesin e tij të parë të madh e arriti në vitin 1968 si kampion tenisi në Bosnje dhe Hercegovinë. Megjithatë, sportit të cilit ai i'u dedikua deri në fund të karrierës ishte basketbolli, fillimisht në klubin sportiv të Tuzlës “Sloboda” dhe që nga viti 1972 luajti për klubin sportiv të Sarajevës “Bosna”. Për Studentët luajti rreth 700 ndeshje dhe bëri rreth 14.000 kosha. Ishte kampion Jugosllavie në vitin 1978 dhe 1980, dhe kampion klubi në Europë në vitin 1979, dhe me klubin kombëtar të Jugosllavisë fitoi të gjitha trofetë. Dy herë ka qënë kampion Europe (në vitin 1977 dhe 1979) dhe kampion olimpik në vitin 1980. Në vitin 1980 u shpall basketbollisti më i mirë i Jugosllavisë. Ka luajtur për Real-in e Madridit dhe ishte trajner i përfaqësueses së BeH në vitin 1993. Ishte fitues i çmimit të Gjashtëprillit në vitin 1976.</p> <p>Këta dy miq të mirë me shembullin e jetës së tyre lanë shenjë në qytetin dhe shtetin e tyre. Vlerat me të cilat jetuan dhe të cilat i theksuan ishin nderi, respekti, humaniteti, dashuria, shpresa dhe ëndërrimi. Ishin shembull i përkushtimit ndaj qëllimeve dhe dashurisë. Dashurisë ndaj ëndrrave, njeriut dhe shokut...</p>

	Duheshin nga qyteti i tyre, dhe mbahen mend si romantikë të sinqertë dhe bohem nga mënyra se si jetonin. Të dy vdiqën në të njëjtin vit nga e njëjta sëmundje. Në ditët e sotme për nder të Davorin Popoviç jepet çmimi muzikor Davorin dhe organizohet turneu i basketbollit për basketbolliste, ndërsa për nder të Mirza Delibashiç organizohet turneu i basketbollit për basketbollista. Përpara FIS-it në Sarajevë, ku zakonisht uleshin dhe pinin kafe, qëndron monumenti i Këngëtarit dhe Kingjetës!
tema të ngjashme	Kujtime në lëvizje, historia lokale/rajonale
mesazhet	Të vihet re deri në çfarë mase shembujt pozitivë të njerëzve që shënuan një periudhë mund të qëndrojnë si mesazh universal i njerëzores, nderit dhe respektit. Konsiderimi i vlerave njerëzore që sot mbizotërojnë në jetën publike si mesazh dhe si shembull jete.
qëllimet	Zhvillimi tek pjesëmarrësit i qëndrimit kritik ndaj kohës në të cilën jetojnë përmes analizës së monumenteve të heronjve urbanë të një periudhe.
Rezultatet e mësimit	Pjesëmarrësit shqyrtojnë marrëdhënien e gjeneratës së tyre ndaj të shkuarës përmes analizës së filmit, por dhe marrëdhënien e shoqërisë së sotme ndaj një periudhe dhe japin një rishikim kritik në lidhje me shkatërrimin e monumenteve kulturore në qendër të Sarajevës.
kohëzgjatja	60 minuta Pjesa hyrëse: 15 minuta Pjesa kryesore: 25 minuta = 5 + 10 + 10 Pjesa e fundit: 20 minuta
numri i pjesëmarrësve	20–30
metodologjia	Pjesëmarrësit me anë të punës individuale dhe punës në çift/grup, dhe me analizën e filmit dhe diskutimin do të nxjerrin përfundime dhe do të japin përgjigje për pyetjet kyçe.
procedura	Pjesa hyrëse: 15 minuta Pjesa e 1: 5 minuta Hapet tema e bashkëbisedimit përmes pyetjeve Pyetjet e mundshme: 1. A janë të njohur për ju emrat Mirza Delibashiç dhe Davorin Popoviç/Indexi? 2. A keni ndonjë njohuri rreth tyre? Shkruani në letër se me çfarë i lidhni këta dy burra. Çdo pjesëmarrës dorëzon letrën e tij, të cilat moderatori i vendos në tabelë.

Pjesa e 2: 10 minuta

Pjesëmarrësve t'ju jepet detyrë që të punojnë në dyshe dhe të gjejnë në google.com informacionet që ekzistojnë rreth tyre, dhe pastaj të vazhdojnë diskutimin me ndihmën e pyetjeve.

Pyetjet e mundshme:

1. Cilat janë pikëpamjet tuaja në lidhje me vlerat që lidhen me ata?
2. A mund të njihen dhe të pëmdenden vlerat e përgjithshme të pranuarat të figurave publike?
3. Çfarë mesazhi kanë përcjellë ata te bashkëkohësit?

Bashkëbisedimi me pjesëmarrësit mbi gjetjet e kërkimeve të tyre. Qëllimi i këtij aktiviteti është të vërehen se sa të vërteta ose të rreme janë informacionet (njohuritë) origjinale rreth atyre të dyve. Nëse mes pjesëmarrësve ka nga ata që në letër kanë shkruar informacione të sakta, të përgëzohen për informatat dhe njohuritë e tyre.

Pjesa kryesore: 25 minuta = 5 + 10 + 10

Pjesa e 1: 5 minuta

Të shkruhen pyetjet e mundshme që do të jenë subjekt analize dhe diskutimi pas shfaqjes së filmit.

Pyetjet e mundshme:

1. Nga çfarë është ndërtuar monumenti dhe ku ndodhet?
2. Cilat janë arsyet për ngritjen e këtij monumenti? Cili është mesazhi fillestar që duhej t'ju dërgonte kalimtarëve?
3. Në çfarë gjendje është monumenti sot? Si reagojnë gjeneratat e reja në lidhje me atë çfarë monumenti përfaqëson si vlerë universale?

Pjesa e 2:

10 minuta Shfaqja e filmit

Pjesa e 3: 10 minuta

Ndarja e pjesëmarrësve në grupe që të materializojnë në letër përshtypjet e tyre, të diskutojnë rreth pyetjeve të shtruarat dhe eventualisht të shtojnë disa fusha të tjera në të cilat filmi mund të përdoret

	<p>Pjesa e fundit: 20 minuta pjesa 1: 10 minuta Prezantimi i pikëpamjeve të grupeve në lidhje me temën dhe pyetjet dhe diskutim i përbashkët</p> <p>Pjesa 2: 10 minuta Rrethi final i prezantimeve të qëndrimeve dhe përshtypjeve të tyre me ndihmën e pyetjeve kyçe.</p> <p>Pyetjet kyçe: – A mund të flasim për monumentet si “jehona e ndërgjegjes” në ditët e sotme? – Në çfarë shkalle monumentet flasin për momentin e tanishëm, dhe në çfarë shkalle flasin për të shkuarën? – Çfarë tregon (flet)për vetë ne marrëdhënia jonë ndaj monumenteve?</p>
materiale	Pjesa 2: Film i shkurtër Indexi dhe Mirza Pjesa 3: Fotografia e monumentit të Mirza Delibashiç dhe Davorin Popoviç
burimet	DVD e përfshirë në manualin “MemorInmotion” – Mjet pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve / film i shkurtër Indexi dhe Mirza, Institucioni Publik Gjinnazi Obala Sarajevë
literaturë shtesë	Nga: “MemorInmotion” – Mjet pedagogjik për temën mësimore Kultura e kujtimeve: <ul style="list-style-type: none"> • Modul II • Modul III • Modul IV • Modul V • Modul VI
aktivitete shtesë	Njohja me biografinë, veprat dhe arritjet e Davorin Popoviç dhe Mirza Delibashiç Vizita studimore dhe eksplorimi i monumentëve modernë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor

ese

Krijimi i kulturës aktive të kujtimit me fuqizimin e mësuesve: Inkurajimi i të rinjve përmes pedagogjisë kritike dhe edukimit për paqe

Dr. Larisa Kasumagiç-Kafexhiç

“(…) si mësuese, jam përpjekur që nxënësit e mi të mësojnë atë që mësuesit e mi nuk kanë arritur të më mësojnë mua – që historia në një shkollë të madhe është rezultat i vendimeve të njeriut, se parandalimi është i mundshëm dhe arsimit duhet të ketë një komponent moral, nëse dëshiron të kontribuojë për ndryshime. Ballafaqimi më të shkuarën bazohet në këto besime. Gjithashtu është i bazuar dhe në besimin që arsimimi në demokraci duhet të jetë, siç e ka thënë një herë Alexis Tocqueville, “të mësuarit në liri”. Kjo do të thotë që arsimimi duhet të promovojë qëndrimet, vlerat dhe aftësitë e nevojshme për të jetuar në liri.”¹

(Margot Stern Strom²; sipas Barr, 2005)

Në Bosnje dhe Hercegovinë jemi dëshmitarë të ndryshimeve që ndodhin vazhdimisht në procesin e edukimit dhe arsimit: ndryshimeve në arsimin tetëvjeçar me futjen e shkollimit të detyrueshëm nëntëvjeçar; përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimi; ndryshimet në arsimin e mësuesve të të gjitha lëndëve; reformat kurrikulare dhe zhvillimi i bërthamës së përbashkët për fusha të lëndëve të ndryshme. Shumë prej ndryshimeve që shohim shpesh vënë theksin në përmbytjen e formës që në thelb nuk ka të bëjë me ndryshimet e lëvizjeve shoqërore. Ndryshimet që do të ishin të drejtuara në ndërtimin e grupeve korrekte shoqërore dhe të cilat duhet të zënë fill në klasë dhe në mbajtjen e politikave cilësore mësimore, angazhimit moral dhe dedikimit profesional të menaxhimit të shkollës, nxënësve dhe mësuesve, në një masë të madhe janë pasqyrë e kontekstit social në të cilin dhe shkollat “jetojnë” çdo ditë realitetin social të past luftës –

-
- 1 “(…) as a teacher, I tried to ensure that my students learned what my own teachers failed to teach – that history is largely the result of human decisions, that prevention is possible, and that education must have a moral component if it is to make a difference. Facing history is based on those beliefs. It is also based on the conviction that education in a democracy must be what Alexis de Tocqueville once called an ‘apprenticeship in liberty’. That is, it must promote the attitudes, values, and skills needed to live in freedom” (Barr, 2005).
 - 2 Një nga themeluesit e Organizatës “Facing History and Ourselves” (<http://www.facinghistory.org/>), Presidente dhe Drejtoreshë ekzekutive. Margot Strom shpjegon vizionin e arsimit në parathënien e librit “Holokausti dhe sjellja njerëzore” (engl. Holocaust and Human Behavior)

fjalimet dominante politike të fuqisë dhe ndarjet e institucionalizuara, të cilat nuk mund të neglizhohen sepse si të tilla janë përgjegjëse për hapjen e frikës nga gjithçka çfarë është ndryshe. Në kompleksitetin e shumë çështjeve me të cilat Bosnja dhe Hercegovina ballafaqohet dhe njëzet vite pas përfundimit të luftës pyesim se ku është më e mira të fillojmë me ndryshimet që ato të jenë cilësore, kuptimplota dhe të marrin fill në praktikën pedagogjike, dhe që të ndodhin në fushën e zgjidhjeve të sistemit dhe politikave arsimore. Në mungesë të reformave të gjëra të sistemit që do ti përgjigjeshin kompleksitetit të të gjithë sfidave të arsimit në shoqërinë e past konfliktit, iniciativat e edukimit dhe arsimit në nivel lokal, formal dhe joformal vazhdojnë të paraqesin mundësinë e fuqizimit të atyre individëve, mësuesve dhe aktivistëve të ndërgjegjësuar moralisht dhe shoqërisht, që temat e kulturës së kujtimeve dhe ballafaqimit me të shkuarën të përfaqësojnë dhe të hulumtojnë kontekstin e arsyeshmërisë relevante pedagogjike dhe principet metodike dhe didaktike. Iniciativa të tilla arsimore theksojnë nevojën për gjetjen e mënyrave të reja për t'u ballafaquar me të shkuarën, për ballafaqim me tregimet historike dominante dhe për të hulumtuar konceptet e përcaktuara të identitetit, që të inkurajohen të rinjtë që të mendojnë në mënyrë kritike rreth procesit të përkujtimit dhe për të njohur rolin e tyre dhe përgjegjësitë në procesin e ndryshimeve. Në këto lloj marrëdhëniesh kritike- pedagogjike ndaj temave të identitetit, përkatësisë, ballafaqimit me traumat dhe me kujtimet e dhimbshme, i jepet mundësia të rinjve që në vete procesin e dialogut të fuqizohen dhe të shohin përgjegjësitë dhe rolin e tyre në procesin e vendimarrjes dhe në procesin e rimëkëmbjes së shoqërisë së past-konfliktit.

Fuqia që konceptualisht kontrollon ndryshimet në drejtim kryesor është e pranishme në literaturë dhe e drejtuar në fenomenin e pedagogjisë kritike. Kjo pedagogji në thelbin e saj është një filozofi arsimore që inkurajon pedagogët dhe mësuesit që profesionin e mësimdhënies ta kuptojnë si një proces dinamik në të cilin dituria konstruktohet (Banks, 1994) në ndërveprim me studentët, dhe jo si një rrjedhë e paracaktuar në të cilën është e nevojshme që dija ekzakte t'ju përcillet studentëve (Freire, 1974, 1995, 1998; Giroux, 1992, 1997; sipas: Byram, Feng 2004). Përkrahësit e pedagogjisë kritike konsiderojnë që në procesin mësimor i cili është i përcaktuar në këtë mënyrë, nxënësit nuk duhet të jenë konsumatorët pasiv, por krijuesit aktiv të dijes të cilët janë angazhuar në zhvillimin krijues kulturor (Byram, Feng, 2004:158).

Në kuadër të pedagogjisë kritike, arsimi shihet si proces i të mësuarit i cili është çlirues dhe në të cilin të gjithë individët pa dallim klase, race, gjinie, gjuhe, prejardhje apo përkatësie etnike bëhen të vetëdijshëm për aftësitë e tyre për të promovuar ndryshime efektive të cilat çojnë në avancimin e shoqërisë. Pedagogjia kritike në këtë mënyrë ndihmon studentët të dekonstruktojnë idetë e formuara më përpara, të cilat janë në shërbim vetëm të grupeve dominante dhe rrëfimeve dominante. Kjo qasje çon në procesin e çlirimit që promovon transformimin e qënieve, ndërsa procesi i dialogut retrospektiv është një ndër mënyrat për të arritur vetëdijen rreth transformimit. Reflektimi luan një rol kyç në këtë proces sepse lejon vështrimin prapa dhe n'a ndihmon që përvojat tona të mëparshme t'i lidhim me realitetin e tanishëm dhe të ndërtojmë një kuptim të ri. Ideja e ndërgjegjësimit³ (angl. conscientization, critical consciousness, consciousness raising) i referohet zhvillimit të vetëdijes së individit në shoqëri dhe çdo person duhet të kalojë përmes atij procesi (Freire, 1998). Në këtë lloj klime pedagogjike, të rinjtë bëhen të vetëdijshëm për rolin e tyre në procesin e përkujtimit, lirojnë zërat e shtypur dhe inkurajohen për përdorimin e argumentit dhe faktit përmes analizës multiperspektive dhe dialoguese.

Pedagogjia e paqes është “filozofia dhe procesi që përfshin aftësitë, të tilla si dëgjimi, reflektimi, zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi dhe zgjidhja e konflikteve; ky lloj procesi nënkupton fuqizimin e njerëzve përmes aftësive, pikëpamjeve dhe dijeve që i ndihmon të krijojnë një botë më të sigurtë në një mjedis të qëndrueshëm” (Harris & Morrison, 2003:9; cit. sipas: Opatow, Gerson, Woodside, 2005). Për të qënë efektiv, *arsimi i paqes* duhet të shmangë fokusin e kufizuar, i cili romantizon vizionin e paqëndrueshëm dhe stabël të paqes dhe në vend të tij të përpiket të paraqesë natyrën dinamike dhe të menjëhershme të tensioneve shoqërore me qëllim shqyrtimin e sistemeve sociale të cilat institucionalizojnë pabarazinë dhe padrejtësinë (Opatow, Gerson dhe Woodside, 2005). Edukimi për paqe është në thelb dinamik, interdisiplinar dhe multikulturor dhe ka ardhur nga puna e shumë pedagogëve të shquar dhe aktivistëve të paqes, siç janë John Dewey, Maria Montessori, Paulo Freire, Johan Galtung, Elise dhe Kenneth Boulding dhe shumë të tjerë.

3 Termi në anglisht *conscientization* është përkthim nga termi portugez *conscientizaçã*, të cilin e ka popullarizuar pedagogu brazilian, aktivisti dhe teoricieni Paulo Freire në librin e tij “Pedagogjia e të shtypurve” (*Pedagogy of the Oppressed*, 1970).

Paqja nënkupton një vetëm mungesë të formave të dukshme tradicionale të dhunës por edhe praninë pozitive të mirëqënies, të drejtësisë sociale, barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut. Edukimi për paqe nuk i mëson nxënësit rreth asaj se çfarë duhet të mendojnë, por se si të mendojnë në mënyrë kritike, dhe këto principe ndërthuren me pedagogjinë kritike; edukimi për paqe nuk ka si qëllim riprodhimin e njohurive, por transformimin dhe si i tillë rrjedh nga transformimi i të mësuarit, dhe qasjet që përdoren në vetë mësimin janë të shenjta dhe pjesëmarrëse.

Për një transformim të ngjashëm flet dhe Swee-Hin (1997) duke e quajtur atë “fuqizim kritik”:

“Nëse edukimi për paqe nuk është në gjendje ose nëse nuk do të inkurajojë jo vetëm mendimet tona por edhe zemrat dhe shpirtin për veprim personal dhe shoqëror në kuadrin e ndërtimit të paqes, atëherë ushtrimi “akademik”, do të qëndrojë si i pajetë madje edhe në kontekstin e edukimit joformal(...) Ndërkohë që arsimit joformal konsiderohet shpesh si një habitat natyror për fuqizimin kritik, institucionet e arsimit formal duhet që në të njëjtën mënyrë të inkurajojnë nxënësit për transformim.”⁴

Kujtime në lëvizje – Mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve me vizionin e tij kreativ influencon të rinjtë që të bëjnë shumë pyetje për hulumtimin e historisë, tregimeve dominante dhe mbizotëruese mbi monumentet dhe lokalitet përkujtimore në Ballkanin Perëndimor dhe rolet e artit dhe të artistit në procesin e përkujtimit dhe të ballafaqimit me të shkuarën. Këto lloj mjetesh kanë si qëllim të influencojnë të rinjtë për veprim social në ruajtjen dhe ndërtimin e paqes, ndërsa roli i mësuesit dhe edukatorit në kontekstin e edukimit-arsimit formal dhe joformal është kryesor në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe empatik i cili rezulton në “fuqizimin kritik”.

(Swee-Hin, 1997; cit. sipas: Clarke-Habibi, 2005)

4 “If peace education is not able or willing to try to move not just minds but also hearts and spirits into personal and social action for peacebuilding, it will remain emasculated, a largely “academic” exercise even in the non-formal context... While the non-formal community sector is often seen as the “natural” site for critical empowerment, the formal education institutions should also challenge learners towards transformation.” (Swee-Hin, 1997; cit. sipas: Clarke-Habibi, 2005)

Lloji i seminarit në punën pedagogjike i lejon edukatorët të influencojnë të rinjtë në lidhje me analizën kritike duke përdorur aktivitete dhe strategji të shumta ndërvepruese dhe bashkëpunuese, si dhe video materialet të cilat reflektojnë strategjitë e vërteta pjesëmarrëse sepse të rinjtë kanë marrë pjesë në procesin e zhvillimit, regjistrimit, rishikimit të rolit të përkujtimit, krijimin dhe montimin e tregimeve të paraqitura historike. Duke pasur parasysh se materialet janë të disponueshme në gjuhë të ndryshme, ekziston mundësia për përdorim në seminare ose adaptim të aktiviteteve përkatëse dhe materialeve në fusha të ndryshme lëndore, në këtë mënyrë do të inkurajohet lidhja ndër-kurrikulare e temave dhe përmbajtjeve dhe identifikimi i objektivave ndërkulturorë, edukimit dhe arsimit qytetar të paqes, të cilët zënë një vend të rëndësishëm në objektivat e fushave dhe kurrikulave të shumta shoqërore dhe humaniste.

Iniciativat arsimore në Bosnje dhe Hercegovinë që përdorin qasje dhe strategji pjesëmarrëse dhe holistike, të cilat rezultojnë me aktivizmin e të rinjve të motivuar për transformimin e shoqërisë dhe ndërtimin e paqes, tani për tani “mbarten” nga individë të dedikuar dhe të ndërgjegjshëm, pedagogë, aktivistë dhe mësues që transformojnë botën duke transformuar veten e tyre dhe klasat e tyre, të cilët dhe vetë kanë kaluar përmes rrugës së zhvillimit të ndërgjegjes dhe kanë identifikuar përgjegjësinë e tyre morale dhe sociale të kodit të tyre pedagogjik. Institucionet e edukimit dhe arsimit, kryesisht fakultetet pedagogjike dhe institucionet kërkimore duhet që në të njëjtën mënyrë të marrin përsipër rolin në nisjen e iniciativave të tilla dhe në shtrimin e pyetjeve rreth rëndësisë dhe rolit të rëndësishëm të edukimit në shoqëritë e post-konfliktit. Nëse edukimi nuk është i bazuar në principet kritike-pedagogjike dhe humaniste, ballafaqimi me të shkuarën do të mbetet vetëm një imazh në pasqyrën e realitetit shoqëror të fragmentimit, ndarjes dhe diskursit dominues politik të pushtetit. Nëse edukimi nuk është në gjendje ose nëse nuk do të inkurajojë të rinjtë për aktivitet shoqëror dhe ndërtim të paqes, atëherë “do të mbetet si i pajetë dhe mbi të gjitha ushtrimi akademi.

autorët

Manual:

Laura Boerhout është historiane, që studion transferimin ndër breza të kujtimeve të luftës në Bosnje, në Universitetin e Amsterdimit, si dhe edukatore në Shtëpinë e Anne Frank (Anne Frank House), përgjegjëse për organizimin e seminareve për të rinjtë rreth monumenteve dhe kujtimeve. Së bashku me Iniciativën e të rinjve për të drejtat e njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë organizoi Shëtitjen ndër kujtime në Sarajevë dhe Shëtitjen ndër kujtime në Mynih.

Bojana Dujkoviç-Blagojeviç është diplomuar në Universitetin e Banja Llukës për histori ku ka mbaruar dhe masterin. Mësuese, autore dhe redaktore e materialeve mësimore shtesë, gjithashtu dhe anëtare e UO EUROCLIO - HIP BeH.

Melisa Foriç është historiane nga Sarajeva, autore dhe bashkëautore e disa teksteve historie për shkollat fillore dhe të mesme. Ajo është anëtare e Shoqatës së mësuesve dhe profesorëve të historisë në Bosnje dhe Hercegovinë EUROCLIO-HIP BeH. Ajo është e punësuar në Qendrën për Studime Ballkanike në Akademinë e Shkencave dhe Artit në Bosnje dhe Hercegovinë.

Senada Jusiç është historiane dhe anëtare e Shoqatës së mësuesve dhe profesorëve të historisë në Bosnje dhe Hercegovinë EUROCLIO-HIP BeH. Ajo jep mësim në shkollën fillore dhe të mesme, ka marrë pjesë në një sërë konferencash dhe projektesh në fushën e kërkimit dhe analizës së ndërtimit historik, metodave të reja të mësimdhënies së historisë, dhe në projekte për ndalimin e diskriminimit.

Muhamed Kafexhiç Muha është profesor i edukimit dhe arsimit në fushën e artit dhe mjeshtër i pikturës, jeton dhe punon në Sarajevë si artist i pavarur.

Vjollca Krasniqi është sociologe dhe asistente profesore në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Prishtinës. Ajo është bashkëkryetare e Programit Universitar për studime gjinore dhe kërkime. Ajo ka shkruar rreth temave të ndryshme në lidhje me rindërtimin e pastluftës në Kosovë me fokus në çështjet gjinore, kombëtare, ndërtimit të shtetit dhe drejtësisë tranzicionale.

Larisa Kasumagiç-Kafexhiç është aktiviste shumëvjeçare në fushën e edukimit dhe arsimit të paqes, filozofisë së jo-dhunës dhe edukimit ndërkulturor. Ajo aktualisht punon në Departamentin e gjuhës angleze të Fakultetit të Filozofisë në Sarajevë në grupin e lëndëve pedagogjike të drejtimit të mësimdhënies.

Nita Luci është lektore në Departamentin e antropologjisë në Universitetin e Prishtinës. Puna e saj aktuale në temën e politizimit të kujtimeve si pjesë e programit të Universitetit për studime gjinore dhe kërkime fokusohet në mashkullizimin në Kosovë.

Nicolas Moll, doktor shkencash në fushën e historisë bashkëkohore është historian dhe lektor në fushën e bashkëpunimit ndërkulturor dhe ballafaqimit me të shkuarën. Ai është profesionalisht aktiv në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Europës Perëndimore, por gjithashtu punon dhe si koordinator i platformës europiane për shkëmbim Memory Lab.

Michele Parente për 18 vjet punon si pedagog social dhe ekspert për zgjidhjen e konflikteve civile dhe punës së paqes. Nga viti 2008, ai kryen funksionin e menaxherit të projektit *forumZFD* në Bosnje dhe Hercegovinë.

Wouter Reitsema është historian i specializuar i teorisë post-koloniale, post-1975 diaspora vietnameze dhe lufta e ftohtë në Hollandë dhe aktualisht punon për Anne Frank House dhe për Fondacionin Demokracia dhe mediat në Amsterdam (Hollandë).

Konsulentët:

Suad Aliç për 18 vjet punon në shkollën e mesme dhe për 4 vjet kryen funksionin e drejtorit të shkollës. Nga viti 2007 është përfaqësues i përhershëm i BeH në Këshillin European përsa i përket arsimit qytetar dhe programit EDC.

Andrea Baotić është diplomuar për histori arti dhe studime Romane. Ajo punon si asistente profesore dhe kërkuese shkencore në Katedrën për histori arti të Universitetit të Sarajevës.

Judith Brand që nga qershori i vitit 2014 është menaxhere e programit *forumZFD* në Bosnje dhe Hercegovinë. Me profesion është punëtore sociale ndërsa diplomën e masterit e ka fituar pas përfundimit të studimeve të Europës Lindore. Ajo ka fituar përvojë pune të konsiderueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Elma Hashimbegović është historiane dhe konsulente muzeu. Aktualisht kryen funksionin e drejtoreshës së Muzeut Historik të Bosnje dhe Hercegovinës në Sarajevë.

Adis Hukanović ka mbaruar masterin për psikologji dhe është aktivist i paqes. Ka punuar për Iniciativën e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR BeH), në Shoqatën e Grave të Prijedorit “Izvor” nga Prijedorit dhe në Progarmin Amerikan për liderët e rinj. Që nga prilli i vitit 2016 punon si projekt koordinator në organizatën *forumZFD* në Sarajevë.

Alma Mashić që nga viti 1994 është e përfshirë në sektorin e shoqërisë civile në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ka njohuri të mëdha rreth zhvillimit të shoqërisë civile dhe çështjeve të demokracisë në Ballkan, por kryesisht merret me temat që kanë të bëjnë me ballafaqimin me të shkuarën dhe drejtësinë tranzicionale për viktimat dhe të rinjtë.

Nerkez Opaqin është lektor në Departamentin për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin Ndërkombëtar në Sarajevë. Interesat e tij kërkimore janë analiza dhe zgjidhja e konflikteve, studimet e paqes dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Christian Pfeifer është diplomuar nga Departamenti i shkencave politike, gjuhës serbo-kroate, letërsisë dhe historisë. Që nga viti 2008 është menaxher rajonal i programit *forumZFD* për rajonin e Ballkanit Perëndimor me bazë në Beograd.

Soraja Zagiç ka mbaruar programin e masterit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Bolonjës / Universiteti i Sarajevës. Ajo punon si menaxhere projekti në organizatën *forumZFD* në Bosnje dhe Hercegovinë.

DVD: filma të shkurtër, dokumentari dhe videoklipët

Pjesëmarrësit dhe bashkëautorët e filmit të shkurtër të animuar MONUMENTImotion: Dukagjin Borova, Ardi Borova, Edita Dauti, Paula Feicke, Ermira Gega, Dejan Kosaniç, Andrea Kovaqeviç, Moritz Kremer, Bleron Krivanjeva, Branislav Pantiç, Filip Pantiç, Tonin Tarquki, Luka Tilinger, Marko Krojaq, Jan-Alex Niklas Wahl, Fabian Hanschen, Michele Parente, Muhamed Kafexhiç Muha.

Pjesëmarrësit dhe bashkëautorët e Shëtitje ndër kujtime (Memory walk) në Sarajevë dhe Shëtitje ndër kujtime (Memory walk) në Mynih. Videoklipët: Filip Bojaniç, Nermin Shehiç, Boris Batkoviç, Amir Haskiç, Nejra Oruç, Sejdefa Ibisheviç, Naida Hoxhiç, Kenan Muriç, Daniel Zerem, Hana Qurak, Sabina Hajdareviç, Marko Matoviç, Aida Durakoviç, Amar Kolashinac, Amina Alijagiç, Dalila Zaimoviç, Emina Adiloviç, Alexander Bayer, Vanessa Binder, Alina Feldmeier, Alexander Gebhardt, Monika Karlinger, Carina Klein, Veronika Kribitzneck, Nicolas Weigel, Jessica Weiß, Bastian Wirthmann. Falënderime dhe për: Nina Sheremet, Nicolas Moll, Yan Paul Dubbelman, Lukas Ellmer, Aaron Peterer, Alma Mashiq, Chloe Grant, Lamija Landžo, Inga Kotlo, Wouter Reitsema, Martina Bachmann, Sacha Bertram, Tobias Traxler, Paul Grabenberger.

Autorë/et e filmit të shkurtër “Indexi dhe Mirza” nga Institucioni Publik Gjinnazi Obala Sarajevë: Amila Mashoviç; Ajna Grabus; Armin Papoviç; Benjamin Fazliç; Ilma Subotiç; Tija Hajro; Lejla Smjeqanin; Ena Qengiç; Kerim Hoxhiç dhe profesor Irfan Kubat.

Autorja e filmit dokumentar “Kujtime për të tjerët”: Ana Qigon, artiste çmimesh dhe rregjizore nga Sllovenia që kryesisht përdor videot, performancat dhe mediat e reja. Filmat e saj dokumentar fokusohen te feminizmi dhe çështjet sociale.

Materialet dhe burimet e kulturës së kujtimeve dhe ballafaqimit me të shkuarën në Ballkanin Perëndimor me fokus edukimin

Platforma edukative dhe informative online me aktorët, leksionet, mjetet dhe përvojat rreth edukimit në fushën e kulturës së kujtimeve	http://www.memorytools.cliohipbih.ba
Ballafaqimi me të shkuarën – faqja e internetit dhe platforma për krijimin e rrjeteve në Ballkanin Perëndimor	http://www.dwp-balkan.org
EUROCLIO HIP BeH Shoqata e mësuesve të historisë në Bosnje dhe Hercegovinë	http://cliohipbih.ba
Forumi i Shërbimit Civil për Paqen (<i>forumZFD</i>)	http://www.forumzfd.de http://westernbalkans.forumzfd.org
Anne Frank House / Memory walk	http://www.annefrank.org
Projekti HIP – Historia – mesazhe për të tashmen	http://www.historijaistorijapovijest.org
Shoqata për të mbështetur veteranat e luftës, familjet dhe viktimat e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë “Pravipožar”	http://www.pravipozar.com
Humanity in Action në BeH	http://www.humanityinaction.org
Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në BeH	http://www.yihr.ba
Rrjeti për ndërtimin e paqes BeH	http://www.mreza-mira.net
Pax christi Aachen, Lëvizja Ndërkombëtare e Paqes, Ahen (Gjermani)	http://www.paxchristi-aachen.de/
Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën Srpska (BeH), Bijeljina	http://www.helcommrs.org/
Qendra për paqe, jodhunë dhe të drejta të njeriut Osijek (Kroaci)	http://www.centar-za-mir.hr
BIRN: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese Drejtësia tranzicionale, përkujtimi, monumentët ballkanik të past luftës në fokus	http://www.balkaninsight.com/en/page/balkan-transitional-justice-memorialisation-conflicting-memories
Pravo ljudski	http://pravoljudski.org/en/index.html#
Laboratori i kujtimeve	http://www.memorylab-europe.eu
Projekti Monumentët e papërshtatshëm	http://www.inappropriatemonuments.org
Qendra për demokraci dhe pajtim në Europën Juglindore	http://www.cdrsee.org
EUROCLIO Shoqata Europiane e mësuesve të historisë (Hollandë)	http://www.euroclio.eu

Fondi për të drejtën humanitare, Beograd (Serbi)	http://www.hlc-rdc.org
C31-Qendra për zhvillimin e kulturës së të drejtave të fëmijëve Beograd (Serbi)	https://www.facebook.com/pages/C31-Centar-za-razvoj-kulture-decijih-prava/
Documenta – Qendra për ballafaqim me të shkuarën, Zagreb (Kroaci)	http://www.documenta.hr/en/home.html
Muzeu i fëmijërisë së luftës, BeH	http://djetinjstvouratu.com/muzej/
Qendra për veprim paqësor (CNA), BeH dhe Serbia	http://kulturasjecanja.org/en/
PCRC – Qendra kërkimore e post-konfliktit BeH	http://www.balkandiskurs.com/en/2016/01/13/the-bridges-of-bosnia-herzegovina/
Instituti i kulturës dhe artit Ars acta, Shkup (Maqedoni)	http://www.facebook.com/ars.acta
Arti i padukshëm	http://www.balkaninsight.com/en/article/critical-voices-erased-from-macedonian-arts--11-05-20
Bota tjetër Jugosllavia, film i shkurtër	http://www.nowness.com/story/a-second-world-yugoslavia www.nowness.com/story/a-second-world-yugoslavia
BIRN - dokumentar 'The Unidentified' për luftën në Kosovë	http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-s-war-movie-premiered-at-sarajevo-film-festival-08-16-2015-1 http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-documentary-screened-for-us-students http://www.balkaninsight.com/en/article/new-birn-war-crimes-movie-premiered-belgrade
Filmi i shkurtër i drejtorit Britanik Jamie Donoughue 'Shok' ('Friend'), mbi luftën e nëntëdhjetës	http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-movie-reaches-hollywood-01-14-2016
Projekti Living together film dokumentar mbi guximin e sportistëve Jugosllavë "Know What is Offside"	http://www.balkaninsight.com/en/article/sportsmen-wartime-acts-honoured-in-film
WARM Foundation: War Reporters' Festival, BeH (Festivali i gazetarëve të luftës)	http://www.balkaninsight.com/en/article/international-war-reports-call-for-truth-and-justice-in-sarajevo

Festivali i tolerancës, dedikuar filmit dhe edukimit, Zagreb (Kroaci)	http://www.balkaninsight.com/en/article/film-festival-of-tolerance-starts-in-zagreb
'Camps of Death' (Kampet e vdekjes) film dokumentar, Sarajevë, BeH	http://www.balkaninsight.com/en/article/documentary-camps-of-death-premiered
Filmi dokumentar mbi përdhunimet gjatë luftës dhe abuzimet seksuale 'Silent Scream'	http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-documentary-silent-scream-premiers-in-sarajevo
Agjencia e lajmeve SENSE: Arkivi i gjykimeve të gjenocidit në Srebrenicë i hapur në Qendrën Përkujtimore Potoçari në Srebrenicë	http://www.balkaninsight.com/en/article/news-agency-sense-s-archive-on-srebrenica-in-potocari
Filmi dokumentar "The Majority Starts Here" flet rreth asaj se si të rinjtë interpretojnë konfliktin e fundit në ish Jugosllavi	http://www.balkaninsight.com/en/article/majority-starts-here-premiers-in-mitrovica http://www.balkaninsight.com/en/article/new-birn-film-shows-tolerance-is-possible http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-premieres-film-on-youth-and-war http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-documentary-premieres-in-skopje
Filmi dokumentar 'Missing You...', flet për procesin e lodhshëm dhe traumatik të kërkimit të eshtrave të njerëzve të zhdukur	http://www.balkaninsight.com/en/article/documentary-missing-you-premieres-in-sarajevo
"Arti në kohën e errët" ekspozita e karikaturave të motivuara politikisht të cilat janë krijuar gjatë kohës së sundimit të Slobodan Milosheviçit	http://www.balkaninsight.com/en/article/belgrade-hosts-cartoons-from-dark-times
Filmi dokumentar "Më kujto mua" i shoqatës së Grave të Prijedorit "Izvor", drejtuar nga Azra Hoxhiç, flet për procesin e ballafaqimit me të shkuarën të dy vajzave, Hasema, e cila ishte dy vjeç kur i ati i'u dërgua në kampin Keraterm, dhe Lejla, vetëm disa muajshe kur i ati i'u zhduk	https://www.ictj.org/news/documentary-film-remember-me
Filmi dokumentar "Through Their Eyes: Witnesses to Justice" thekson rolin e dëshmitarit në gjykimet për krimet e luftës në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë në Hagë (ICTY)	http://www.balkaninsight.com/en/article/premiere-screenings-of-icty-s-documentary-in-zagreb
Harta e gjykimeve për krimet e luftës(online) – (Misioni i OSBE –së në BeH)	http://www.balkaninsight.com/en/article/bosnian-war-crimes-case-map-published

Aktorët nga Serbia dhe Kosova në projektin e përbashkët Performanca e dramës së Shekspirit, Romeo dhe Zhuliet	http://www.balkaninsight.com/en/article/romeo-and-juliet-connects-belgrade-and-pristina
Muzikanti i ish Jugosllavisë performon ‘War Requiem’ në koncertin dedikuar promovimit të bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe të kuptuarit	http://www.balkaninsight.com/en/article/zagreb-orchrestras-from-the-region-played-britten
Sarajeva mirëpret Konferencën ndërkombëtare për paqe nën moton “Living Together is the Future” (Të jetojmë së bashku është e ardhmja)	http://www.balkaninsight.com/en/article/sarajevo-international-conference-urged-for-peace
Shkolla e drejtësisë tranzicionale për paqe në Ballkan	http://www.balkaninsight.com/en/article/sarajevo-to-share-lessons-in-summer-school
Qendra për të rinjtë Kuart Prijedor	http://centarzamladekvartprijedor.blogspot.ba/
Shoqata e Qytetarëve “Oštra nula” (Zero e mprehtë) Banja Luka, BiH	http://ostranula.org/
Qendra për ndërtimin e paqes Sanski Most / Center for peacebuilding Sanski Most	http://unvocim.net/eng/
Projekti Historia e përbashkët e Europës Juglindore është një iniciativë multinationale dhe multidisiplinare e cila përdor multiperspektivën dhe qasjen pjesëmarrëse kritike për të edukuar mbi historinë me qëllim luftën kundër nacionalizmit, kapërcimin e armiqësive dhe promovimin e barazisë dhe diversitetit.	http://www.fes-soe.org/news-list/e/the-southeast-european-joint-history-project/
Facing History and Ourselves është një organizatë ndërkombëtare jo-fitimprurëse për edukim dhe zhvillim. Misioni i organizatës është përfshirja e nxënësve të profileve të ndryshme për të hulumtuar mbi racizmin, paragjykimet dhe antisemitizmin që të promovohet dhe të inkurajohet zhvillimi i qytetarisë më humane dhe më të informuar.	https://www.facinghistory.org
Organizata EIHR zhvillon partneritetin dhe ofron mbështetje mësuesve, edukatorëve, studiuesve dhe organizatave që japin mësim rreth Holokaustit, të drejtave njerëzore dhe parandalimit të gjenocidit.	http://www.eihr.org

Përkthimi:

Diwan, shoqata për ofrimin e shërbimeve gjuhësore dhe të tjera, Sarajevë
Enes Tuna

Lektor:

Enes Tuna

Fotograf:

Të gjitha fotografitë janë nga katalogu MOnuMENTI, i autorit Marko Krojaq (përveç fotos Moduli V: “kuadër nga krijimi i materialit MOnuMENTImotion, i autorit Muhamed Kafexhiç Muha dhe fotoja Moduli VII: kuadër nga filmi i shkurtër Indexi dhe Mirza, autor Instituti Publik Gjinnazi Obala Sarajevë

Daniel Brumund, foto “Luftëtari në kalë”

Fotografia c/b Boro dhe Ramiz në manual dhe në kartën pedagogjike, autori i panjohur (wikipedia)

DVD mastering:

Muhamed Kafexhiç Muha
Damir Shauli

Muzika në filmin e shkurtër “MOnuMENTImotion”:

Renato Foder

Dizajni:

Studio Lisica

DTP:

Jasmin Leventa

Shtypi:

Dobra knjiga Sarajevo

Botuesi:

Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (*forumZFD*)

Tirazhi:

100

Sarajevë, 2016.

Copyright: Forum Ziviler Friedensdienst e.V. (*forumZFD*)

Ky publikim është pronë e Forum Ziviler Friedensdienst e.V. (*forumZFD*). Publikimi mund të përdoret lirisht për qëllime edukative dhe jo komerciale pa lejen e botuesit. Duke përdorur pjesë të këtij materiali, përdoruesi/it janë të detyruar të ndjekin citimin e saktë:

“Kujtime në lëvizje – mjet pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve”, *forumZFD* dhe autorët. Përdorimi i publikimit është i dëshirueshëm. Përdoruesi/t janë të lutur të informojnë *forumZFD* (parente@forumzfd.de) përpara përdorimit të materialit ose pjesëve të tij.

Mirënjohje:

Pjesë të këtij manuali janë të lidhura me projektin Memory Walk i krijuar në bazë të manualit të mëparshëm “Memory Walk. Mjet edukativ” (i krijuar nga Kongresi i pakicave kombëtare të Ukrainës) dhe në veçanti falënderojmë ekspertët të cilët kanë punuar në krijimin e këtij manuali: Kira Kreyderman (Kongresi i pakicave kombëtare të Ukrainës), Olexander Voitenko (ekspert i pavarur) dhe Mikhail Tyaglyy (Qendra Ukrainase për studime të Holokaustit).


Falënderojmë Ana Qigon, artisten dhe regjizoren nga Sllovenia, e cila n'a lejoi të përdornim filmin e saj dokumentar “Kujtime për të tjerët”, si pjesë përbërëse e mjetit të ri pedagogjik “Kujtime në lëvizje”, Gjimnazin Obala në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, për filmin e tyre të shkurtër “Indexi dhe Mirza” dhe Nita Lucin dhe Vjollca Krasniqin, profesoresha në Universitetin e Prishtinës (Kosovë), të cilët kanë bërë modulin pedagogjik VI “Kujtime për të tjerët”.

Falënderojmë dhe Soraja Zagiç, Sunita Dautbegoviç-Boshnjakoviç, Judith Brand, Adis Hukanoviç, Korab Krasniqin (*forumZFD*), dhe Gerda Seidelmann (vullnetarët e pax christi Aachen) Eva Goesswein për kontributin e tyre të çmuar.

Në veçanti falënderojmë 124 mesuesit/et dhe edukatorët të cilët kanë kaluar përmes trajnimeve për trajnerë mbi zbatimin e botimit të parë të këtij mjeti pedagogjik dhe të cilët kanë përcjellë njohuri të reja te nxënësit e rinj dhe studentët. Së fundmi, një falenderim i madh shkon për Amra Hasiç, profesoreshën e Universitetit të Tuzlës, e cila pas trajnimit, me iniciativën e vet arriti që mjetin pedagogjik mbi kulturën e kujtimeve “Kujtime në lëvizje” të pranohej nga ana e dekanit dhe të miratohej si pjesë e programit mësimor në Departamentin e Historisë në Fakultetin e Filozofisë në Tuzla.



ISBN 978-9958-0399-4-2



9 789958 039942 >

Manuali është strukturuar si një mjet interaktiv pedagogjik për mësues, instruktorë dhe profesorë që punojnë me të rinjtë nga mosha 15 deri në 25 vjeç dhe përmban:

- shtatë module tematike mbi kulturën e përkujtimit;
- njëmbëdhjetë njësi për të punuar me nxënësit dhe studentët, si dhe për të punuar me të rinjtë që janë aktivë në organizata rinore joqeveritare kulturore dhe arsimore;
- dy përmbajtje me shkrim (ese);
- DVD me material audiovizual didaktik (shtatë filma të shkurtër dhe një film dokumentar);
- 27 karta didaktike (për të punuar me pjesëmarrësit e trajnimit) me fotografi monumentesh dhe përmendoresh nga Ballkani Perëndimor;
- Katalog me monumentet e Ballkanit Perëndimor me titullin MONUMENTI;
- Biografia e autorëve;
- përzgjedhja e materialeve relevantë për edukim mbi kulturën e kujtimit.

Autorët:

Melisa Foriq
Bojana Dujkoviç-Blagojeviç
Senada Jusiç
Larisa Kasumagiç-Kafexhiç
Laura Boerhout

dhe

Vjollca Krasniqi
Nita Luci
Wouter Reitsema
Muhamed Kafexhiç Muha
Nicolas Moll
Ana Qigon
Michele Parente
Nxënësit e Institucionit Publik Gjymnazi Obala Sarajevë

Financuar nga

BMZ



Bundesministerium für
wirtschaftliche Zusammenarbeit
und Entwicklung